

Dr. Majlinda Ziu

LIBËR PËR MËSUESIN  
**Gjeografia 7**

BOTIME



# Përmbajtja

<b>I. Çfarë na orienton dhe kërkon programi i Gjeografi së 7</b>	5
<b>I.1</b> Qëllimet e programit	5
<b>I.2</b> Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës/lëndës	6
<b>I.3</b> Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj	10
<b>I.4</b> Koha mësimore për tematikë	11
<b>I.5</b> Rolet që ndërmarrin nxënësi/ja dhe mësuesi/ja gjatë procesit të të nxënit:	11
<b>I.6</b> Çfarë situatash duhet të përdoren në funksion të të nxënit?	12
<b>I.7</b> Në sa mënyra vlerëson mësuesi/ja?	12
<b>II. Modele të planifi kimit vjetor, 3-mujor dhe ditor të mësuesit...</b>	13
<b>II.1</b> Modeli i planifi kimit vjetor	13
<b>II.2</b> Modeli i planifi kimit mujor (me disa situata model)	17
Nëntematika I-Toka në hapësirë	57
<b>III. Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve</b>	198

### ***Mësues të dashur!***

Ky libër mësuesi, ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme, me anë të planifikimeve dhe udhëzimeve që ofron. Udhëzimet e tij bazohen në programin e IZHA-s, miratuar nga MAS-i. Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor, është hartuar në frymën e të nxënit me kompetenca. Ju do t'i orientoni nxënësit tuaj drejt krijimit të kompetencave, drejt punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen planifikimet vjetore, 3-mujore dhe ditore. Ju mund t'u përmbaheni atyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja, në përputhje me kërkesat dhe nivelin e nxënësve tuaj.

Mirëpresim çdo këshillë dhe mendim nga ju.

***Ju urojmë punë të mbarë!***



# I.

---

## Çfarë na orienton dhe kërkon programi i Gjeografisë 7

---


*(Kjo çështje është trajtuar duke u bazuar në programin e hartuar nga IZHA në vitin 2014.)*

### I.1 Qëllimet e programit

Programi i gjeografisë për shkallën e 3-të synon që nxënësi/ja:

- Të zhvillojë kuriozitetin për vendet, njerëzit, kulturat dhe mjediset në botë.
- Të zhvillojë dijet për dukuritë dhe proceset fiziko-gjeografike mbi bazën e një përgatitjeje të përshkallëzuar dhe ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues.
- Të zhvillojë kuptimin, interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vendet e tjera, njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë.
- Të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik.
- Të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.
- Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.

Korniza konceptuale e programit (sipas programit të hartuar nga IZHA në vitin 2014).



## I.2 Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës/lëndës

Mësuesi duhet të mbajë parasysh lidhjen e **kompetencave kyçe me kompetencat e fushës**. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme që i shërbejnë procesit të të nxëniet. **Kompetenca përcaktohet si një ndërthurje e njohurive me shkathtësinë dhe me qëndrimet që një nxënës duhet të fitojë gjatë procesit të nxënies.**

- **Kompetenca qytetare**

Si pjesë e fushës *Shoqëria dhe mjedisi*, përmes kërkimit gjeografik programi i gjeografisë krijon kushte për ndërtimin dhe për demonstrimin nga nxënësi/ja të kompetencës qytetare. Në shkallën e tretë, nxënësi/ja hulumton për çështje aktuale gjeografike; vlerëson gjetjet e tij/saj në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore në nivel lokal e global, me diversitetin dhe me respektimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në zonën ku jeton etj. Përmes eksplorimit të çështjeve të tilla, nxënësi/ja nxitet të mendojë në mënyrë kritike, të marrë vendime dhe të veprojë për adresimin e çështjeve qytetare në një botë të ndërvarur dhe të ndryshueshme. Nxënësi/ja propozon alternativat e tij/saj për sfida apo për çështje të ndryshme gjeografike, duke marrë në konsideratë faktorët mjedisorë, ekonomikë, shoqërorë.

- **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

Programi krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi/ja përdor

materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Ai/ajo mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë se si gjuha mund të përdoret për të manipuluar të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve apo prezantimeve, nxënësi/ja zhvillon shkathtësi të të shprehurit; në mënyrë progresive zhvillon dhe përdor fjalorin gjeografik për komunikimin e informacionit dhe të ideve në audiencë të ndryshme.

- **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi/ja zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre; teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai/ajo zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi/ja të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues/e dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bëhen në terren. Ai/ajo nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe krijuese për mënyrat e përdorimit sa më racional të burimeve natyrore. Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematike për ndërtimin e grafikëve e të tabelave, si dhe për llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit/et punojnë me koncepte numerike, si: shkalla, largësia, koordinatat.

- **Kompetenca e të nxënit**

Për të mbështetur kërkimin gjeografik, nxënësi/ja përdor metoda efektive të punës; shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme; gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai/ajo përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij/saj dhe për komunikimin e gjetjeve. Nxënësi/ja mendon në mënyrë kritike kur konsideron pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar; kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale; kur pozicionohet dhe mbron qëndrimin e tij/saj.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme gjeografike e ndihmon nxënësin/en të njohë kulturën e tij/saj dhe kulturat e tjera. Ai/ajo mëson ku është dhe si lidhet pozita e tij me të tjerët. Nxënësi/ja mëson të bashkëpunojë dhe të përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave, ai/ajo demonstroi respekt e mirëkuptim, si dhe pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e gjeografisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij/saj dhe për të organizuar përgjigjet.

- **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit/et zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik; analizojnë elemente të situatës, kompleksitetin e saj; vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme gjeografike e ndihmon nxënësin/en të njohë kulturën e tij/saj dhe kulturat e tjera. Nxënësit/et mësojnë të bashkëpunojnë ndërsa përballet me detyra të ndërlikuara, të cilat kërkojnë bashkëpunim.

- **Kompetenca personale**

Programi i gjeografisë stimulon të nxënit duke u bazuar në kërkim dhe duke zhvilluar aftësinë e nxënësve/eve për të menaxhuar veten. Nxënësit/et kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe

të shkathtësive, si dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit/et zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve/eve të tjerë/a të grupit.

- **Kompetenca digjitale**

Nxënësi/ja zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë gjeografike, për vendin e tij/saj, marrëdhënien e njeriut me mjedisin.

### **Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së Gjeografisë SHKALLA 3**

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

*(Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)*

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

#### **Kompetenca e të menduarit *(Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)***

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie.
- Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë.
- Interpretin mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy a më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

**Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe të mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**  
(Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.



<b>Kompetenca qytetare (<i>Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.</li><li>• Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.</li></ul>
<b>Kompetenca digjitale (<i>Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.</i>)</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.</li><li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).</li></ul>

### I.3 Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Programi i gjeografisë (i shkallës së tretë) zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike*
- *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit*
- *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur*

<b>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës SHKALLA 3</b>
<b>Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b>
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Formulon dhe drejton pyetje për çështjen gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi gjeografik.</li><li>• Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza.</li><li>• Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe në mjedisin lokal.</li></ul>

### Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe proceset e dukuritë gjeografike në gjeosistem, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren, fotografi etj.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

### Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyçe.
- Nxënësi/ja identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.

## I.4 Koha mësimore për tematikë

Programi i gjeografisë për klasën e 7-të zhvillohet në 70 orë mësimore. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë dhe nëntematikë, për secilën shkallë dhe klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Mësuesit/et duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, dhe janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë dhe nëntematikë.

## I.5 Rolet që ndërmarrin nxënësi/ja dhe mësuesi/ja gjatë procesit të të nxënit:

**Nxënësi/ja – aktiv/e dhe i/e interesuar.** Në lëndën e Gjeografisë, nxënësi/ja studion dukuritë dhe proceset gjeografike, ndërton kuptimin për vendin e tij/saj. Ai/ajo inkurajohet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi/ja angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj

që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij/saj; bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin/en, ndan me ta/to vëzhgimet dhe përvojat e tij/saj. Ai/ajo punon individualisht ose në grup, dhe mbështetet nga mësuesi/ja.

**Mësuesi/ja – udhëheqës/e dhe lehtësues/e.** Mësuesi/ja i/e gjeografisë ndihmon nxënësit/et të zbulojnë kënaqësitë e të nxënësve. Roli i mësuesit/es konsiston në udhëheqjen e nxënësve/eve; ai/ajo moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit/et veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësit/es, duke e ndihmuar nxënësin/en të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ata/ato krijojnë kontekste të nxëni, të cilat i aftësojnë nxënësit/et të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi/ja të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënësve/eve. Ai i angazhon nxënësit/et në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

### I.6 Çfarë situatash duhet të përdoren në funksion të të nxënësve?

- *Situatat e të nxënësve në gjeografi duhet të jenë të larmishme dhe komplekse.* Nxënësi/ja duhet të perceptojë lidhjen ndërmjet përvojave të tij/saj të të nxënësve dhe zbatimeve të ardhshme.
- *Situatat duhet të jenë të hapura,* çka do të thotë që nxënësi/ja aftësohet të kërkojë zgjidhje të ndryshme për një çështje apo problem, dhe jo një zgjidhje të vetme apo një përgjigje të vetme. Situata të tilla përfshijnë detyra të ndryshme, favorizojnë përdorimin e mediave të ndryshme dhe rezultojnë me punime të llojeve të ndryshme.
- *Situatat e të nxënësve duhet të jenë komplekse,* që do të thotë të përdoren burime të ndryshme të të nxënësve dhe nxënësit/et të punojnë së bashku. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënësve. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

### I.7 Në sa mënyra vlerëson mësuesi/ja?

Mësuesit/et duhet të përdorin situata të jetës reale, si pikënisje për vlerësimin e nxënësve/eve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit/et) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara.

Përdorimi i portofolit, si një koleksion sistematik i punës së nxënësve/eve, siguron një tablo të plotë të zhvillimit e të progresit të nxënësve/eve në përvetësimin e njohurive, të të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai u afron nxënësve/eve gjithashtu mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofolave të tyre.



## II.

### Modele të planifikimit vjetor, 3-mujor dhe ditor të mësuesit...

#### II.1 Modeli i planifikimit vjetor

Tematika	Proceset natyrore dhe shoqërore	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve
Klasa 7	orë	8 orë

#### Klasa 7

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Proceset natyrore dhe shoqërore	Toka në hapësirë	8
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë	54
Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin	8

- **PLANI MËSIMOR VJETOR KLASA VII**
- **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**

**LËNDA: GJEOGRAFI 7**

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
	SHTATOR – DHJETOR (24 ORË)	JANAR – MARS (26 ORË)	PRILL – QERSHOR (20 ORË)
<p>Toka në hapësirë (8 orë)</p> <p>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (54)</p>	Nëntematika I- Toka në hapësirë	Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (vazhdim)	Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (vazhdim)
	1. Toka në sistemin diellor	1. Projekt (ora e parë); Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim	1. Historia e Tokës
	2. Forma e Tokës dhe rëndësia e saj	2. Cikli i ujit	2. Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike
	3. Përmasat e Tokës. Rëndësia e tyre	3. Veçoritë e ujit të deteve dhe të oqeaneve	3. Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre
	4. Rrotullimi i Tokës rreth boshtit dhe pasojat gjeografike	4. Lëvizjet e ujërave oqeanike. Valët detare	4. Tërmetet
	5. Rrotullimi i Tokës rreth Diellit	5. Baticat dhe zbaticat	5. Vullkanet
	6. Punë praktike 1.1 Tema: Vendi i Tokës në sistemin diellor. Rrotullimi ditor, qarkullimi vjetor dhe pasojat që rrjedhin për planetin tonë	6. Rrymat oqeanike	6. Format e relievit
	7. Përsëritje 1 (Toka në hapësirë)	7. Punë praktike 2.4; Tema: Skicimi në hartë i rrugës që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe evidencimi i rolit që ato kanë mbi klimën e rajoneve që përshkojnë.	7. Bota bimore

<p>Toka në hapësirë (8 orë)</p> <p>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (54)</p>	8. Testim 1 (Toka në hapësirë)	8. Lumenjtë dhe pjesët përbërëse të tij	8. Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore
	Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë	9. Punë praktike 2.5 Tema: Elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve	9. Bota shtazore
	9. Atmosfera. Përbërja e saj	10. Punë praktike 2.6 Tema: Përcaktimi i drejtimeve kryesore të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës	
	10. Struktura e atmosferës	11. Veprimtaria e lumenjve	10. Punë praktike 2.9 Tema: Bota e gjallë sipas brezave të nxehtësisë
	11. Rrezatimi diellor dhe rëndësia e tij	12. Liqenet dhe llojet e tyre	
	12. Faktorët dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë	13. Punë praktike 2.7 Tema: Liqenet në Shqipëri	
	13. Moti	14. Burimet dhe përdorimi i tyre	
	14. Punë praktike 2.1 Tema: Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta nga nxënësit, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin (ora e parë)	15. Punë praktike 2.8 Tema: Burimet në vendbanimin tim dhe përdorimi i tyre	11. Përsëritje 5 (Litosfera 2)
15. Punë praktike 2.1 Tema: Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta nga nxënësit, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin (ora e dytë)	16. Bora dhe akujt	12. Testim 4 (Litosfera 2)	

<p>Toka në hapësirë (8 orë)</p> <p>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (54)</p>	<p>16. Punë praktike 2.2 Tema: Parashikimi i motit përmes leximit të hartave sinoptike dhe të përdorimit të instrumenteve të thjeshta</p>	<p>17. Përsëritje 3 (Hidrosfera)</p>	<p>TEMATIKA: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve</p> <p>Nëntematika: Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin (8 orë)</p>
	<p>17. Klima</p>	<p>18. Projekt (ora e dytë) Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim</p>	<p>13. Projekt ora e tretë Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim</p>
	<p>18. Klima (vazhdim)</p>	<p>19. Ndërtimi i brendshëm i Tokës</p>	<p>14. Potencialet e zonave bregdetare</p>
	<p>19. Njeriu dhe ndryshimet klimatike</p>	<p>20. Llojet e shkëmbinjve dhe shkëmbinjtë sedimentarë</p>	<p>15. Ndotjet në zonat bregdetare</p>
	<p>20. Zonat klimatike</p>	<p>21. Shkëmbinjtë magmatikë</p>	<p>16. Shkaqet e tjera të ndotjes së zonave bregdetare</p>
	<p>21. Punë praktike 2.3 Tema: Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas brezave të nxehtësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve klimatikë për vende të ndryshme në to. (ora e parë)</p>	<p>22. Shkëmbinjtë metamorfikë</p>	<p>17. Ndotja në qendrat urbane</p>
	<p>23. Rëndësia e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për shoqërinë</p>	<p>23. Rëndësia e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për shoqërinë</p>	
	<p>22. Punë praktike 2.3 Tema: Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas brezave të nxehtësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve klimatikë për vende të ndryshme në to. (ora e dytë)</p>	<p>24. Dherat</p>	<p>18. Ndotja në qendrat urbane (vazhdim)</p>
	<p>23. Përsëritje 2 (Atmosfera)</p>	<p>25. Përsëritje 4 (Litosfera 1)</p>	<p>19. Ndotja në qendrat rurale</p>
	<p>24. Testim 2 (Atmosfera)</p>	<p>26. Testim 3 (Hidrosfera dhe Litosfera 1)</p>	<p>20. Projekt ora e katërt Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim</p>

## II.2 Modeli i planifikimit mujor (*me disa situata model*)

- **PLANI 3-MUJOR (SHTATOR-DHJETOR -24 orë); KLASA VII**
  - **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
- LËNDA: GJEOGRAFI 7**

### Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe

#### 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)

- Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit për: formën dhe përmasat e Tokës, lidhjen ndërmjet rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe gjatësisë së ditës; pasojat e ndryshimit të pozicionit të Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve, rëndësinë e rrezatimit diellor, marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative (për të kuptuar motin) etj.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm) kuptimin mbi: formën dhe përmasat e Tokës, pozicionin e Tokës në sistemin diellor, formimin e ditë natës dhe të stinëve, strukturën vertikale të atmosferës, brezat e nxehtësisë, shkaqet dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë, motin si ndryshim afatshkurtër i temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative, faktorët që ndikojnë në formimin e klimës.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.



## 2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati (p.sh mbi: vendin që zë Toka në sistemin diellor, në gjithësi dhe në galaktikën “Rruga e Qumështit”; rolin e elementeve që përbëjnë atmosferën e Tokës; ndikimet që ka rryma e Golfstrimit në temperaturat e ajrit në vendet pranë të cilave kalon; etj).
- Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse (p.sh vëzhgon kushtet e motin përgjatë një jave dhe përshkruan elementet e tij; Ndërrton argumente mbi pasojat që sjellin ndryshimet klimatike në jetën tonë dhe në planet. Veçon prej tyre, disa nga pasojat që janë të pranishme në vendin ku jeton. etj).
- Interpretton duke e ilustruar me shembuj konkretë rolin e gjeografisë për jetën e përditshme dhe rolin e kërkimit gjeografik në njohjen mbi botën.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet midis zonave klimatike etj.

## 3. Kompetenca e të nxëniet (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, foto, harta të ndryshme, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzojnë për realizimin e detyrave të dhëna
- Shfrytëzojnë të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve, duke përdorur dhe ndërtuar instrumentet për matjen e temperaturës së ajrit, të shtypjes atmosferike, lagështirës dhe përcaktimit të erës, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin; analizuar harta sinoptike për të bërë parashikime të motit; përshkruar klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës e reshjeve; ndërtuar dhe interpretuar grafikë klimatikë për zona të ndryshme.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, internet, media etj., për të nxënë, në detyrën që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemën e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur (si p.sh., hulumton, analizon dhe jep disa shembuj që tregojnë se si ka ndikuar shoqëria mbi klimën në vendin tonë ose në vendbanimin e tij/saj).
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe të mjeteve gjatë kryerjes së detyrave në klasë/shkollë apo në terren.

#### **4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (p.sh ndërton vetë instrumente për matjen e temperaturës së ajrit, të shtypjes atmosferike, lagështirës së ajrit, reshjeve si dhe për përcaktimin e drejtimit e të shpejtësisë së erës, dhe parashikon motin).

#### **5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan përvojja dhe mendime në grup.

#### **6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjërë.

#### **7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- Formulon dhe drejton pyetje për: rëndësinë që ka forma e Tokës, rëndësinë që ka shtresa e troposferës dhe ajo e stratosferës për jetën në tokë; shkallën e ndikimit të faktorëve mbi elementet e motit dhe të klimës; disa nga pasojat e ndryshimeve klimatike që janë të pranishme në vendin ku jeton; etj.
- Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza (p.sh., mbi pozicionin e Tokës në gjithësi, në galaktikën tonë apo në sistemin diellor).

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim (p.sh harta, grafikë, video, foto të ndryshme, materiale të printuara, etj).
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Ndërton njohuri për mjedisin lokal duke përdorur hartat, vëzhgimet në terren, fotografi, intervistat, etj në çështje që kanë të bëjnë me ndërvëprimin midis shoqërisë dhe mjedisit, me motin, me klimën etj.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi:


- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyçe.
- Nxënësi/ja identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.

SHTATOR-DHJETOR (24 orë)							
Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1.	Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore	Nxënësi/ja: <b>Përshkruan:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>formën e Tokës;</li> <li>përmasat dhe rëndësinë e tyre;</li> <li>pozicionin e Tokës në sistemin diellor.</li> </ul>		<b>Situata 1.1:</b> Hapësira që na rrethon, është e pafundme. Njeriu kërkon vazhdimisht ta njohë sa më shumë atë. Por, çfarë vendi zë Toka jonë në këtë hapësirë?	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale;	Vlerësim me gojë Vlerësim i punës në grup Vlerësim i punës praktike Vlerësim i	Teksti i gjeografisë Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës.
	Nëntematika I - Toka në hapësirë (8 orë)	<b>Identifikon:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj.</li> </ul>	<b>1. Toka në sistemit diellor</b>	<b>Situata 1.2:</b> Bazuar në figurat 2 dhe 3 të tekstit: <ul style="list-style-type: none"> <li>përshkruaj se ku ndodhet Toka në raport me Diellin dhe me planetët e tjerë të sistemit diellor;</li> <li>krahaso përmasat e Tokës me ato të Diellit dhe të planetëve të tjerë të sistemit diellor;</li> <li>përcakto se çfarë vendi zë sistemi ynë diellor në galaktikën “Rruga e Qumështit”.</li> </ul>	Bashkëbisedim; Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming; Diskutime; Debat;	Vlerësim i detyrës së shtëpisë Vlerësim i eseve Vlerësim me shkrim Vlerësim i lojës me role.	Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës dhe të Shqipërisë Materiale nga interneti, libra, enciklo-
	Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (54 orë)	<b>Ndërton dhe përdor modele që:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>tregojnë lidhjen ndërmjet rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe gjatësisë së ditës;</li> </ul>					

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
2.		<ul style="list-style-type: none"> <li>përshkruajnë pozicionin e Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve.</li> </ul>	<p><b>2. Forma e Tokës dhe rëndësia e saj</b></p>	<p><b>Situata 2.1:</b> Njeriu është përpjekur të zbulojë pamjen e vërtetë të Tokës shumë kohë më përpara se të dërgoheshin kamerat në hapësirë (kujto çfarë ke mësuar në klasën e gjasthtë). Në shekullin III pr.K., me anë të llogaritjeve që bëri, dijetari grek, Aristoteli dha i pari idenë e rrumbullakësisë së Tokës. Kohë më vonë, formën reale të këtij planeti e sollën imazhet e dërguara nga satelitët artificialë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ju mund të keni lexuar kuriozitetet e ndryshme mbi Tokën dhe keni parë fotografi të pamjes së saj. Si e parafytyroni formën e Tokës?</li> </ul> <p><b>Situata 2.2:</b> Rikujto njohuritë e marra nga teksti i Gjeografisë 6, mbi klimën e vendit tonë. Diskuto: a) në cilin brez klimatik ndodhet vendi ynë dhe me çfarë këndi bie rrezatimi diellor në këtë brez; b) çfarë tiparësh ka klima e vendit tonë.</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim; Përdorimi TIK; Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming; Diskutime; Debat; Lojë me role;</p>		<p>pedi. Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video. Materiale të përgatitura me Power point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesi/ja dhe nxënësif/et.</p>


Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
3.			<p>3. Përmasat e Tokës.</p> <p><b>Rëndësia e tyre</b></p>	<p><b>Situata 3:</b> Risjellim në vëmendje vendin që zë Toka në sistemin diellor. Krahasojmë përmasat e saj me ato të planetëve të tjerë të sistemit diellor.</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim; Përdorimi TIK; Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming; Diskutime; Debat; Lojë me role;</p>		
4.			<p><b>4. Rrotullimi i Tokës rreth boshtit dhe pasojat gjeografike</b></p>	<p><b>Situata 4.1:</b> Përgjatë 24 orëve, vëmë re se dita dhe nata ia lënë vendin njëra-tjetrës në mënyrë të përsëritur. Dielli shfaqet në agim, në vazhdim e shohim që lëviz nëpër qiell deri sa perëndon, dhe më pas vjen nata. Mëngjesin tjetër, dielli rishfaqet dhe çdo gjë përsëritet nga e para. Për rrjedhojë, duke iu përshtatur këtij ndryshimi të përhershëm, e gjithë bota e gjallë në planetin tonë krijon një regjim ditor të caktuar. Por, a e dimi si formohet ditë-nata?</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi i TIK-ut; Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming;</p>		

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
4.		<p><b>4. Rrotullimi i Tokës rreth boshtit dhe pasojat gjeografike</b></p>	<p><b>Situata 4.2:</b> Ndërto një maket (me një top llastiku, plastelinë etj.), ku të paraqesësh formën e Tokës. Kalo mes përmes tij një bosht, si për të zëvendësuar boshtin imagjinar të Tokës. Vendose përballë një burimi drite (një llambë e ndezur ose elektrik dore). Shëno një pikë ose një shenjë tjetër mbi top dhe pasi ta rrotullosh atë nga perëndimi në lindje, në kah të kundërt me lëvizjen e akrepave të orës, përshkruaj se si ndryshon ndriçimi mbi pikën apo shenjën gjatë rrotullimit.</p> <p><b>Situata 4.3:</b> Qëndro ulur si në figurë, në një rrotullame që nuk lëviz. Hidh një top drejt shokut/shoqes së ulur përballë teje. Përsërite vepërimin (pra, hidhe topin</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• drejt shokut/shoqes) kur rrotullamja të lëvizë në drejtimin e lëvizjes së Tokës rreth vetes. Përshkruaj se çfarë vure re dhe në ç’përfundim arrite pas</li> <li>• vëzhgimit tënd. Bëj një vizatim që tregon drejtimin</li> <li>• e lëvizjes së rrotullames dhe të topit (në të dyja rastet: kur rrotullamja nuk lëviz, dhe kur ajo është në lëvizje).</li> </ul>	<p>Diskutime; Debat; Lojë me role;</p>		

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
5.			5. Rrotullimi i Tokës rreth Diellit	<p><b>Situata 5.1:</b> Gjatë vitit, stinët i lënë vendin njëra-tjetrës. Duke qenë se i njohim karakteristikat e secilës stinë, planifikojmë edhe punët, pushimet apo mënyrën e të veshurit, për t'u përshtatur me to. Por, a e dini si formohen stinët?</p>			
6.			6. Punë praktike 1.1 Tema: Vendi i Tokës në Sistemin Diellor. Rrotullimi diellor, qarkullimi vjetor dhe pasojat që rrjedhin për planetin tonë	<p><b>Situata 5.2:</b> Me anë të një topi (që përfaqëson Tokën) dhe të një elektriku dore (që përfaqëson Diellin), vepro si në figurën përbri.</p> 			
7.			7. Përsëritje 1 (Toka në hapësirë)	<p>Trego se si ndriçohet Toka në stinë të ndryshme. Analizo se çfarë ndodh në secilën prej hemisferave të Tokës më: 22 Qershor, 22 Dhjetor 21 Mars dhe 23 Shtator.</p>			




Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve në sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
8.			8-Testim 1 (Toka në hapësirë)	<p><b>Situata 6.1:</b> Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi shkaktuesit e atmosferës dhe ndryshimet klimatike. Çfarë kuptoni me konceptin atmosferë? A është ajo e domosdoshme për jetën në Tokë?</p> <p><b>Situata 6.2:</b> Trego përmes disa shembujve, rëndësinë që ka oksigjeni për botën e gjallë në planetin tonë.</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;</p>		
	9.		9. Atmosfera. Përbërja e saj				
10.	Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Modelon strukturën vertikale të atmosferës duke përdorur informacion nga burime të ndryshme të të nxënësve.</li> <li>Dallon brezat e nxehtësisë dhe rëndësinë e rrezatimit diellor, si</li> </ul>	10. Struktura e atmosferës	<p><b>Situata 7:</b> Deri në çfarë lartësie shkon atmosfera? Si mendoni, a është ajo njësoj e dendur dhe me të njëjtat temperatura si pranë sipërfaqes së Tokës, ashtu edhe në lartësi?</p> <p><b>Situata 8.1:</b> Çfarë roli luan energjia diellore për jetën në planetin tonë?</p> <p><b>Situata 8.2:</b> Përshkruaj figurën 6 për të treguar ndikimin e formës së Tokës në sasinë e rrezatimit diellor që marrin zona të ndryshme të saj, në gjerësi të ndryshme gjeografike.</p>	<p>Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;</p>		
	11.		Nëntematika II: Hartat gjeografike (12 orë)	11. Rrezatimi diellor dhe rëndësia e tij			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
12.		<p>rrezatimi bazë për planetin tonë.</p> <p><b>Përshkruan:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkaqet dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë;</li> <li>• ndikimin e saj në qarkullimin e rrymave oqeanike dhe erëtrave.</li> </ul>	<p><b>12. Faktoret dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë</b></p>	 <p>Situata 9: Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi formën e Tokës dhe qarkullimin e saj rreth Diellit. Pse sasia e rrezatimit diellor që vjen në sipërfaqen e Tokës varet nga forma e saj sferike dhe nga koha e ekspozimit kundrejt Diellit?</p>			
13.		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sjell shembuj si modelet globale ndikojnë mikroklimën (p.sh., rryma e Golfstrimit pasojat në klimën e Evropës veriperëndimore);</li> <li>• Shpjegon marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës</li> </ul>	<p><b>13. Moti</b></p>	<p>Situata 10.1: Pothuajse çdo ditë interesohemi të dimë se si është dhe si do të jetë moti ditën tjetër në vendin ku jetojmë. Krugët nga mund ta marrim informacionin janë të ndryshme: televizioni, radioja, interneti, telefonat tanë celularë. Bazuar në të dhënat e mëposhtme, përshkruajmë ndryshimet e motit gjatë 24 orëve të datës 3 janar. Cilat elemente të motit kanë ndryshuar më tepër? A kanë lidhje ato midis tyre?</p> <p>Situata 10.2: Përshkruaj se si paraqitet moti në veri, në lindje, në jug dhe në perëndim të Shqipërisë.</p> <p>Situata 10.3: Vëzhgo kushtet e motit përgjatë</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
14.		<p>ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor:</li> <li>• instrumentet për matjen e temperaturës së ajrit, shtypjes atmosferike, lagështirës dhe përcaktimin e drejtimit të erës, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin;</li> <li>• harta sinoptike për të bërë parashikime të motit.</li> <li>• Përkruan klimën si rezultat i mod-eleve afatgjatë</li> </ul>	<p><b>14. Punë praktike 2.1 Tema: Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta nga nxënësit, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin (ora e parë)</b></p>	<p>javës në të cilën je dhe përshkruaj elementet e tij (vendos edhe shenjat konvencionale përkatëse), si në modelin e paraqitur në tabelë.</p>			
15.		<p>shtypjes atmosferike, lagështirës dhe përcaktimin e drejtimit të erës, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• harta sinoptike për të bërë parashikime të motit.</li> <li>• Përkruan klimën si rezultat i mod-eleve afatgjatë</li> </ul>	<p><b>15. Punë praktike 2.1 Tema: Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta nga nxënësit, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin (ora e dytë)</b></p>				

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
16.		<p>të temperaturës, reshjeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon:</li> <li>• faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;</li> <li>• zonat kryesore klimatike në hartë.</li> <li>• Ndërtton dhe interpreton grafikë klimatikë për zona të ndryshme.</li> <li>• Argumenton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi ) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serë).</li> </ul>	<p><b>16. Punë praktike 2.2 Tema: Parashikimi i motit përmes leximit të hartave sinoptike dhe nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të thjeshta</b></p>				
17.		<p><b>17. Klima</b></p>	<p><b>Situata 11.1:</b> Klima e vendit tonë ka tipare të ndryshme nga ajo e shumë vendeve të tjera, që ndodhen pranë apo larg nesh (risjellim në vëmendje se çfarë veçorish ka klima e Shqipërisë dhe e vendbanimit tonë). Si mendoni, cilët mund të jenë faktorët që ndikojnë në klimën e një vendi?</p> <p><b>Situata 11.2:</b> Përshkruaj se si ndikon relievi në klimën e vendit ku t'i jeton.</p>				

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
18.			<p><b>18. Klima (vazhdim)</b></p>	<p><b>Situata 12.1:</b> Në mësimin e mëparshëm, trajtuam disa prej faktorëve që ndikojnë mbi klimën e një vendi. Përveç tyre, mësuar që mbi klimë ndikojnë edhe rrymat oqeanike/detare, afërsia me sipërfaqet ujore, bimësia, veprimtaria njerëzore. Si mendoni, cili prej këtyre faktorëve ndikon më tepër në klimën e vendit tonë? Po në klimën e vendbanimit tuaj?</p> <p><b>Situata 12.2:</b> Bazuar në hartën e mëposhtme të zonave klimatike: a) evidento llojet e klimave në brigjet e kontinenteve dhe në brendësi të tyre; në Ekuator, në gjerësitë mesatare, në gjerësitë polare, si dhe në zonat mallore. Vrojto gjithashtu klimat në Gadishullin Skandinav.</p> <p>b) përcakto se cilët faktorë ndikojnë në llojshmërinë e klimave në botë.</p>			
19.			<p><b>19. Njeriu dhe ndryshimet klimatike</b></p>	<p><b>Situata 13.1:</b> Risjellim në vëmendje çfarë kemi mësuar mbi rëndësinë e atmosferës. Në Tokë do të kishte diferenca të mëdha midis temperaturave të ditës dhe të natës, nëse nuk do të ishte atmosfera. Ajo e mban nxehtësinë</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënë- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënëit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
19.			<p>19. Njeriu dhe ndryshimet klimatike</p>	<p>konstante, duke e qarkulluar atë nga njëri vend te tjetri. Disa shtresa të saj veprojnë si një filter për rrezet diellore. Cilat janë këto shtresa? Si dhe sa ndikon rrezatimi diellor mbi klimë? Po klima si ndikon mbi jetën tonë?</p> <p><b>Situata 13.2:</b> Diskuto rreth pasojave që sjellin ndryshimet klimatike në jetën tonë dhe në planet. Veço prej tyre, disa nga pasojat që janë të pranishme në vendbanimin tënd.</p>			
20.			<p>20. Zonat klimatike</p>	<p>Situata 14.1: Siç e dimë, rrezatimi diellor shpërndahet në mënyrë të pabarabartë mbi sipërfaqen e Tokës. Kjo bën që në planetin tonë të formohen brezat (zonat) e nxehtësisë. Cilët janë ata? Sipas jush, çfarë klime kanë?</p> <p>Situata 14.2: Bazuar në figurat 22 dhe 23, përshkruani mjedisin që krijohet në kushtet e klimës mesatare mesdhetare dhe klimës polare.</p> 			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
21.			<p>21. Punë praktike 2.3 Tema: Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas brezave të nxehsësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve klimatikë për vende të ndryshme në to. (ora e parë)</p>				
22.			<p>22. Punë praktike 2.3 Tema: Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas brezave të nxehsësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve klimatikë për vende të ndryshme në to. (ora e dytë)</p>				

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënë- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënërit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
23.			23. Përsëritje 2 (Atmosfera)				
24.			24. Testim 2 (Atmosfera)				



- **PLANI 3-MUJOR (JANAR-MARS -26 orë); KLASA VII**
- **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
- LËNDA: GJEOGRAFI 7**

### **Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe**

#### **1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)**

- Shpreh mendimin e vet për: lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën; veçoritë dhe lëvizjet e ujit të deteve dhe oqeaneve; ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përfshiruar veçoritë kryesore për secilën shtresë; klasifikimin e shkëmbinjtve sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë; për faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave etj.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët për to, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm) kuptimin e termave: hidrosferë, litosferë, atmosferë, biosferë, valë detare, rryma oqeanike, baticë/zbaticë, elemente përbërëse të lumit, liqen, burime, borë dhe akuj, shkëmbinjt sedimentarë, metamorfikë e vullkanikë, dhera.

#### **2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)**

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati (p.sh mbi: rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi ) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serë); mbi rolin e deteve, liqeneve, lumenjve dhe burimeve; veçoritë kryesore të secilës shtresë të Tokës.)
- Zgjidh një problem dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse (p.sh vëzhgon në zonën qytetin/fshatin e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.
- Ndërton argumente, p.sh. mbi pasojat që sjellin ndryshimet klimatike në jetën tonë dhe në planet. Veçon prej tyre, disa nga pasojat që janë të pranishme në vendin ku jeton.
- Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë (si p.sh., skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe përfshiruan rolin e tyre në klimën e rajoneve që përfshojnë).
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet: midis shtresave që përbëjnë Tokën në brendësi; midis llojeve të shkëmbinjtve etj.

- Interpreton përmbajtjen e hartave të ndryshme: të lumenjve, të liqeneve, të shpërndarjes së botës bimore, etj. duke e ilustruar me shembuj konkretë..
- 3. Kompetenca e të nxënësve (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)**
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, harta të ndryshme, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrave të dhëna.
  - Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve: Ndërton dhe interpreton grafikë klimatike, të nivelit të ujërave në lumenj, etj, ndërton makete të ndryshme të vullkaneve, tërmetejeve, kufijve të pllakave tektonike etj.
  - Argumenton rëndësinë e faktorëve të brendshëm në formimin e tërmetejeve, vullkaneve, shkëmbinjve të ndryshëm, liqeneve, etj.
  - Interpreton lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën;
  - Identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia) dhe bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve (valëve detare, rrymave oqeanike; baticë/ zbaticeave) dhe faktorëve që ndikojnë:
  - Përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis.
  - Modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.
  - Klasifikon shkëmbinj të sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë.
  - Identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave etj.
  - Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë ose për të realizuar një detyrë që i kërkohet.
  - Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit, sipas një radhitjeje logjike.
  - Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për tematikën që trajtohet/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
  - Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët si p.sh. heton për një çështje mjedisore që lidhet me ujërat (p.sh., erozioni lumor, tharja e liqenit artificial etj.) në zonën e tij duke identifikuar problemin, përcaktuar faktorët e mundshëm që e shkaktajnë, ofruar zgjidhje dhe vlerësuar përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- Identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshme, elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve dhe përcakton drejtimit kryesorë të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës dhe në atë të Shqipërisë;
- Krahason liqenat me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vendndodhjen e tyre në hartë;
- Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerren pa dëmtoar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh. organizimin e informacioneve të siguruara nga interneti duke i përmbledhur në tabela ose grafike).

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës**

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja:

- Përcakton drejtimit kryesorë të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës dhe në hartën e Shqipërisë.
- Krahason liqenat me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vendndodhjen e tyre në hartë.

- Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.
- Heton për një çështje mjedisore që lidhet me ujërat (p.sh., erozioni lumor, tharja e liqenit artificial etj.) në zonën e tij duke ofruar zgjidhje dhe vlerësuar përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme.
- Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza.
- Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë në formimin e tërmeteve, të vullkaneve, të valëve, të baticë/zbaticave etj.

## 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim (p.sh. identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia) dhe bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve duke krahasuar faktorët që ndikojnë; identifikon bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm, elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve duke diskutuar mbi to; etj
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, fotove etj., duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

## 3. Marrja e vendimeve


Nxënësi:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç, p.sh. nivelin e ndofjes në ujërat e vendbanimit të tij.
- Nxënësi/ja identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.

Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.

**JANAR-MARS (26 orë)**

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
26.	Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore	Nxënësi: • Interpretim lidhur me hidrosferën e litosferën, atmosferën, biosferën; • Identifikim veçoritë e ujërave të deteve dhe oqeanëve (temperatura, kripësia, dendësia); • Bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeanëve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë.	<b>1. Projekt (ora e parë)</b> Tema: <b>Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim</b>	<b>Situata 15:</b> Në mësimin e parë të Gjeografisë mësuam se në planetin tonë, uji është i pranishëm në të gjitha format e ujit, për shkak të atmosferës dhe distancës Tokë-Diell. Si mendoni, a mund të shpërtojë uji ndonjëherë? Jepni disa shembuj.	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare;	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i punës praktike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë; -Vlerësim i ese-ve;	Teksti i gjeografisë Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës. Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës. Materiale nga interneti, libra, enciklopedi
			<b>2. Cikll i ujit</b>				
27.	Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore	• Identifikim veçoritë e ujërave të deteve dhe oqeanëve (temperatura, kripësia, dendësia); • Bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeanëve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë.	<b>3. Veçoritë e ujërave të deteve dhe oqeanëve</b>	<b>Situata 16:</b> Plotësojmë në hartën skicë të mëposhtme oqeanet e botës dhe përshkruajmë se midis cilave kontinente ndodhen. Siç e shohim, ato duket si një tërësi ujore që rrethon kontinentet. Si mendoni, a kanë të gjitha oqeanet të njëjtën kripësi, dendësi dhe temperaturë të ujit?	Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme; Përdorimi TIK; Projekte kurrikulare;	-Vlerësim i detyrës së shtëpisë;	Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.
			<b>4. Lëvizjet e ujërave oqeanikë. Valët detare</b>				
28.	Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (54)	• Bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeanëve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë.	<b>5. Baticat dhe zbatat</b>	<b>Situata 17:</b> Gjatë pushimeve në bregdet, kemi vënë re se deti herë është i qetë e herë me dallgëzime të vogla ose të mëdha. Në figurën e mëposhtme, deti paraqitet i dallgëzuar. Si mendoni, nga se formohen këto dallgëzime?	Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;	-Vlerësim me shkrim;	Materiale nga interneti, libra, enciklopedi
			<b>6. Rrymat oqeanike</b>				
29.							
30.							



Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
31.		<ul style="list-style-type: none"> <li>• baticat dhe zbaticat</li> <li>• Skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike</li> </ul>	<p>7. Punë praktike</p> <p>2.4 Tema: Skicimi në hartë i rrugës që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe evidentimi i rolit që ato kanë mbi klimën e rajoneve që përshkojnë.</p>	<p><b>Situata 18.1:</b> Nëse jemi të vëmendshëm, në ditët e pushimeve mund të vëmë re që gjatë 24 orëve, niveli i ujit në bregun e detit ndryshon. Kjo mund të dallohet qartë, sidomos kur ndodhemi pranë ndonjë moli apo trampoline. Në mëngjes herët dhe pasdite, kolonat e molit e të trampolinës dallohen lehtësisht, ndërsa në mesditë uji mbulon një pjesë të madhe të tyre. Këtë ndryshim mund ta vëmë re edhe nëse kemi zgjedhur të qëndrojmë nën një çadër pranë bregut. Në mesditë, uji mund të na vijë deri te çadra. A e dini se pse ndodh ky ndryshim i nivelit të ujit në bregdet?</p>			Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video
32.		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe përshkruan rolin e tyre në klimën e rajoneve që përshkojnë.</li> </ul>	<p>8. Lumenjtë dhe pjesët përbërëse të tij</p>	<p><b>Situata 18.2:</b> Le të shohim pamjet (a) dhe (b) të figurës 30, që paraqesin të njëjtën pjesë të bregdetit. Në pamjen (a), që është fotografuar në mëngjes (në orën 6), deti ka përparuar drejt tokës. Ndërsa në pamjen (b), të fotografuar në mesditë, deti është tërhequr nga bregu.</p> <p><b>Situata 19:</b> Risjellim në vëmendje informacionet mbi rrugën që përshkon</p>			Materiale të përgatitura me power point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
				<p>rryma e Golfstrimit dhe për ndikimet e saj në klimën e vendeve pranë të cilave kalon. Përveç kësaj rryme ka edhe shumë të tjera që ndikojnë ndjeshëm në klimën e vendeve të ndryshme. Një pjesë e tyre sjell rritje të temperaturave, ndërsa disa të tjera i ulin ato. Por, pse formohen dhe lëvizin rrymat oqeanike?</p> <p><b>Situata 20:</b></p> <p>Dikush mund të banojë pranë një lumi, një tjetër e ka parë gjatë udhëtimeve, në emisione televizive apo filma; dikush mund të ketë pushuar pranë tij; një tjetër mund të ketë parë se nga buron apo ku derdhet një lumë.</p> <p>Gjithashtu, në harta kemi parë shtrirjen e lumenjve të ndryshëm. Bazuar në këto njohuri dhe me ndihmën e hartës fizike, përshkruajmë së bashku se çfarë është lumi dhe nga se përbëhet ai.</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
33.		<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm, elementet përbërëse të lumenjve dhe llojet e lumenjve.</li> <li>Përcakton drejtimet kryesore të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës dhe Shqipërisë.</li> <li>Krahason liqen- et me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vend- dodhjen e tyre në hartë.</li> </ul>	<p><b>9. Punë praktike</b>  <b>2.5 Tema: Elementet përbërëse të lumenjve dhe llojet e lumenjve</b></p>	<p><b>Situata 21.1:</b> Dikush mund të banojë pranë një lumi, një tjetër e ka parë gratë udhëtimeve, në emisione televizive apo film; dikush mund të ketë pushuar pranë tij; një tjetër mund të ketë parë se nga buron apo ku derdhet një lumë.</p> <p>Gjithashtu, në harta kemi parë shtrirjen e lumenjve të ndryshëm. Bazuar në këto njohuri dhe me ndihmën e hartës fizike, përshkruajmë së bashku se çfarë është lumi dhe nga se përbëhet ai.</p> <p><b>Situata 21.2:</b> Bazuar në figurën 34 (a dhe b), përshkruaj veçoritë e secilit prej lumenjve.</p> <p><b>Situata 22.1:</b> Përgjatë rrugës që përshkon, lumi krijon relievin e tij. Përshkruajmë së bashku veçoritë e këtij relievi. A e dimi si krijohen format karakteristike të relievit lumor?</p> <p><b>Situata 22.2:</b> Bazuar në figurën 36, përcakto elementet përbërëse të lumenjve dhe përshkruaj</p>	<p>Punë në grup;</p> <p>Punë në dyshe;</p> <p>Punë individuale;</p> <p>Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;</p> <p>Përdorimi TIK;</p> <p>Projekt kurrikular;</p> <p>Hulumtim dhe zbulim;</p> <p>Brainstorming;</p> <p>Diskutime;</p> <p>Debat; Konkurs;</p>		
34.			<p><b>10. Punë praktike</b>  <b>2.6 Tema: Përcaktimi i drejtimeve kryesore të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës</b></p>				



Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
35.			<b>11. Veprimtaria e lumenjve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• format e luginave</li> <li>• që formohen në</li> <li>• pjesë të ndryshme</li> <li>• të tij.</li> </ul>			
36.			<b>12. Liqenet dhe llo- jet e tyre</b>	<b>Situata 23:</b> Vendi ynë ka dalje të gjerë në det, si dhe liqene mjaft të thella, me sipërfaqe të mëdha. Kështu, kushdo prej nesh mund të pushojë në bregdet apo pranë një liqeni. Ashtu si detet, edhe liqenet e zbutin klimën dhe na ofrojnë peshk shumë të mirë. Kur jemi pranë një liqeni, natyrshëm mund të na lindë pyet-ja: si është formuar ai?			
37.		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.</li> <li>• Përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe</li> </ul>	<b>13. Punë praktike</b> <b>2.7 Tema: Liqenet në Shqipëri</b>				

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
38.		<p>veprimin e tyre në mjedis.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Heton për një çështje mjedisore që lidhet me ujërat (p.sh., erozioni lumor, tharja e liqenit artificial etj.) në zonën e tij:</li> <li>identifikon problemin;</li> <li>përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë;</li> <li>ofron zgjidhje;</li> <li>vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme.</li> <li>Modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përkrahur veçoritë</li> </ul>	<p><b>14. Burimet dhe përdorimi i tyre</b></p>	<p><b>Situata 24:</b> Përshkruajmë figurën e paraqitur. Bazuar në idenë që përcjell ajo dhe në informacionet që kemi, evidentojmë së bashku disa prej burimeve ujore që ndodhen në Shqipëri ose pranë vendbanimit tonë. A e dimi se ç'loj burimesh janë? Si janë formuar?</p>			
39.		<ul style="list-style-type: none"> <li>identifikon problemin;</li> <li>përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë;</li> <li>ofron zgjidhje;</li> <li>vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme.</li> </ul>	<p><b>15. Punë praktike</b> <b>2.8 Tema: Burimet në vendbanimin tim dhe përdorimi i tyre</b></p>				
40.		<ul style="list-style-type: none"> <li>Modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përkrahur veçoritë</li> </ul>	<p><b>16. Bora dhe akujt</b></p>	<p><b>Situata 25:</b> Gjatë stinës së dimrit, një pjesë e popullsisë që jeton në zonat malore të vendit tonë, përballet me vështirësi të mëdha qarkullimi, për shkak të reshjeve të mëdha të dëborës dhe ngricave. Në lartësi më të mëdha, disa maja malesh zbardhin nga bora e akujt edhe gjatë verës, pra në mënyrë të përhershme. A e dimi pse ndodh kështu? Si formohen akujt dhe bora e përhershme?</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
41.			17. Përsëritje 3 (Hidrosfera)				
42.		kryesore për secilën shtresë. • Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë. • Identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.	18. Projekt (ora e dytë) Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim				
43.			19. Ndërtimi i brendshëm i Tokës	<b>Situata 26:</b> Dimë që Toka, si pjesë e grupit të planetëve të brendshëm, është një trup shkëmbor që përbëhet prej elementeve të rënda (alumin, silic, nikel, hekur, krom etj). Në sipërfaqe, ne e shohim atë si një trup të ngurtë. Bazuar në informacionet dhe përfytyrimet tuaja, si mendoni, është ajo njësoj e ngurtë deri në qendrën e saj?			
44.			20. Llojet e shkëmbinjve dhe shkëmbinjtë sedimentarë	<b>Situata 27:</b> Mësuam që çdo shtresë e Tokës është e përbërë nga shkëmbinj të ndryshëm. Në sipërfaqen e saj arrijmë të shohim vetëm disa prej tyre (kryesisht në zonat ku vepron erozioni, mungon bimësia apo ka çarje të relievit), pasi pjesa më e madhe e shkëmbinjve është e			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
				<p>mbuluar nga dherat, bimësia, ujërat apo ndërtimet. Figurat e mëposhtme paraqesin dy mjedise shkëmbore.</p> <p>Përshkruajmë përmbajtjen e secilit prej tyre dhe sjellim shembuj të ngjashëm nga mjedise shkëmbore që njohim apo shohim rreth nesh. Si janë ndërtuar ato?</p>			
45.			<p><b>21. Shkëmbinj të magmatikë</b></p>	<p><b>Situata 28:</b> Risjellim në vëmendje se çfarë ndodh në mantelin e Tokës, ku mendohet që ka vatrën pjesa më e madhe e vullkaneve. Bazuar në njohuritë që keni mbi vullkanet, si mendoni, nga shpërthimi dhe ftohja e tyre, a ndodhin ndryshime në sipërfaqen e Tokës?</p>			
46.			<p><b>22. Shkëmbinj të metamorfikë</b></p>	<p><b>Situata 29:</b> Mermeri është një material që përdoret shpesh për ndërtimin apo zbukurimin e objekteve të ndryshme, p.sh.: statuja, shkallë banesash, parrmakë dritarësh, fasada ndërtesash etj. Në të gjitha këto raste është përdorur mermeri i përpunuar (pllaka ose copa të mëdha mermeri). Si mendoni, në ç'forma dhe madhësi gjendet ai në natyrë?</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
47.			<p><b>23. Rëndësia e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralët) për shoqërinë</b></p>	<p><b>Situata 30.1:</b> Dimë që nëntoka shqiptare është e pasur me minerale. Listojmë disa prej tyre dhe përshkruajmë ku ndodhen e përse përdoren.</p> <p><b>Situata 30.2:</b> Bazuar në modelin e paraqitur më sipër (fig. 59), jep shembuj të tjerë shkëmbinjsh të zonës ku banon dhe përshkruaj përdorimet e tyre.</p>			
48.			<p><b>24. Dherat</b></p>	<p><b>Situata 31:</b> Në figurë është paraqitur preja tërthore e një lloj toke. Përshkruajmë se çfarë veçorish (trashësia, ngjyra, dendësia, përmasat e copave që e përbëjnë) dallojmë nga sipërfaqja e saj deri në thellësi.</p>			
49.			<p><b>25. Përsëritje 4 (Litosfera 1)</b></p>				
50.			<p><b>26. Testim 3 (Hidrosfera dhe Litosfera 1)</b></p>				

- **PLANI 3-MUJOR (PRILL – QERSHOR 20 orë); KLASA VII**
- **FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**
- LËNDA: GJEOGRAFI 7**

### **Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe**

#### **1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)**

- Shpreh mendimin e vet, me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit mbi: proceset historike që kanë kontribuar në format e Tokës; lëvizjet e kontinenteve përgjatë kohërave, faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nëhtësisë; mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota.; ndërvarësinë globale të ndikimeve mjedisore (p.sh., transferimi i ndoijes).
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm) kuptimin e termave: pllaka tektonike, fusha, kodra, male, ndërvarësi globale e ndikimeve mjedisore, etj.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, harta, foto, etj., komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim.

#### **2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese)**

- Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (p.sh. ndotjen në ujëra).
- Interpreton të dhëna të ndryshme mbi pasurinë ujore, klimën, botën e gjallë, popullimin, aktivitetet prodhuese dhe llojin e vendbanimit, trashëgiminë natyrore e kulturore të tij, si dhe mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin lokal.
- Krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e lëvizjeve të ngadalta (p.sh. formimi i maleve) dhe proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet).

#### **3. Kompetenca e të nxënimit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, të dhëna të marra nga publikime të qeverisjes vendore, enciklopedi, internet,

ose vëzhgime në terren), të cilat i shfrytëzojnë për realizimin e projektit kurrikular dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

- Shfrytëzojnë të dhënat për të demonstruar të kuptuarit (nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit) mbi: format kryesore të relievit të kontinenteve; ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e lëvizjeve të ngadalta (p.sh. formimi i maleve) dhe proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet); faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë; problematikat e krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve; etj.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga burimet e përdorura për detyrën që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhë logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për tematikë që trajtohet/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

#### **4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët si p.sh. heton për një çështje mjedisore që lidhet me ujërat (p.sh., erozioni lumor, tharja e liqenit artificial etj.) në zonën e tij duke identifikuar problemin, përcaktuar faktorët e mundshëm që e shkaktojnë, ofruar zgjidhje dhe vlerësuar përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- Duke zhvilluar projektin kurrikular, realizon edhe shërbime në ndihmë të përmirësimit të mjedisit të komunitetit të tij;
- Diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota.
- Heton disa ndërproblematikat e krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve (p.sh., ndërtime të shumta dhe pa kriter, mungesa e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza etj.)-në një zonë bregdetare, në një qendër urbane, në një zonë rurale
- Vlerëson ndërvarësinë globale të ndikimeve mjedisore (p.sh., transferimi i ndotjes).
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e banorëve dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.

### 5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

### 6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerren pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

### 7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja:

- Formulon dhe drejton pyetje mbi: format kryesore të relievit të kontinenteve; proceset historike që kanë kontribuar në format e tokës (lëvizjet e kontinenteve përgjatë kohërave; pllakat tektonike);
- Spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij;
- Heton disa ndërproblematikat e krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve (p.sh., ndërtimet e shumta dhe pa kriter, mungesa e kanalizimeve dhe trajtimet të ujërave të zeza etj)-në një zonë bregdetare, në një qendër urbane, në një zonë rurale;
- Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në mjedisin lokal;
- Identifikon në hartë vendet me lartësi absolute të ndryshme;



- Diferencon format kryesore të relievit të kontinenteve dhe bën dallimin e tyre në hartë;
- Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.

## 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja:

- Identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
- Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe proceset e dukuritë gjeografike në gjeosistem, duke përdorur mjettet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren, fotografi, etj.
- Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik;
- Krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e lëvizjeve të ngadalta (p.sh. formimi i maleve) dhe proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet);
- Vlerëson ndërvarësinë globale të ndikimeve mjedisore (p.sh., transferimi i ndofjes).

## 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja:

- Sintetizon të dhënat dhe zhvillon një përfundim, p.sh., një parashikim apo një gjetje kyç.
- Nxënësi/jaidentifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to.
- Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet”.

<b>PRILL-QERSHOR (20 orë)</b>							
Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
51.		Nxënësi/ja: • Argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për shoqërinë.	1. Historia e Tokës 2. Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike 3. Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre	<b>Situata 32.1:</b> Rikujtojmë çfarë kemi mësuar mbi vendin që zë Toka në sistemin diellor dhe diskutojmë mbi pyejet: Kur është formuar Toka? Pse ndryshon ajo nga planetet e tjerë të sistemit diellor?	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedime e prezantime në forma të ndryshme;	-Vlerësim me gojë; -Vlerësim i punës në grup; -Vlerësim i fiziko-gjeografike dhe politike; -Vlerësim i detyrës së shtëpisë;	Teksti i gjeografisë Hartat
52.							
53.	Tematika: Proceset natyrore dhe shoqërore		4. Tërmetet 5. Vullkanet	<b>Situata 32.2:</b> Bazuar në skemën e paraqitur: a) përshkruaj ndryshimet që vëren nga një periudhë të tjetra gjatë erës kenozoike; b) evidento dy prej ngjarjeve më të rëndësishme të erës paleozoike dhe asaj mesozoike.			Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të botës.
54.							
55.							
56.	Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë (vazhdim)		6. Format e relievit 7. Bota bimore	<b>Situata 33:</b> Risjellim në vëmendje ndërtimin strukturor të Tokës dhe përshkruajmë çfarë janë litosfera dhe astenosfera.	Hulumtim dhe zbulim; Brainstorming; Diskutime; Debat; Konkurs; Lojë me role;	Hartat fiziko-gjeografike dhe politike të Evropës.	
57.							
58.			8. Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore	<b>Situata 34:</b> Sjellim edhe një herë në vëmendje ndërtimin e kores së Tokës; kuptimin mbi pllakat tektonike dhe kufijtë midis tyre. Përshkruajmë çfarë janë: korja kontinentale dhe ajo oqeanike, pllakat tektonike dhe kufijtë midis tyre. Mësuam që pllakat tektonike lëvizin, por, a e dini pse?			
59.			9. Bota shtazore				

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
60.		<p>tyre në hartë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon në hartë vendet me lartësi absolute të ndryshme.</li> </ul>	<p><b>10. Punë praktike</b>  <b>2.9 Tema: Bota e gjallë sipas brezave të nxehëtisë</b></p>	<p>Çfarë ndodh në kufijtë e pllakave tektonike?  <b>Situata 35.1:</b> Le të shohim në tabelën mbi pasojat e tërmetit të rënë në Porto Princ të Haitit, në vitin 2010. Nga informacionet që mund të keni për tërmetet që kanë rënë në vendin tonë, sillini shembuj rreth pasojave të tyre.</p> <p><b>Situata 35.2:</b> Bazuar në hartën e figurës 70, trego se në cilët kufij pllakash është përqendruar pjesa më e madhe e tërmeteve në botë.</p> <p><b>Situata 36.1:</b> Rikujtojmë njohuritë që kemi marrë mbi shkëmbinjtë magmatikë dhe përshkruajmë se si formohen ata. Po magma dhe llava, çfarë janë? Pse ndryshojnë midis tyre?</p> <p><b>Situata 36.2:</b> Bazuar në hartën e figurës 73, trego se në cilët kufij pllakash është përqendruar pjesa më e madhe e vullkaneve në botë.</p>			<p>Materiale nga interneti, libra, enciklopedi</p> <p>Tekste nga fusha të tjera; foto, harta, video</p> <p>Materiale të përgatitura me Power point dhe në programe të tjera, të krijuara nga mësuesit/et dhe nxënësit.</p>
			<p><b>11. Përsëritje 4 (Litosfera 2)</b></p>				
61.		<ul style="list-style-type: none"> <li>Krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e lëvizjeve të ngadalta (p.sh. formimi i maleve) dhe proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet).</li> <li>Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</li> </ul>					
62.			<p><b>11. Përsëritje 4 (Litosfera 2)</b></p>				

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
		<ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul>		<p><b>Situata 37:</b> Nga teksti i Gjeografisë 6, rikujtojmë se çfarë janë mjediset natyrore. Krahasojmë mjediset natyrore të paraqitura në figurat e mëposhtme (a, b, c) dhe përshkruajmë se cilat elemente natyrore mbizotërojnë te secili prej tyre.</p> <p><b>Situata 38:</b> Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi brezat e nxehtësisë, duke përshkruar veçoritë e klimës në këta breza dhe si ndikon ajo në zhvillimin dhe shpërndarjen e botës bimore.</p> <p><b>Situata 39.1:</b> Bazuar në njohuritë që kemi, ne mund të evidentojmë disa nga faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe në shumëllojshmërinë e saj. Cilët janë ata?</p> <p><b>Situata 39.2:</b> Përshkruaj se çfarë ndikimi ka mbi bimësinë komuniteti në vendbanimin tënd.</p> <p><b>Situata 40.1:</b> Shohim hartën e mëposhtme dhe përshkruajmë se si janë shpërndarë disa prej llojeve të botës shtazore në planet. Bazuar në njohuritë e marra ose</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
62.			12. Testim 4 (Litosfera 2)	në kuriozitetet që mund të keni lexuar mbi botën e kafshëve, përmendni edhe shembuj të tjerë (mbi vendndodhjen dhe jetën e tyre). Si mendoni, pse bota shtazore është e larmishme dhe e shpërndarë në botë në mënyrë të pabarabartë? <b>Situata 40.2:</b> Bazuar në fig. 87 dhe 88, përkrahuj ndryshimet që vëren midis llojeve të botës shtazore të zonës së nxehtë dhe atyre të zonës së ftohtë.			
63.		Nxënësi: • Diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota. • Heton disa ndërproblematikat e	13. Projekt ora e tretë Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim				
64.			14. Potencialet e zonave bregdetare	<b>Situata 41.1:</b> Shihni me kujdes fotot e mëposhtme dhe krahasoni ndryshimet midis tyre. Në cilin prej bregdeteve të paraqitura dalloni elemente të ngjashme me bregdetet e vendit tonë, të cilat i kemi parë			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxënësve në sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
65.		<p>krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve (p.sh., ndërtimet e shumta dhe pa kriter, mungesa e kanalizimeve dhe trajtimin të ujërave të zeza etj):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• në një zonë bregdetare;</li> <li>• në një qendër urbane;</li> <li>• në një zonë rurale</li> </ul>	<p><b>15. Ndotjet në zonat bregdetare</b></p>	<p>apo keni pushuar në to? Si mendoni, çfarë rëndësie kanë zonat bregdetare për jetën dhe ekonominë tonë?</p> <p><b>Situata 41.2:</b> Përshkruaj veprimtaritë ekonomike në figurat 2, 3 dhe 4, dhe evidento se sa të pranishme janë ato në zonat bregdetare të vendit tonë.</p> <p><b>Situata 42:</b> Mësuam se zonat bregdetare përbëjnë hapësira me potenciale të mëdha turistike dhe ekonomike për vendet ku gjenden. Për vetë kushtet që ofrojnë, në këto zona është përqendruar një numër i lartë popullsie. Por, a dëmtohet dhe ndotet mjedisi bregdetar prej veprimtarive ekonomike dhe mbipopullimit? Çfarë ndotjesh mund të shkaktohen?</p>			
66.		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson ndërvarësinë globale të ndikimeve mjedisore (p.sh., transferimi i ndotjes).</li> </ul>	<p><b>17. Ndotja në qendrat urbane</b></p>	<p><b>Situata 44:</b> Si e paraqytroni qytetin ku do të donit të jetonit: me parqe dhe hapësira të gjera, godina të vjetra antike apo historike të ruajtura me kujdes, blloqe ndërtesash të ulëta, të ndërtuara me planimetri, apo me ndërtesa të larta dhe shumë pranë njëra-tjetrës? Si mund të jetë gjendja e trafikut të automjeteve dhe shkalla e ndotjes në të?</p>			

Nr.	Tematika/ Nëntematika	Rezultatet e të nxën- nit sipas tematikave	Temat mësimore	Situata e të nxën- nit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
67.			17. Ndotja në qendrat urbane	<b>Situata 44:</b> Si e parafytyroni qytetin ku do të donit të jetonit: me parqe dhe hapësira të gjera, godina të vjetra antike apo historike të ruajtura me kujdes, blloqe ndërtesash të ulëta, të ndërtuara me planimetri, apo me ndërtesa të larta dhe shumë pranë njëra-tjetrës? Si mund të jetë gjendja e trafikut të automjeteve dhe shkalla e ndotjes në të?			
68.			18. Ndotja në qendrat urbane (vazhdim)	<b>Situata 45:</b> Pranë lumenjve janë përqendruar qytete të rëndësishme të botës. Edhe qytetërimet e para kanë lindur për gjatë rrjedhave të tyre. Por, paralelisht me zhvillimin dhe rritjen e qyteteve, shoqëria njerëzore ka shkaktuar ndotje të shumë lumenjve. Si mendoni, nga se ndoten lumenjtë dhe tokat e qyteteve?			
69.			19. Ndotja në qendrat rurale	<b>Situata 46:</b> Problematika e ndotjes nuk ndeshet vetëm në qytete, ajo është e pranishme edhe në fshatra. Nga njëohuri të që keni, si mendoni, nga se shkaktohet ndotja në zonat rurale?			
70.			20. Projekt (ora e katërt) Tema: Çështjet mjedisore të ujërave në/pranë vendbanimit tim				

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE (modele skematike)

**Shënim:** Edhe pse në planifikimet e mëposhtme ditore të orëve mësimore janë paraqitur për çdo orë, rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe, nuk është detyrim që brenda një ore mësimore ato të realizohen të gjitha (të shtata kompetencat), por vetëm disa prej tyre. Paraqitja e plotë e tyre në çdo orë mësimore është bërë:

- për shkak të respektimit të formatit të një ore mësimore;
- me qëllim paraqitjen në të, të çdo detaji që do të ndihmonte në orientimin e punës së mësuesit;
- për të paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha pritshmëritë që mund të ketë secila prej orëve mësimore.

### Nëntematika I-Toka në hapësirë

Në përfundim të kësaj nëntematike, nxënësi/ja:

**përshkruan:**

- formën e Tokës;
- përmasat dhe rëndësinë e tyre;
- pozicionin e Tokës në sistemin diellor.

**identifikon provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj.**

**ndërton dhe përdor modele, të cilat:**

- tregojnë lidhjen ndërmjet rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe gjatësisë së ditës;
- përshkruajnë pozicionin e Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve.



## Tema mësimore: I.1 Toka në sistemin diellor

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika I: Toka në hapësirë</b>		<b>Tema mësimore: I.1 Toka në sistemit diellor</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet me gojë ose me shkrim (si dhe në forma të tjera të komunikimit), mbi vendin e Tokës në hapësirë.</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth tyre, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton duke e ilustruar me shembuj konkretë vendin e Tokës në sistemin diellor.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën dhe shfrytëzimin e materialeve gjatë kryerjes së detyrës.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi-ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e diskutimit mbi vendin e Tokës në hapësirë.</li> <li>• Vizaton një skemë të sistemit diellor, ose ndërton me plastelinë një maket që tregon vendosjen e trupave në sistemin diellor.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së përgjigjeve të grupit.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht mbi: a) vendin që zë sistemi diellor në gjithësi dhe në galaktikën “Rruga e Qumështit” b) vendin që zë Toka në sistemin diellor.</li> </ul> </li> </ol>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

- Nxënësi/ja formulon dhe drejton pyetje mbi raportin e Tokës me Diellin dhe me planetët e tjerë të sistemit diellor; heton mbi origjinën e gjithësisë dhe veçanërisht të sistemit diellor.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

- Nxënësi/ja krahason përmasat e Tokës me ato të Diellit dhe të planetëve të tjerë të sistemit diellor;

### 3. Marrja e vendimeve

- Nxënësi/ja përcakton se çfarë vendi zë sistemi ynë diellor në galaktikën “Rruga e Qumështit” dhe në sistemin diellor.

#### Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:

- përshkruan se ku ndodhet Toka në raport me Diellin dhe me planetët e tjerë të sistemit diellor;
- krahason përmasat e Tokës me ato të Diellit dhe të planetëve të tjerë të sistemit diellor;
- përcakton se çfarë vendi zë sistemi ynë diellor në galaktikën “Rruga e Qumështit”.

**Fjalët kyçe:** univers; galaktikë; sistem diellor; Toka në sistemin diellor

**Burimet:** Teksti, foto, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**  
Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

#### a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në kuriozitetin e vazhdueshëm që i karakterizon nxënësit, në të përditshmen e tyre dhe në dëshirën e vazhdueshme të tyre për të mësuar rreth botës që i rrethon. Përdor pyetje të cilat ata mund t’i kenë bërë në jetën e përditshme... P.sh mësimi fillon me pyetjen: Çfarë vendi zë Toka jonë në hapësirën që na rrethon?”

#### b. Ndërtimi i njohurive të reja

##### Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1.

##### Veprimet në situatë

##### Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.1 në tekst: **Diskutojmë:** “Hapësira që na rrethon, është e pafundme. Njeriu kërkon vazhdimisht ta njohë sa më shumë atë. Por, çfarë vendi zë Toka jonë në këtë hapësirë?”

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: E gjithë hapësira e pafundme rreth nesh quhet <i>univers</i> ose <i>gjithësi</i>. Ajo është krijuar si rezultat i një shpërthimi të madh (Big Beng), gjatë të cilit, lënda dhe energjia u shpërndanë në drejtime të ndryshme...</p> <p>Mësuesja u drejtohet përsëri nxënësve me pyetjen që nxit <i>Brainstorming</i>-un: Po Toka dhe sistemi diellor si u formuan?</p> <p>Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve ....</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Rreth 4.6 miliardë vjet më parë, rreth Diellit u formua sistemi ynë diellor. Sistemi diellor përbëhet nga Dielli (që ndodhet në qendër) dhe nga planetët, satelitët, asteroidet, kometat dhe meteorët, të cilët rrotullohen rreth tij. Toka ku ne jetojmë, është një nga tetë planetët e sistemit diellor. Ajo ndodhet rreth 150 milionë km larg nga Dielli dhe ka vetëm një satelit natyror, Hënën, e cila qarkullon rreth Tokës dhe së bashku me Tokën, edhe rreth Diellit...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë tekstin dhe drejton pyetjet Bazuar në figurat 2 dhe 3: a) përshkruaj se ku ndodhet Toka në raport me Diellin dhe me planetët e tjerë të sistemit diellor; b) krahaso përmasat e Tokës me ato të Diellit dhe të planetëve të tjerë të sistemit diellor; c) përcakto se çfarë vendi zë sistemi ynë diellor në galaktikën “Rruga e Qumështit”.</p> <p>Pasi lexojnë tekstin dhe analizojnë figurat 2 dhe 3 të tekstit, nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet e dhëna në tekst, në rubrikën “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi i nxënësit/es fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## Tema mësimore: I.2

### Forma e Tokës dhe rëndësia e saj

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika I: Toka në hapësirë</b>		<b>Tema mësimore: I.2 Forma e Tokës dhe rëndësia e saj</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet për tematikën që trajtohet.</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth formës reale të Tokës.</li> <li>• Përshkruan formën e Tokës duke analizuar figurën 5 të tekstit.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krahason ngjashmëritë dhe dallimet midis paraqitjeve skematike të formën e Tokës (paraqitur në figurën 5 të tekstit).</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, harta, foto, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për analizën e tij.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët gjatë diskutimit dhe hulumtimit.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (përmes internetit apo materialeve të shkruara) mbi përfytyrimet që ka pasur njerëzimi mbi formën e Tokës, përpara se të bëheshin zbulimet e mëdha gjeografike, studimet mbi formën e saj, si dhe fotografimet nga hapësira.</li> </ul>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja përshkuan se si ka ndryshuar njohja mbi formën e Tokës në etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson rolin e formës së Tokës.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja analizon, vlerëson, formën sferike të Tokës.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja përshkruan formën e Tokës.

**Fjalët kyçe:** formë sferike, formë elipsoidi, forma reale e Tokës, brezat klimatikë.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, shkencë natyrore, TIK

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:  
a. që si të gjithë planetët e tjerë, edhe Toka është sferike.

**b. Ndërtimi i njohurive të reja**

#### **Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

#### **Veprimet në situatë**

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.2 në tekst: Diskutojmë: Njeriu është përpjekur të zbulojë pamjen e vërtetë të Tokës shumë kohë më përpara se të dërgoheshin kamerat në hapësirë (kujto çfarë ke mësuar në klasën e gjashtë). Në shekullin III pr.K., me anë të llogaritjeve që bëri, dijetari grek, Aristoteli dha i pari idenë e rrumbullakësisë së Tokës. Kohë më vonë, formën reale të këtij planeti e sollën imazhet e dërguara nga satelitët artificialë.

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ju mund të keni lexuar kuriozitete të ndryshme mbi Tokën dhe keni parë fotografi të pamjes së saj. Si e parafytyroni formën e Tokës?</li> </ul> <p>Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë....</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 5 të tekstit dhe vazhdon: Për qëllime studimi, forma e Tokës është konsideruar gjithmonë sferike, si një top me sipërfaqe të lëmuar (shih figurën 5, a). Por forma e saj reale është paksa më e ndërlikuar. Rrezja polare është më e shkurtër se ajo ekuatoriale, pra Toka është më e fryrë në Ekuator dhe pak e shtypur në pole (shih figurën 5, b). Përveç kësaj, sipërfaqja e Tokës ka relief me ulje e ngritje të shumta, si male, kodra, fusha, lugina, rrafshnalta etj. (shih figurën 5, c). Pra, forma reale e Tokës i ngjan një elipsoidi që në sipërfaqe ka ulje dhe ngritje të shumta.</p> <p>Orientohen nxënësit të vëzhgojnë me kujdes figurën 5 dhe bazuar në të përshkruajnë ndryshimet që dallojnë midis formave a, b dhe c, duke i dhënë përgjigje pyetjes: Cila prej tyre i përafrohet formës reale të Tokës?</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 6 të tekstit dhe vazhdon: Forma sferike e Tokës ndikon shumë në sasinë e rrezatimit diellor, që mbërrin në sipërfaqe të ndryshme të saj. Për shkak të një forme të tillë, rrezatimi diellor, i cili hyn në atmosferën e Tokës në formën e rrezeve paralele, bie me kënde të ndryshme në sipërfaqen e saj, duke krijuar kështu brezat klimatikë...</p> <p>Nxënësit diskutojnë mbi situatën: “Rikujto njohuritë e marra nga teksti i Gjeografisë 6, mbi klimën e vendit tonë. Diskuto: a) në cilin brez klimatik ndodhet vendi ynë dhe me çfarë këndi bie rrezatimi diellor në këtë brez; b) çfarë tiparesh ka klima e vendit tonë”. Vlerësojnë pasojën e formës sferike të Tokës.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë ushtrimet e rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: I.3 Përmasat e Tokës. Rëndësia e tyre

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika I: Toka në hapësirë</b>		<b>Tema mësimore: I.3 Përmasat e Tokës. Rëndësia e tyre</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth përmasave të planetit tonë.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, disa të dhëna për Tokën: (rrezja ekuatoriale, rrezja polare, rrezja mesatare, sipërfaqja e Tokës, vëllimi i Tokës, dendësia mesatare)</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpretton lidhjen midis masës së Tokës dhe pranisë së atmosferës që e rrethon.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë e marra në temën 1.1, me njohuritë e marra apo të hulumtuara nga burime të ndryshme, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskuton në grup mbi rolin e përmasave të Tokës.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimeve në grup.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.</li> </ul> </li> </ol>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja përshkruan disa përmasa mbi Tokën.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson rolin e përmasave të saj.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja evidenton të dhënat mbi planetin tonë dhe vlerëson rëndësinë që ka masa e tij.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja përshkruan përmasat e Tokës dhe rëndësinë e tyre.

**Fjalët kyçe:** rreze ekuatoriale, rreze polare, rreze mesatare, sipërfaqja e Tokës, vëllimi i Tokës, masa e Tokës, dendësia mesatar e Tokës.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK

Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:  
a. që planeti ynë ka atmosferë.

#### **Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).


#### **Veprimet në situatë**

#### **Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.3 në tekst: Diskutojmë: Risjellim në vëmendje vendin që zë Toka në sistemin diellor. Krahasojmë përmasat e saj me ato të planetëve të tjerë të sistemit diellor.

Nxënësit vëzhgojnë, diskutojnë, përshkruajnë....





<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë përmes imazheve të dërguara nga satelitët artificialë, ka sjellë informacione të plota mbi përmasat e planetit tonë. Mësuesja pyet nxënësit: Ç’ dini ju për mënyrat se si informohemi mbi planetin tone?</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë dhe përshkruajnë....</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin tekstin dhe vazhdon: Shihni më poshtë disa të dhëna për Tokën:</p> <p><b>Përshkruani figurën 8.</b></p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë....</p> <p>Mësuesi/ja përsëri vazhdon: Megjithëse bën pjesë në grupin e planetëve të vegjël, përmasat e planetit tone kanë rëndësi të madhe sepse përcaktojnë masën e tij (<math>5.98 \times 10^{24}</math> kg). Masa e Tokës ndikon në madhësinë e forcës gravitacionale që krijohet. Për shkak të kësaj force që ushtron, planeti ynë arrin të mbajë të lidhur pas vetes atmosferën, një shtresë shumë e rëndësishme për jetën. Më pas i fton nxënësit të plotësojnë tabelën e ushtrimit 1.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë ushtrimin 1, 2 tek rubrika “Radha jote”.</p> <table data-bbox="518 1477 1229 1593"> <tr> <td>Rrezja ekuatoriale (a) = 6378 km</td> <td>Sipërfaqja e Tokës: 510 milionë km<sup>2</sup></td> </tr> <tr> <td>Rrezja polare (b) = 6357 km</td> <td>Vëllimi i Tokës: 1083 miliardë km<sup>3</sup></td> </tr> <tr> <td>Rrezja mesatare = 6371 km</td> <td>Dendësia mesatare: 5,5 gr/cm<sup>3</sup></td> </tr> </table>	Rrezja ekuatoriale (a) = 6378 km	Sipërfaqja e Tokës: 510 milionë km <sup>2</sup>	Rrezja polare (b) = 6357 km	Vëllimi i Tokës: 1083 miliardë km <sup>3</sup>	Rrezja mesatare = 6371 km	Dendësia mesatare: 5,5 gr/cm <sup>3</sup>
Rrezja ekuatoriale (a) = 6378 km	Sipërfaqja e Tokës: 510 milionë km <sup>2</sup>						
Rrezja polare (b) = 6357 km	Vëllimi i Tokës: 1083 miliardë km <sup>3</sup>						
Rrezja mesatare = 6371 km	Dendësia mesatare: 5,5 gr/cm <sup>3</sup>						
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>						
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>						

## Tema mësimore: I.4

### Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet dhe pasojat gjeografike

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJE- DISI</b>	<b>LËNDA: GJEO- GRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika I: Toka në hapësirë</b>		<b>Tema mësimore: I.4 Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet dhe pasojat gjeografike</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet dhe pasojat gjeografike që sjell, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth vetes.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Evidenton rrotullimin ditor të Tokës dhe pasojat që rrjedhin prej tij.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi konceptet (rrotullimi ditor i Tokës, formimi i ditë-natës, shtypja në pole shmangia e trupave që lëvizin horizontalisht), duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit të grupit.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.</li> </ul> </li> </ol>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja vëzhgon dhe përshkruan rrotullimin e Tokës rreth vetes.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson rolin e zhvillimit të teknologjisë, hartografisë dhe të përdorimit të mjeteve e formave digjitale në studimet mbi rrotullimin e Tokës rreth vetes.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja përshkruan rrotullimin e Tokës rreth vetes dhe diferencon pasojat gjeografike që rrjedhin prej rrotullimit të Tokës rreth vetes.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi: Identifikon provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj. Përshkruan rrotullimin e Tokës rreth vetes; Diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes

**Fjalët kyçe:** rrotullimi ditor i Tokës, formimi i ditë-natës, shtypja në pole shmangia e trupave që lëvizin horizontalisht

**Burimet:** Teksti, foto, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve**

Nxënësit/et dinë:  
a. që të gjithë planetët e sistemit diellor, rrotullohen rreth vetes.

**b. Ndërtimi i njohurive të reja**

#### Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).


#### Veprimet në situatë

#### Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.4 në tekst.

**Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura**

**Diskutojmë:** “Përgjatë 24 orëve, vëmë re se dita dhe nata ia lënë vendin njëra-tjetrës në mënyrë të përsëritur. Dielli shfaqet në agim, në vazhdim e shohim që lëviz nëpër qiell deri sa perëndon, dhe më pas vjen nata. Mëngjesin tjetër, dielli rishfaqet dhe çdo gjë përsëritet nga e para. Për rrjedhojë, duke iu përshtatur këtij ndryshimi të përhershëm, e gjithë bota e gjallë në planetin tonë krijon një regjim ditor të caktuar. Por, a e dini si formohet ditë-nata?”

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p> <p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të ar-ritura</b></p>	<p>Nxënësit japin përgjigjet e tyre.</p> <p>Mësuesja orienton nxënësit të shohin figurën 9 dhe vazhdon të trajtojë informacionin e tekstit: Toka rrotullohet rreth boshtit të saj për 24 orë (ose saktësisht 23 orë e 56 minuta), nga perëndimi në lindje, në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të orës. Gjatë rrotullimit rreth vetes, Toka i ekspozon Diellit çdo pjesë të sipërfaqes së saj. Gjithmonë na duket sikur Dielli lëviz në raport me ne, ndërkohë që jemi ne që lëvizim bashkë me Tokën, rreth boshtit të saj...</p> <p>Mësuesja nxit një brainstorming me pyetjen: Përshkruaj si ndryshon vendndodhja e Diellit (ose rruga që përshkon Dielli nga momenti i lindjes deri në perëndim) gjatë 24 orëve, në vendbanimin tënd.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë figurën.</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: shihni figurën 10 të tekstit. A e dini ju se cilat janë pasojat që rrjedhin prej rrotullimit të Tokës rreth vetes?</p> <p>Pas përgjigjeve të tyre ajo vazhdon: Provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth vetes, janë vetë pasojat që rrjedhin prej këtij rrotullimi...</p> <p>Më pas mësuesja nxit një tjetër brainstorming me anë të situatës: Bazuar në figurën 10, përshkruaj drejtimet e shmangies së erërave/masave ajrore/trymave oqeanike, gjatë lëvizjes së tyre nga një gjerësi gjeografike në tjetrën, në secilën hemisferë.</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1 dhe 2. Vlerësohen pasojat që rrjedhin nga rrotullimi i Tokës rreth vetes.</p> <p>Lihen ushtrimet 3 dhe 4 për detyrë shtëpie dhe në orën pasardhëse nxënësit/et demonstrojnë zgjidhjet e tyre.</p> 
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: I.5 Rrotullimi i Tokës rreth Diellit

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika I: Toka në hapësirë</b>		<b>Tema mësimore: I.5 Rrotullimi i Tokës rreth Diellit</b>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)**

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm: Rrotullimin e Tokës rreth Diellit dhe pasojat gjeografike që rrjedhin prej tij.

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)**

- Interpreton duke e ilustruar këtë rrotullim me shembuj konkretë (si p.sh. formim i stinëve apo ndryshimi i vendit të lindjes dhe perëndimit të Diellit).

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)**

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (harta, foto, revista ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e diskutimeve të shembujve të përdorur në klasë për të ilustruar rrotullimin e Tokës rreth Diellit.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si,?), organizon mendimet e veta dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e diskutimeve në klasë.

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit/diskutimeve të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja shpjegon qartë mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe evidenton pasojat gjeografike që rrjedhin prej tij.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson dhe komunikon me të tjerët rolin e këtij rrotullimi.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja analizon dhe vlerëson pasojat gjeografike që rrjedhin prej rrotullimit të Tokës rreth Diellit, në secilin prej pozicioneve të Tokës kundrejt Diellit.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi: përshkruan rrotullimin e Tokës rreth Diellit; diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit

**Fjalët kyçe:** rrotullimi i Tokës rreth Diellit, formimi i stinëve, solstice, ekuinokse.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

#### a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Nxënësit/et dinë:

a. që Toka si gjithë planetët e tjerë, rrotullohet edhe rreth Diellit..

#### b. Ndërtimi i njohurive të reja

##### Situata e të vepruarit


Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

##### Veprimet në situatë

##### Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.5 në tekst- Diskutojmë: “Gjatë vitit, stinët i lënë vendin njëra-tjetrës. Duke qenë se i njohim karakteristikat e secilës stinë, planifikojmë edhe punët, pushimet apo mënyrën e të veshurit, për t’u përshtatur me to. Por, a e dini si formohen stinët?”

**Nxënësit japin përgjigjet e tyre.**

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesja orienton nxënësit të shohin figurën 11 dhe i fton ata ta përshkruajnë atë. Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e tekstit: Në 22 dhjetor, Toka i ekspozon Diellit më tepër Hemisferën Jugore, ndaj kjo date për këtë hemisferë shënon ditën e solsticit veror, ndërsa për Hemisferën Veriore, ditën e solsticit dimëror. Për shkak të këtij pozicioni kundrejt Diellit, Hemisfera Jugore merr më tepër energji diellore dhe në të fillon vera astronomike. Dielli lind në juglindje dhe perëndon në jugperëndim...</p> <p>Ndërkohë ajo fton nxënësit ta përshkruajnë këtë me fjalët e tyre duke iu referuar figurës 12, për datën 22 dhjetor.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Më 22 qershor, Toka i ekspozon Diellit më tepër Hemisferën Veriore. Për Hemisferën Veriore, kjo datë shënon ditën e solsticit veror, ndërsa për Hemisferën Jugore shënon ditën e solsticit dimëror. Hemisfera Veriore merr më tepër energji diellore dhe në të fillon vera astronomike. Dielli lind në verilindje dhe perëndon në veriperëndim. Rrezet diellore bien pingul në tropikun e Veriut...</p> <p>Ndërkohë ajo fton nxënësit ta përshkruajnë këtë me fjalët e tyre duke iu referuar figurës 12, për datën 22 qershor.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Më 21 mars dhe 23 shtator (data ekuinoksi), rrezet diellore bien pingul në Ekuator, kështu që kufiri ndarës midis ditës e natës kalon nëpër të dyja polet...</p> <p>Ndërkohë ajo fton nxënësit ta përshkruajnë këtë me fjalët e tyre duke iu referuar figurës 12, për datën 21 mars dhe 23 shtator.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit demonstrojnë ushtrimin 3: Me anë të një topi (që përfaqëson Tokën) dhe të një elektriku dore (që përfaqëson Diellin), vepro si në figurën përbri. Trego se si ndriçohet Toka në stinë të ndryshme. Analizo se çfarë ndodh në secilën prej hemisferave të Tokës më: 22 Qershor, 22 Dhjetor 21 Mars dhe 23 Shtator.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	 <p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## ■ Punë praktike 1.1

- **Nëntematika: Toka në hapësirë**
- **Tema: Toka në sistemin diellor**

### *Rezultatet e të nxënimit*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- ndërton dhe përdor modele që tregojnë: a) vendin e Tokës në sistemin diellor; b) pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes; c) pozicionin e Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe të solsticeve;
- kërkon me objektivitet të dhëna dhe informacion për të qenë më i/e saktë në shpjegimet e tij/saj mbi formën dhe përmasat e Tokës;
- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e veta;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale;
- demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup për përgatitjen e modeleve.

**Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:** 45 minuta për prezantimin e punës; klasa.

**Materialet burimore:** Të dhëna të siguruara përmes tekstit mësimor, materialeve të rekomanduara nga mësuesi/ja, internetit dhe enciklopedive të ndryshme.

**Mjetet e punës:** Skeda me informacione të shkruara (të siguruara nëpërmjet tekstit mësimor, materialeve të rekomanduara nga mësuesi/ja, internetit dhe enciklopedive), fotografi, plastelinë/ topa llastiku/tullumbace/topa letre, karton/kuti kartoni/dërrasë/kuti druri, tela/spango, lapsa me ngjyra, gjilpëra me kokë.

### **Metodologjia që do të përdoret:**

Punë në grupe (ndërtim maketi, prezantim, diskutim).

### **Puna përgatitore:**

Përcaktohet dhe diskutohet që në mësimin e parë të kësaj nëntematike, ideja e punës praktike (nis puna që me ushtrimin nr. 3). Për këtë: 1. ndahen detyrat e grupeve, në mënyrë që nxënësit të punojnë hap pas hapi në fund të çdo teme mësimore; 2. përgatiten objektet dhe etiketat që do të plotësojnë maketin.



### ***Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike***

- Me objektet e përgatitura në shtëpi (planetë, Dielli, Hëna, asteroide etj.) ndërtohet në klasë maketi që paraqet sistemin diellor. Orbitat dhe boshtet e rrotullimit mund të jenë prej teli.
- Gjatë ndërtimit të maketit jepen të dhënat e duhura mbi: a) përmasat, formën e Tokës dhe rëndësinë që kanë ato për planetin tonë; b) mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe pasojat që rrjedhin prej tij; c) mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe pasojat që vijnë prej tij (në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve) etj. Është mirë që disa prej këtyre të dhënave të jenë të shkruara edhe në etiketa me ngjyra (të përgatitura më parë), që gjatë prezantimit të mund të vendosen dhe ngjiten në platformën e maketit ose mbi trupat e sistemit diellor. Gjatë këtij prezantimi, informacioni shoqëruar mund të bëhet edhe me anë të PowerPoint-it (të përgatitur që më parë).
- Diskutohet midis grupeve (vlerësohen punët e njëri-tjetrit).
- Bëhet vlerësimi i nxënësve.

## ■ Përsëritje 1


- **Nëntematika: Toka në hapësirë**
- **Tema: Toka në sistemin diellor**

### **1. E vërtetë apo e gabuar?**

- Toka bën pjesë në grupin e planetëve të jashtëm, që kanë përmasa të mëdha. **V G**
- Shtypja e Tokës në pole shkaktohet prej rrotullimit të Tokës rreth Diellit. **V G**
- 23 shtatori shënon ditën e ekuinoksit vjeshtor për Hemisferën Veriore. **V G**
- Toka është një nga tetë planetët e sistemit diellor. **V G**
- Toka rrotullohet një herë në vit rreth Diellit. **V G**
- Dielli është qendra e gjithësisë. **V G**
- Toka ka disa satelitë natyrorë. **V G**

**2. a. Në tabelën e figurës 1, plotëso emërtimin e secilit planet sipas numrave përkatës.**

**b. Përshkruaj vendin që zë Toka në sistemin diellor, në gjithësi, si dhe në galaktikën “Rruga e Qumështit”.**




### 3. Diskuto mbi pyetjet:

- Cila është forma e Tokës?
- Çfarë pasojash rrjedhin nga forma që ka planeti ynë?
- Cilat janë përmasat e planetit tonë?
- Përse kanë rëndësi përmasat e Tokës?
- Si bëhet rrotullimi i Tokës rreth vetes dhe çfarë pasojash rrjedhin ?
- Si bëhet rrotullimi i Tokës rreth Diellit?
- Cilat janë pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit?

### 4. Përcakto se në cilën periudhë të vitit ndodhet Toka në figurën 2 (a, b dhe c).

**Analizo** se çfarë ndodh në secilën prej hemisferave të Tokës, për shkak të ndryshimit të pozicionit të saj kundrejt Diellit.



## Testim 1 - Toka në hapësirë

(shih planin vjetor dhe atë të tremujorit të parë për orën se kur bëhet testimi)

**Shënim 1:** Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit: njohuritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipat ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (të tekstit). Pyetjet e përsëritjes mund t'i përdorni për pyetje testimi dhe gjatë orës së përsëritjes të formuloni edhe pyetje të tjera.

**Shënim 2:** Në orën e përsëritjes dhe të testimit, në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi/ja duhet të vlerësohet për shkallën e perceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi/ja mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit për t'i shpjeguar ato me fjalët e tij, por sidomos në aftësinë për t'i zbatuar ato. Pra i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues të nxënësit.

▪ **Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë**

Në përfundim të kësaj nëntematike, nxënësi/ja:

- Modelon strukturën vertikale të atmosferës duke përdorur informacion nga burime të ndryshme të të nxënit.
  - Dallon brezat e nxehtësisë dhe rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë.
  - Përshkruan:
    - shkaqet dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë;
    - ndikimin e saj në qarkullimin e rrymave oqeanike dhe erërave.
  - Sjell shembuj si modelet globale ndikojnë mikroklimën (p.sh., rryma e Golfstrimit pasojat në klimën e Evropës veriperëndimore);
  - Shpjegon marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.
  - Përdor:
    - instrumentet për matjen e temperaturës së ajrit, shtypjes atmosferike, lagështirës dhe përcaktimin e drejtimit të erës, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin;
- harta sinoptike për të bërë parashikime të motit.
- Përshkruan klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve.
  - Identifikon:
    - faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;
    - zonat kryesore klimatike në hartë.
  - Ndërton dhe interpreton grafikë klimatike për zona të ndryshme.
  - Argumenton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi ) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serë).
  - Interpreton lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën;
  - Identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia);
  - Bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë:
    - valët detare
    - rrymat oqeanike
    - baticat dhe zbatikat
  - Skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe përshkruan rolin e tyre në klimën e rajoneve që përshkojnë.

- Identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm, elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve.
- Përcakton drejtimet kryesore të shtrirjes së disa lumenjve në hartën e botës dhe Shqipërisë.
- Krahason liqenet me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vendndodhjen e tyre në hartë.
- Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.
- Përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis.
- Heton për një çështje mjedisore që lidhet me ujërat (p.sh., erozioni lumor, tharja e liqenit artificial etj.) në zonën e tij:
  - identifikon problemin;
  - përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë;
  - ofron zgjidhje;
  - vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme.
- Modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.
- Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë.
- Identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.
- Argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, minerale) për shoqërinë.
- Nxjerr përfundime për proceset historike që kanë kontribuar në format e tokës:
  - Lëvizjet e kontinenteve përgjatë kohërave
  - Pllakat tektonike
- Diferencon format kryesore të relievit të kontinenteve dhe bën dallimin e tyre në hartë.
- Identifikon në hartë vendet me lartësi absolute të ndryshme.
- Krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e lëvizjeve të ngadalta (p.sh. formimi i maleve) dhe proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet).
- Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.
- Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.

## Tema mësimore: II.1 Atmosfera. Përbërja e saj

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJE- DISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.1 Atmosfera. Përbërja e saj</b>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

**1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)**

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi atmosferën, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor mbi rajonin nga libra, internet etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë diskutimeve në grup.

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)**

- Përdor analizën për të prezantuar përbërjen e atmosferës.

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)**

- Ndërlidh temën e re me njohuritë e mëparshme (kryesisht rrezatimin diellor dhe formën sferike të Tokës).

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave në grup.

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Përdor mjetet digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me shokët/shoqet.

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja përshkruan se ç'është atmosfera dhe pse ka rëndësi ajo.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja diskuton përmes shembujve rolin e atmosferës.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja analizon përbërjen e atmosferës

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja: përcakton kuptimin mbi atmosferën; analizon përbërjen e atmosferës.

**Fjalët kyçe:** atmosferë, elemente të gazta, të ngurta, të lëngëta.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:  
që atmosfera qëndron e lidhur pas Tokës për shkak të masës së saj.

**b. Ndërtimi i njohurive të reja**

#### **Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

#### **Veprimet në situatë**

##### **Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.1 në tekst- Diskutojmë: “Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi shkakun pse atmosfera qëndron gjithmonë e lidhur me Tokën. Çfarë kuptoni me konceptin atmosferë? A është ajo e domosdoshme për jetën në Tokë?”

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Nxënësit diskutojnë, tregojnë...</b></p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Atmosferë quhet shtresa e ajrit që mbështjell Tokën. Prania e saj është mjaft e rëndësishme për planetin tonë, sepse lejon të mbërrijë në sipërfaqen e tij atë pjesë rrezatimi diellor aq të domosdoshme për jetën dhe pengon depërtimin e rrezeve të dëmshme. Përveç kësaj, lëvizjet e përhershme të rrymave të ajrit që ndodhin në atmosferë, zbutin diferencat midis temperaturave të ditës dhe të natës, si dhe realizojnë shpërndarjen e dritës në Tokë.</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të vërejnë figurën 1 dhe të diskutojnë mbi pyetjen: Përshkruaj rëndësinë që ka prania e atmosferës për jetën tëndë dhe për gjithë botën e gjallë.</p> <p><b>Nxënësit/et përshkruajnë...</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Atmosfera e Tokës përbëhet nga elemente të gazta, të ngurta dhe të lëngëta. Elementet e gazta janë: azoti, që zë 78% të atmosferës, oksigjeni, i cili zë 21%, si dhe gaze të tjera, që zënë 1% të saj. Pjesën më të madhe të gazeve që përbëjnë 1% të atmosferës e zë dioksidi i karbonit... Në vazhdim mësuesi/ja fton nxënësit/et të vërejnë figurën 2 dhe të diskutojnë mbi pyetjen: Trego përmes disa shembujve, rëndësinë që ka oksigjeni për botën e gjallë në planetin tonë.</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1, 2 dhe 3 tek rubrika “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.2

### Struktura e atmosferës

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VI
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.2 Struktura e atmosferës	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi lëvizjen, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> <li>• Veçon llojet e lëvizjeve dhe i komenton me moshatarët e tij/saj</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor krahasimin dhe kontrastin për të dalluar llojet e lëvizjeve.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë e mëparshme.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave në grup.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mjetet digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me shokët/shoqet.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>			
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja vëzhgon llojet e lëvizjeve dhe shkaqet e tyre.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja vlerëson rolin e zhvillimit të teknologjisë dhe të përdorimit të mjeteve e formave digjitale në njohjen mbi botën dhe në lëvizjen e mallrave ideve e informacionit. Dallon se dukuria e migrimëve të popullsisë ka ndodhur në etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë dhe për arsye të ndryshme.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja diferencon përmes shembujve nga vendi/Evropa/bota, llojet e ndryshme të lëvizjes.</p>			



<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja modelon strukturën vertikale të atmosferës duke përdorur informacion nga burime të ndryshme të të nxënit.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> troposferë, stratosferë, mezosferë, termosferë, ekzosferë</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë: që atmosfera qëndron e lidhur pas Tokës për shkak të masës së saj. përbërjen e atmosferës</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.2 në tekst- Diskutojmë: “Deri në çfarë lartësie shkon atmosfera? Si mendoni, a është ajo njësoj e dendur dhe me të njëjtat temperatura si pranë sipërfaqes së Tokës, ashtu edhe në lartësi?” Nxënësit diskutojnë, tregojnë se çfarë kanë lexuar mbi këtë... Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Atmosfera e planetit tonë është e përbërë nga disa shtresa, ku secila prej tyre ka veçoritë dalluese. Nisur nga sipërfaqja e Tokës drejt lartësisë, atmosfera përbëhet nga këto shtresa: troposfera, stratosfera, mezosfera, termosfera dhe ekzosfera... Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë në tekst mbi shtresat e atmosferës. Në vazhdim i fton ata që duke pasur si referencë figurat 3 dhe 4 të tekstit të diskutojnë mbi veçoritë e secilës shtresë të atmosferës. Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë... Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1 dhe 2 te rubrika “Radha jote”. Lihet detyrë në grup, në shtëpi, ushtrimi 3.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.3

### Rrezatimi diellor dhe rëndësia e tij

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.3 Rrezatimi diellor dhe rëndësia e tij</b>	

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

##### 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)

- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi rrezatimin diellor, rrezatimin tokësor, breza (zona) të nxehtësisë (duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm).
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV, harta të ndryshme etj., dhe e shfrytëzon atë si referencë për të evidentuar rolin e rrezatimit diellor.

##### 2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)

- Përzgjedh dhe demonstroi forma të ndryshme gjatë diskutimit mbi rolin e rrezatimit diellor dhe botës së gjallë e njeriut.

##### 3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)

- Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.

##### 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)

- Diskuton në grup për rëndësinë që ka rrezatimi diellor për jetën në planet.

##### 5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

##### 6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjet e dhëna, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.

##### 7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)

- Përdor mjetet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja evidenton kuptimin mbi rrezatimin diellor dhe atë tokësor.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja vlerëson rolin e rrezatimit diellor mbi jetën në planetin tonë.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja analizon formimin e brezave të nxehtësisë në Tokë.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja dallon brezat e nxehtësisë dhe rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë.</p>	<p>Fjalët kyçe: rrezatim diellor; brezat e nxehtësisë.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></p>	<p>Nxënësit dinë: Rolin e formës sferike të Tokës.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit II.3 në tekst- Diskutojmë: “Çfarë roli luan energjia diellore për jetën në planetin tonë?”</p> <p>Nxënësit diskutojnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Dielli i dërgon Tokës në mënyrë të vazhdueshme sasi të mëdha energjie dhe drite, të cilat përbëjnë rrezatimin diellor. Ky rrezatim nuk mbërrin i gjithi në sipërfaqen e planetit tonë, sepse një pjesë e tij përthithet nga gazet e shtresave të atmosferës... Ftohen nxënësit/et që, bazuar në figurën 5, të përshkruajnë se çfarë ndodh me rrezatimin diellor që mbërrin në sipërfaqen e Tokës. Nxënësit/et tregojnë....</p>

<b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b>	<p>Mësuesi/ja vazhdon: Siç e dimë, për shkak të formës sferike të Tokës, pjesë të ndryshme të sipërfaqes së saj marrin sasi jo të njëjta rrezatimi diellor, çka do të thotë që vende të ndryshme në planetin tonë ngrohen në mënyrë të pabarabartë. Për rrjedhojë, në Tokë formohen këto zona ose breza nxehtësie:...</p> <p>Ftohen nxënësit/et që, bazuar në figurën 6, të përshkruajnë figurën 6 për të reguar ndikimin e formës së Tokës në sasinë e rrezatimit diellor që marrin zona të ndryshme të saj, në gjerësi të ndryshme gjeografike.</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë....</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Në vazhdim orientohen nxënësit/et të diskutojnë në grup mbi rolin rrezatimit diellor për planetin tonë. Sjellin shembuj.</p> <p>Diskutojnë gjithashtu edhe ushtrimet 1, 2, 3 dhe 4 tek rubrika “Radha jote”.</p> <p>Ushtrimi 4 punohet së bashku me mësuesen.</p>
<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.4

### Faktorët dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.4 Faktorët dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet mbi faktorët e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë.</li> </ul>			

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.</li> </ul>	
<p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor analizën për të dalluar faktorët dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë.</li> </ul>	
<p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit mbi faktorët dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.</li> </ul>	
<p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup</li> </ul>	
<p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul>	
<p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.</li> </ul>	
<p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b></p>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja përshkuan faktorët e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë</p>	
<p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja vlerëson pasojat që rrjedhin prej shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë në Tokë.</p>	
<p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja diskuton mbi faktorët dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi: përshkruan: shkaqet dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë; ndikimin e saj në qarkullimin e rrymave oqeanike dhe erërave.</p>	<p>Fjalët kyçe: pozita gjeografike, ekspozimi ndaj Diellit, kushtet e motit dhe gjendja atmosferike, lloji i sipërfaqes, formimi i masave, ajrore dhe rrymave, oqeanike/detare.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkencë natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit kanë njohuri mbi: formën e tokës dhe shpërndarjen e pabarabartë të nxehtësisë.</p>

	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.4 në tekst – “Diskutojmë: Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi formën e Tokës dhe rrotullimin e saj rreth Diellit. Çfarë lidhje ka midis sasisë së rrezatimit diellor që mbërrin në Tokë, formës sferike të saj, si dhe kohës së ekspozimit kundrejt Diellit?”</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 7 dhe trajton së bashku me ta se si ndikon pozita gjeografike mbi shpërndarjen e pabarabartë të nxehtësisë.</p> <p>Nxënësit përshkruajnë figurën.</p> <p>Më tej mësuesi/ja vazhdon të trajtojë faktorët e tjerë: Kushtet e motit dhe gjendja atmosferike. Kur moti është i kthjellët dhe pa re, në sipërfaqen e Tokës mbërrin një sasi më e madhe e rrezatimit diellor. Ndërsa në kushtet e një moti të vranët, me ajër të ndotur dhe të lagësht, sasia e rrezeve diellore është më e vogël, pasi një pjesë e tyre thithet nga avujt e ujit, gazet e ndryshme dhe pluhurat. • Lloji i sipërfaqes. Sasia e rrezatimit që përthithet dhe shpërndahet më pas nga Toka, lidhet ngushtë me karakteristikat e sipërfaqes së saj. Sipërfaqet më të errëta të Tokës (toka të errëta, asfalti etj.) thithin më shpejt e më tepër energji diellore sesa ato më të çelëta, ndërsa sipërfaqet ujore ngrohen dhe ftohen më ngadalë...</p> <p>Ftohen nxënësit/et të lexojnë pasojat që rrjedhin prej ndryshimit të sasisë së rrezatimit duke e ilustruar me shembullin e figurës 10.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1,2,3 tek rubrika “Radha jote”. Lihet për detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.5

### Moti

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.5 Moti</b>	

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

##### 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)

- Shpreh mendimin e vet mbi marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

##### 2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)

- Përdor analizën për të shpjeguar marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.

##### 3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)

- Nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit, shfrytëzon të dhënat për të demonstruar marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin.

##### 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup

##### 5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)

- Ndan mendimet në grup.

##### 6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.

##### 7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja përshkuan elementet e motit si një ndryshim afatshkurtër.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja shpjegon marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja shpjegon marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.

**Fjalët kyçe:** mot, elementet e motit

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

#### a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Nxënësit/et kanë njohuri mbi:  
Ndryshueshmërinë e motit gjatë ditës apo nga një vend në tjetrin.

#### b. Ndërtimi i njohurive të reja

##### Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Veprimet në situatë

##### Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.5 në tekst – “Pothuajse çdo ditë interesohemi të dimë se si është dhe si do të jetë moti ditën tjetër në vendin ku jetojmë.



<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Rrugët nga mund ta marrim informacionin janë të ndryshme: televizioni, radioja, interneti, telefonat tanë celularë. Në këtë tabelë paraqitet moti në Tiranë përgjatë 24 orëve të datës 3 janar. Bazuar në të dhëna e saj, përshkruani ndryshimet e motit gjatë 24 orëve të kësaj dite. Cilat elemente të motit kanë ndryshuar më tepër? Çfarë lidhje shihni midis elementeve të motit?</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 11 dhe trajton së bashku me ta se si ndryshojnë elementet e motit: Trysnia atmosferike, temperatura, drejtimi i erës dhe lagështira relative janë elemente të motit, të cilat lidhen ngushtë ndërmjet tyre (fig. 11). Ndryshimi i njërit prej këtyre elementeve reflektohet te të gjitha të tjerat, duke shkaktuar kështu ndryshime të motit në një vend të caktuar. Për shembull, nëse temperaturat e ajrit rriten, ai blymehet e ngjitet lart duke u bërë më i lehtë dhe për pasojë, trysnia atmosferike ulet. Ndryshimet e vlerave të trysnisë atmosferike midis vendeve të ndryshme shkaktojnë lëvizje të masave ajrore ndërmjet tyre, pra erën. Gjatë lëvizjes, era ndikon më pas në ndryshimin e temperaturës dhe të lagështirës së ajrit. Kjo tregon se elementet e motit ndikojnë zinxhir te njëri-tjetri.</p> <p>Më tej mësuesi/ja fton nxënësit/et të përshkruajnë motin e paraqitur në hartën e figurës 12.</p> <p>Më tej mësuesja trajton rëndësinë e parashikimit të motit...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1,2,3 tek rubrika “Radha jote”. Lihet për detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## ■ Punë praktike 2.1 (2 orë)

- **Tema: Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta nga nxënësit/et, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin**

### *Rezultatet e të nxënit*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- ndërton instrumente për matjen e temperaturës së ajrit, të trysnisë atmosferike, të lagështirës së ajrit, të reshjeve, si dhe për përcaktimin e drejtimit e të shpejtësisë së erës;
- përdor këto instrumente për të mbledhur të dhëna që lidhen me motin;
- shpjegon raportin ndërmjet temperaturës ditore, trysnisë atmosferike, lagështirës relative dhe drejtimit e shpejtësisë së erës, për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve;
- bashkëpunon në grup dhe ndan me të tjerët njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.

### *Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:*

90 minuta (2 orë mësimore); në klasë.

*Materialet burimore:* teksti mësimor i Gjeografisë 7, interneti.

### *Disa njohuri paraprake mbi aparaturat që përdoren për matjen e elementeve të motit:*

Për të qenë sa më të saktë në parashikimet e tyre, meteorologëve u duhet të mbledhin të dhëna atmosferike deri **në lartësinë** 30 000 m. Këtë e arrijnë nëpërmjet përdorimit të teknologjive dhe të aparaturave të ndryshme, si: radarët dhe satelitët e motit, imazhet infra të kuqe, aparaturat digjitale. Për të matur vlerat e elementeve të motit **pranë sipërfaqes**, ata përdorin aparatura më të thjeshta si: termometër, barometër, higrometër, pluviometër etj. Këto gjenden në qendrat sinoptike. Edhe ju mund të ndërtoni aparatura të ngjashme, por më të thjeshta, të cilat do t'ju shërbejnë për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin.

### *Mjetet e punës:*

**Për ndërtimin e termometrit:** një vazo qelqi, ujë, alkool për përdorim të zakonshëm, ngjyrosës ushqimi (si p.sh. ngjyrosës vezësh), pipëz plastike, plastelinë, letër e bardhë dhe vizore.

**Për ndërtimin e barometrit:** një vazo qelqi, një tullumbace e madhe, një llastik, një gjilpërë, ngjitës, pipëz plastike, letër e bardhë.

**Për ndërtimin e flugerit:** pipëz plastike, pjatë; letër e bardhë, laps me gomë, gjilpëra me kokë, ngjitës, shenjues, plastelinë.

**Për ndërtimin e anemometrit:** pesë gota plastike, dy pipëza plastike, një laps (me gomë të papërdorur), kapëse letrash, gërshërë, ngjitës, gjilpëra me kokë, shenjues.

**Për ndërtimin e higrometrit:** Një copë dërrasë me përmasa 27.5 cm x 5 cm x 5 cm, një copë kartoni të hollë me përmasa 15 cm x 4 cm, një copë kartoni të fortë me përmasa 21 cm x 27.5 cm, laps, vizore, gërshërë, ngjitës, disa fije floku rreth 20 cm të gjata,

gjilpëra me kokë, lapsa me ngjyra.

**Për ndërtimin e pluviometrit:** Një shishe plastike dylitërshe, gërshërë, ngjitës shirit, vizore, shenjues.

### **Metodologjia që do të përdoret:**

Punë në grupe.

### **Alkool + ujëngjyrues**

### **Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:**

**A. Për ndërtimin e termometrit** (instrumenti që mat temperaturën e ajrit), veproni si më poshtë (fig. A/1):

1. Në kapakun e vazos prej qelqi bëni një brimë sa diametri i pipëzës plastike që keni zgjedhur.
2. Përzieni në pjesë të barabarta ujin me alkoolin dhe hidheni këtë përzierje në vazo, duke e mbushur deri në ¼-ën e saj.
3. Shtoni disa pika të ngjyrosësit të ushqimit te përzierja e ujit me alkoolin. Kjo ju bën të mundur të shihni ndryshimin e temperaturës kur lëngu i ngjyrosur të kalojë nëpër pipëzën plastike.
4. Futeni pipëzën plastike përmes brimës së bërë në kapak, aq sa të mos e prekë fundin e vazos (fig. A/2).
5. Mbështilleni me plastelinë pipëzën plastike në pjesën ku ajo hyn në vazo, për të siguruar kështu një mbyllje hermetike, dhe termometri juaj është gati për t'u përdorur.
6. Ngjitni në pjesën e jashtme të vazos një letër të bardhë, të vijëzuar, ose një vizore, për të parë sa ndryshon niveli i lëngut gjatë ndryshimit të temperaturës.

### **Për nxënësit më kureshtarë**

Për të parë se si mund të ndërtohet një termometër në kushtet e shtëpisë, mund ndiqni linkun e mëposhtëm: [https://www.youtube.com/watch?v=1LOk1XzbP\\_xg](https://www.youtube.com/watch?v=1LOk1XzbP_xg)

**Prova:** Provoni ta vendosni termometrin tuaj në ambiente të ndryshme (vendoseni atë një herë në një enë me ujë të ngrohtë dhe më pas, në një enë me ujë të ftohtë).

**B. Për ndërtimin e barometrit** (instrumenti që mat tryshninë atmosferike) veproni në këtë mënyrë:

1. Priteni tullumbacen në dy pjesë me madhësi të ndryshme (fig. B/1). Pjesën më të madhe të saj tendoseni mbi buzët e vazos së qelqit, duke e puthitur (si kapak) me anë të një llastiku (fig. B/2).
2. Ngjiteni pipëzën plastike mbi tullumbace me ngjitësin shirit (fig. B/3).
3. Në fund të pipëzës ngjitni një gjilpërë po me ngjitës shirit.
4. Shënoni mbi një copë letër të ngjitur në mur, disa vija të ndara me hapësira të barabarta midis tyre. Tashmë, barometri juaj është gati (fig. B/4).

**Për nxënësit më kureshtarë** Në linkun e mëposhtëm mund të shihni se si ndërtohet një barometër me mjetet përkatëse: <https://www.youtube.com/watch?v=ah8F-xmvB2k>

#### A/1

**C. Për ndërtimin e flugerit** (instrumenti që mat drejtimin e erës), veproni si më poshtë (fig. C/1):

1. Priteni pipëzën në mënyrë të tërthortë në të dyja anët, deri në 2 cm gjatësi.
2. Vizatoni në një letër të bardhë dy forma si në figurë dhe pritini ato. Ngjitini format nëpër prerjet e pjesëve anësore të pipëzës plastike.
3. Me anë të një gjilpëre me kokë, bashkoni mesin e pipëzës plastike me gomën e lapsit. Sigurohuni që pipëza plastike të rrotullohet lirshëm (fig. C/2).
4. Ngjiteni me plastelinë pjesën tjetër të lapsit, të vendosur vertikalisht me pjatën.
5. Shkruani mbi pjatë anët e horizontit: V (veriu), J (jugu), L (lindja), P (perëndimi).
6. Vendoseni flugerin në një mjedis të hapur, për të parë se nga cili drejtim fryn era (nëse flugeri tregon veriun, atëherë era vjen nga veriu).

**D. Për ndërtimin e anemometrit** (instrumenti që mat shpejtësinë e erës) veproni si më poshtë:

1. Merrni katër gota plastike dhe në secilën prej tyre hapni nga një brimë. Brima duhet të bëhet rreth 1.5 cm poshtë buzëve të gotës.
2. Merrni edhe një gotë tjetër dhe hapni në të dy brima (rreth 1.5 cm poshtë buzëve të saj) përballë njëra-tjetrës. Më pas, bëni edhe dy brima të tjera përballë njëra-tjetrës (secila 1 cm poshtë buzëve të gotës). Hapni edhe një brimë në fundin e gotës (në qendër), nëpër të cilën lapsi të kalojë lirisht (fig. D/1 dhe D/2).
3. Futini pipëzat plastike nëpër brimat e bëra, ashtu si në figurat D/2 dhe D/3.
4. Sigurohuni që gryka e secilës gotë të ndjekë fundin e gotës përbri. Çdonjëra nga katër gotat duhet të qëndrojë në pozicion anësor, si në figurën D/3.
5. Futeni lapsin nga pjesa e gomës përmes fundit të gotës së pestë. Në vazhdim, vendoseni gjilpërën me kokë në mënyrë të tillë që të bashkojë dy pipëza plastike (diagonale me njëra-tjetrën) me gomën e lapsit.

- Përdorim shenjuesin për të vënë një shenjë (p.sh. një X të madh) në fundin e njëres prej gotave anësore (fig. D/3).
- Anemometri juaj është gati për t'u përdorur. Vendoseni në një vend të hapur, ku fryn erë.
- Shikoni gotën e shënuar me X në fund të saj teksa rrotullohet. Numëroni sa herë rrotullohet kjo gotë brenda 10 sekondave dhe përdorni tabelën e mëposhtme për të vlerësuar shpejtësinë e erës.

Rrotullimet në 10 sekonda	2-4	5-7	8-9	10-12	13-15	16-18	19-21	22-23	24-26	27-29	30-32	33-35	36-37	38-40	41-43	44-46	47-49	50-51	52-54	55-57
Shpejtësia e erës në kilometra për orë (km/h)	2	3	5	6	8	10	11	13	14	16	18	19	21	23	24	26	27	29	31	32

**E. Për ndërtimin e higrometrit** (instrumenti që mat lagështirën e ajrit) veproni në këtë mënyrë:

- Vizatoni në një karton të hollë një shigjetë me përmasa 12.5 cm x 2.5 cm dhe pritni më pas me gërshtë.
- Ngjitni copën e kartonit të trashë mbi sipërfaqen e dërrasës.
- Fiksioni me një gjilpërë me kokë shigjetën mbi kartonin e trashë.
- Njërën anë të fijeve të flokut (të bashkuara si tufë) ngjiteni me qendrën e shigjetës, ndërsa anën tjetër, me kartonin e trashë si në fig. E.
- Vendoseni higrometrin jashtë. Shënoni në karton pozicionet e shigjetës dhe shkruani sipas rastit: “mot i lagësht” ose “mot i thatë” (me anë të shenjave konvencionale).

**Prova** Në ditë me ajër të lagësht, fija e flokut e thith lagështinë, si rrjedhojë, ajo zgjatet dhe shigjeta do të shkojë më poshtë. Ndërsa në

ditë të thata, kur fija e flokut thahet dhe bëhet më e shkurtër, shigjeta do të shkojë më sipër.

**F. Për ndërtimin e pluviometrit** (instrumenti që mat sasinë e reshjeve), veproni si më poshtë (fig. F):

- Priteni grykën e shishes plastike dylitërshe dhe kthejeni përmbys brenda pjesës tjetër, që të shërbejë si hinkë.
- Ngjitini bashkë të dyja pjesët në vendin ku takohen.
- Duke përdorur vizoren dhe shenjuesin, në anë të shishes, në të gjithë gjatësinë e saj ndërtoni një vijë të ndarë në centimetra.
- Në ditët me shi, vendoseni jashtë pluviometrin që ndërtuat. Pas shiut do të shikoni se sa ujë është mbledhur aty. Që shishja të mos bjerë gjatë matjes së sasisë së reshjeve në një mjedis të hapur, hidhni disa gurë ose rërë në fund të saj.
- Ndërtoni një tabelë, ku të shënoni sasinë e reshjeve të rëna gjatë një jave.

## Punë Praktike 2.2

- **Tema: Parashikimi i motit përmes leximit të hartave sinoptike dhe përdorimit të instrumenteve të thjeshta**

### *Rezultatet e të nxënës*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përdor dhe lexon harta të ndryshme sinoptike;
- parashikon dinamikën e motit përmes krahasimit të hartave sinoptike;
- përdor instrumentet që ka përgatitur vetë, për të matur elementet e motit;
- vëzhgon dhe interpreton të dhënat e regjistruara prej këtyre instrumenteve;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.

### *Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:*

45 minuta; në klasë.

### *Materialet burimore:*

Harta të ndryshme sinoptike, teksti mësimor i Gjeografisë 7, rubrika e parashikimit të motit në stacione të ndryshme televizive, interneti.

### *Mjetet e punës:*

Harta të ndryshme sinoptike, të siguruar përmes internetit ose prej mësueses, teksti mësimor, laps/ stilolaps, fletore/fletë formati A-4, tabak kartoni, lapsa me ngjyra/lapustila, instrumentet e matjeve të elementeve të motit, të përgatitura prej nxënësit/es (termometri, barometri, higrometri, pluviometri, anemometri dhe flugeri).

### *Metodologjia që do të përdoret:*

Punë në grupe.


### *Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike*

**A.** Lexoni hartën sinoptike të Evropës, të paraqitur në faqen pasuese (ose harta të tjera sinoptike, të siguruar nga interneti), duke përshkruar:

- **Vlerat e trysnisë atmosferike** në kontinentin tonë, në momentin e matjes së tyre (duhet të keni parasysh që vlerat e trysnisë atmosferike ndryshojnë në varësi të temperaturës së ajrit).
- **Numrin e qendrave atmosferike** me trysni më të lartë dhe atyre me trysni më të ulët, **llojin e masave ajrore** dhe të **fronteve atmosferike** që janë formuar (shënim: kur një

masë ajrore e ngrohtë lëviz drejt një mase ajrore të ftohtë, formon frontin e ngrohtë, dhe anasjelltas).

- **Drejtimin e erës** (duke pasur parasysh që era lëviz nga një vend me trysni të lartë drejt një vendi me trysni të ulët);



**Llojet e reshjeve** që sjellin këto masa ajrore të paraqitura në hartë.

**B.** Nxirrni përfundimet mbi veçoritë që paraqet moti në këtë moment fotografimi në hartë, duke i shënuar ato në fletore/fletë formati A-4. Diskutoni me të tjerët mbi punën e përgatitur.

**C.** Nëse keni siguruar nga interneti harta sinoptike që paraqesin motin për disa ditë rresht, vëzhgoni se si ndryshojnë elementet e tij nga njëra hartë në tjetrën. Mbi bazën e ndryshimeve që dalloni, mund të bëni parashikimin e motit për ditët në vazhdim.

**D.** Për të paraqitur dhe parashikuar motin në vendbanimin tuaj, shfrytëzoni të dhënat e regjistruara prej instrumenteve që keni përgatitur mbi temperaturën, trysninë atmosferike, lagështinë e ajrit, sasinë e reshjeve, shpejtësinë dhe drejtimin e erës. Mbi bazën e këtyre të dhënave, vizatoni me lapsa me ngjyra gjendjen e elementeve të motit (duke përdorur shenjat konvencionale) për ditët që keni përzgjedhur të analizoni dhe më pas prezantoheni punën tuaj (si në figurën përbri).

Diskutoni me njëri-tjetrin mbi përfundimet e arritura.

## Tema mësimore: II.6

### Klima

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.6 Klima</b>	

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

##### 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)

- Shpreh mendimin e vet mbi klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve etj dhe mbi faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

##### 2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)

- Përdor analizën për të shpjeguar marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar klimën si ndryshim afatgjatë i këtyre treguesve.

##### 3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)

- Nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit, shfrytëzon të dhënat për të përshkruar klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve;

Identifikon: - faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;

##### 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup

##### 5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)

- Ndan mendimet në grup.

##### 6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.

##### 7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.



## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja përshkuan elementet e klimës si një ndryshim afatgjatë.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të dalluar klimën.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja përshkruan klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve; Identifikon:  
- faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja përshkruan klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve; Identifikon: - faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;

**Fjalët kyçe:** klimë, gjerësi gjeografike, qarkullimi i masave ajrore, relief.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et kanë njohuri mbi:  
Në glob ka larmi klimash.  
Disa faktorë që ndikojnë në klimën e vendit tonë.

**b. Ndërtimi i njohurive të reja**

#### **Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Veprimet në situatë

#### **Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.6 në tekst – “Klima e vendit tonë ka tipare të ndryshme nga ajo e shumë vendeve të tjera, që ndodhen pranë apo larg nesh (risjellim në vëmendje se çfarë veçorish ka klima e Shqipërisë dhe e vendbanimit tonë). Si mendoni, cilët mund të jenë faktorët që ndikojnë në klimën e një vendi?”

Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Mesatarja e të gjitha kushteve të motit të një vendi (temperaturës, trysnisë atmosferike, lagështirës, ditëve me diell etj.) për një periudhë afatgjatë (30-vjeçare) quhet klimë. Ajo, në dallim nga moti, është më e qëndrueshme. Nëse elementet e motit në një vend të caktuar të globit mund të ndryshojnë në çdo kohë, klima atje ka pothuajse të njëjtat tipare për periudha të gjata kohore.</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 13 dhe të përshkruajnë se si ndryshojnë elementet e klimës sipas gjerësive gjeografike.</p> <p>Në vazhdim fton nxënësit/et të përshkruajnë përmbajtjen e figurave 14 dhe 15. Në vazhdim nxit përgjigjet e nxënësve: Përshkruaj se si ndikon relievi në klimën e vendit ku ti jeton.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1,2,3 tek rubrika “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.7 Klima (vazhdim)

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.6 Klima (vazhdim)	
<p align="center"><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet mbi faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.</li> </ul>			

<p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor analizën për të kuptuar klimën si ndryshim afatgjatë i këtyre treguesve.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikon: - faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja rendit faktorët që ndikojnë mbi klimë.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna për llojet e klimave në botë.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës;</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> afërsia me sipërfaqet ujore, rrymat oqeanike e detare, bimësia, veprimtaria njerëzore.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b></p>	<p>Nxënësit/et kanë njohuri mbi: Në glob ka larmi klimash. Disa faktorë që ndikojnë në klimën e vendit tonë.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.7 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Veprimet në situatë</p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.7 në tekst – “Në mësimin e mëparshëm, trajtuam disa prej faktorëve që ndikojnë mbi klimën e një vendi. Përveç tyre, mësuaam që mbi klimë ndikojnë edhe rrymat oqeanike/detare, afërsia me sipërfaqet ujore, bimësia, veprimtaria njerëzore. Si mendoni, cili prej këtyre faktorëve ndikon më tepër në klimën e vendit tonë? Po në klimën e vendbanimit tuaj?</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë me radhë faktorët e tjerë që ndikojnë mbi klimë. Nxënësit përshkruajnë fig 16. Më pas ajo orienton nxënësit që bazuar në hartën e zonave klimatike të: a) evidentojnë llojet e klimave në brigjet e kontinenteve dhe në brendësi të tyre, në Ekuator, në gjerësitë mesatare, në gjerësitë polare, si dhe në zonat malore dhe të vrojtojnë gjithashtu klimat në Gadishullin Skandinav.</p> <p>b) të rendisin faktorët që ndikojnë në shumëllojshmërinë e klimave në botë.</p> <p>Ajo fton nxënësit/et të lexojnë në tekst rëndësinë e klimës dhe të sjellin shembuj të tyre për ilustrim.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Nxënësit/et punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1,2,3 tek rubrika “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.8

### Njeriu dhe ndryshimet klimatike

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.8 Njeriu dhe ndryshimet klimatike	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet mbi rolin e veprimtarisë njerëzore mbi klimë (p.sh. shtimi i gazeve serë);</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor argumente për të evidentuar rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi).</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi/ja argumenton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi ) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serë).</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b></p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja bën dallimin midis efektit serë natyral dhe atij të shtuar prej veprimtarisë njerëzore,</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna për ndryshimet klimatike që po ndodhin në planet dhe pasojat që rrjedhin prej tyre.</p>			

<b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi/ja argumenton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi ) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serrë).	
<b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja argumenton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serrë). Evidenton pasojat që rrjedhin prej ndryshimeve klimatike.	<b>Fjalët kyçe:</b> efekti serrë, ngrohja globale, pasojat e tyre.
<b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve	
<b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b>	Nxënësit/et kanë njohuri mbi: Ndryshimet që po ndodhin në klimë
<b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.8 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). <b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.8 në tekst – “Risjellim në vëmendje çfarë kemi mësuar mbi rëndësinë e atmosferës. Në Tokë do të kishte diferenca të mëdha midis temperaturave të ditës dhe të natës, nëse nuk do të ishte atmosfera. Ajo e mban nxehtësinë konstante, duke e qarkulluar atë nga njëri vend te tjetri. Disa shtresa të saj veprojnë si një filtër për rrezet diellore. Cilat janë këto shtresa? Si dhe sa ndikon rrezatimi diellor mbi klimë? Po klima si ndikon mbi jetën tonë?” Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...	

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë efektin serë natyral të atmosferës së planetit dhe atë shtuar prej veprimtarisë njerëzore. Kështu mësuesja sqaron: Elemente përbërëse si dioksidi i karbonit, avujt e ujit e disa gaze të tjerë, edhe pse zënë përqindje shumë të vogël në atmosferë, luajnë rol shumë të rëndësishëm për temperaturat e ajrit, pra për klimën e planetit tonë. Ata lejojnë të mbërrijë në Tokë rrezatimi diellor dhe mbajnë në atmosferën pranë sipërfaqes së saj rrezatimin tokësor. Ky proces quhet efekti serë dhe është një proces vetërregullues i atmosferës. Nëse nuk do të ndodhte, temperatura mesatare vjetore e ajrit do të ishte me vlera negative. Gjatë shekullit të fundit, përmes aktivitetit të tij, njeriu e ka rritur ndjeshëm efektin serrë, sepse ka shtuar përqindjen e dioksidit të karbonit, pluhurave, avujve të ujit dhe të gazeve të dëmshme në atmosferë. Kjo ka ndodhur prej rritjes së përdorimit të lëndëve djegëse (nafta, gaz, qymyri), pakësimit të sipërfaqeve pyjore, shtimit të erozionit të tokave, përdorimit pa kriter të kimikateve në bujqësi etj. Çlirimi me shumicë i gazeve serrë ka rritur përqendrimit të tyre në atmosferë dhe për rrjedhojë, përherë e më shumë po ndikon në rritjen e vazhdueshme të temperaturës mesatare globale të ajrit, pra në ngrohjen globale.</p> <p><b>Fton nxënësit/et të përshkruajnë figurën 18.</b></p> <p>Në vazhdim ftohen nxënësit/et të përshkruajnë figurën 19 a/b/c/d/e/ dhe bashkë me mësuesin/en trajtojnë pasojat e ndryshimeve klimatike.</p> <p>Fton nxënësit/et të sjellin shembuj nga e përditshmja e tyre.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Nxënësit/et sjellin shembuj të ndryshimeve klimatike që vënen në të përditshmen e tyre. Në vazhdim punojnë me ushtrimet 1,2,3 tek rubrika “Radha jote”. Jepet si detyrë për në shtëpi ushtrimi 4 (me qëllimin që përgjigjet e dhëna në klasë, t’i detajojnë më tepër duke i konsultuar edhe me prindërit)</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.9

### Zonat klimatike

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.9 Zonat klimatike	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet mbi veçoritë e zonave kryesore klimatike në botë;</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor krahasimin për të identifikuar zonat kryesore klimatike në botë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi/ja identifikon zonat kryesore klimatike në hartë.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>			
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja identifikon zonat kryesore klimatike në hartë.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna për zonat kryesore klimatike në botë dhe vlerëson ndryshimet midis tyre.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja identifikon zonat kryesore klimatike në botë.</p>			



<p><b>Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja identifikon zonat kryesore klimatike në hartë.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> klima e zonës së nxehtë, klima e zonave mesatare klima e zonave të ftohta</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë: Që klima ndryshon nga ekuatori në pole; Q në Tokë formohen brezat e nxehtësisë.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.9 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). <b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.9 në tekst – “Siç e dimë, rrezatimi diellor shpërndahet në mënyrë të pabarabartë mbi sipërfaqen e Tokës. Kjo bën që në planetin tonë të formohen brezat (zonat) e nxehtësisë. Cilët janë ata? Sipas jush, çfarë klime kanë?” Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b> Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë zonat klimatike që formohen në planetin tonë. Kështu mësuesja sqaron: Secila prej zonave të nxehtësisë ka veçoritë e veta klimatike. Kështu, duke shkuar nga Ekuatori në pole, dallojmë llojet e klimave të mëposhtme. Klima e zonës së nxehtë, e cila shtrihet midis Tropikut të Veriut dhe Tropikut të Jugut, përfshin klimën ekuatoriale dhe klimën tropikale. Vendet që ndodhen në të dyja anët e Ekuatorit kanë klimë ekuatoriale. Për shkak të sasisë së njëjtë të rrezatimit diellor që marrin gjatë gjithë vitit, ato kanë vetëm një stinë, e cila karakterizohet nga temperatura të larta deri në mesditë dhe reshje të shumta çdo pasdite. Duke u larguar nga Ekuatori drejt tropikëve, të gjitha vendet kanë klimë tropikale, në të cilën dallohen dy stinë. Pranë tropikëve, për shkak të masave ajrore të thata dhe mungesës së reshjeve, në brendësi të kontinenteve janë formuar sipërfaqe të mëdha shkretinore. Fton nxënësit të shohin figurat 20 dhe 21, dhe të përshkruajnë mjediset që krijohen në kushtet e klimës ekuatoriale dhe asaj tropikale.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Në vazhdim mësuesi/ja trajton veçoritë e zonës klimatike mesatare: Klima e zonave mesatare, të cilat shtrihen midis tropikëve dhe rrrathëve polare në të dyja hemisferat, përfshin: klimën mesatare oqeanike, klimën mesatare kontinentale dhe klimën subtropikale (ku bën pjesë klima mesdhetare, që ka edhe vendi ynë). Në këtë zonë dallohen të katërta stinët e vitit. Vendet me klimë mesatare oqeanike kanë verë të ngrohtë e të thatë dhe dimër të ftohtë e të lagësht. Vendet me klimë mesatare kontinentale karakterizohen nga diferenca të mëdha të temperaturës dhe sasi jo të mëdha. Klima e zonave të ftohta ose polare, që shtrihen midis rrrathëve polare dhe poleve në të dyja hemisferat, karakterizohet nga temperatura shumë të ulëta (temperatura mesatare është gjithmonë nën 00), reshje në formë bore, akuj të përhershëm dhe erëra të forta. Në këto zona dallohen dy stinë.</p> <p>Në vazhdim, fton nxënësit të përshkruajnë figurat 22, 23 dhe të përshkruajnë mjedisin që krijohet në kushtet e klimës mesatare mesdhetare dhe klimës polare.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Në vazhdim plotësojnë ushtrimin 1 të rubrikës “Radha jote”. Mësuesja ndihmon nxënësit të japin përgjigjet e duhura për ushtrimin 2.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## ■ Punë Praktike 2.3

- **Tema: Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas zonave të nxehtësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve klimatikë për vende të ndryshme në to (2 orë)**

### *Rezultatet e të nxënësit*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përdor dhe plotëson harta të ndryshme, ku paraqiten zonat klimatike të botës;
- ndërton dhe krahason grafikë klimatikë për zona të ndryshme;
- interpreton ndryshimet e temperaturës dhe reshjeve në grafikët që prezantojnë klimën

e zonave të ndryshme, duke i parë të lidhura me faktorët që ndikojnë;

- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.
- demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup.

### ***Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:***

90 minuta (dy orë mësimore); në klasë.

### ***Materialet burimore:***

Harta klimatike e botës, teksti mësimor i Gjeografisë 7, enciklopedi, atlasit gjeografik, interneti.

### ***Mjetet e punës:***

Harta klimatike e botës, teksti mësimor, laps/stilolaps, fletore/fletë formati A-4, lapsa me ngjyra/lapustila.

### ***Metodologjia që do të përdoret:***

Punë individuale.

### ***Puna përgatitore:***

Për realizimin e kësaj pune praktike, mbështetuni në të dhënat e tabelave 1, 2 dhe në hartën që paraqet zonat e nxehtësisë.

### ***Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:***

- Ndërtoni grafikët me të dhënat e tabelave 1 dhe 2, që paraqesin vlerat mesatare të temperaturave dhe sasinë mesatare të reshjeve të çdo muaji, për vende që ndodhen në breza klimatike të ndryshëm. Ndërtoni në të njëjtin grafik kurbat e vlerave të temperaturës dhe të reshjeve të një vendi në gjithë muajt e vitit. Përsëriteni këtë për të gjitha vendet e treguara në tabelë.

<b>Sasia mesatare e reshjeve sipas muajve (në mm) për disa stacione meteorologjike</b>												
<b>Vendet/Muajt</b>	<b>Janar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>	<b>Prill</b>	<b>Maj</b>	<b>Qershor</b>	<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>
Londër	70	90	110	85	50	40	45	78	80	107	113	65
Republika e Kongos	154	140	162	201	174	77	29	129	226	253	195	128

Algjeria	116	76	57	65	36	14	2	4	27	84	93	117
Irkutsk (Rusi)	12.4	8.5	10.8	18.9	32.9	61.9	120.1	82.6	50.2	29.9	18.3	19.2
Antarktida	50	40	70	50	8	7	15	20	18	110	100	50
Shqipëria	132	120	100	87	99	60	28	39	73	157	152	142
Sudan	15	30	70	100	150	170	110	70	15	710	0	0

Vëzhgoni dhe mbani shënime për secilin stacion meteorologjik, duke evidentuar se në cilët muaj paraqiten vlerat më të larta dhe më të ulëta të temperaturës, si dhe sasinë më të mëdha dhe më të vogla të reshjeve përgjatë vitit.

- Gjeni në hartën e botës, të ekspozuar në klasë, pozitën gjeografike të secilit vend që ndodhet në tabelat 1 dhe 2. Përmes një shenje dalluese, përcaktoni vendndodhjen e secilit prej këtyre vendeve në hartën klimatike (skicë) të tekstit;
- Përcaktoni se çfarë klime ka secili prej këtyre vendeve (bazuar në vlerat e temperaturave, sasinë e reshjeve dhe në ecurinë e tyre përgjatë vitit).
- Interpretoni ndryshimet që vihen re në vlerat e temperaturave dhe në sasinë e reshjeve në secilin prej grafikëve, duke i lidhur ato me faktorët që ndikojnë.
- Plotësoni në hartën skicë tipat e klimave dhe evidentoni në hapësirat e lëna bosh veçoritë që ka secila prej tyre. Vendosni në hartë edhe vlerat e gjerësive gjeografike të kufijve ndarës midis brezave të nxehtësisë.
- Ndani me të tjerët përfundimet dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale

## Nëntematika II

### Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë

#### ▪ Përsëritje II Tema Atmosfera

##### 1. E vërtetë apo e gabuar?

- Mbështjellja ujore e Tokës quhet atmosferë. **V G**
- Rrezatimi diellor është burimi i jetës në Tokë. **V G**
- Grimcat e pluhurit në atmosferë janë elemente të gazta. **V G**
- Ajri pranë sipërfaqes së Tokës ngrohet nga rrezatimi tokësor. **V G**
- Kur moti është i kthjellët dhe pa re, sasia e rrezatimit diellor që vjen në Tokë është më e madhe. **V G**

**2. Përcakto:**

- a) në grafikun 1, se sa për qind zë secili element në përbërjen e atmosferës dhe përshkruaj rolin e tyre;
- b) në figurën 2, se cilat janë shtresat që përbëjnë atmosferën dhe përshkruaj veçoritë e tyre.

**3. Diskuto** mbi pyetjet:

- a. Pse ka rëndësi prania e atmosferës?
- b. Cilët janë faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e nxehtësisë në planet?
- c. Ku ndryshon rrezatimi diellor nga rrezatimi tokësor?
- d. Përse është i rëndësishëm rrezatimi diellor?
- e. Cilat janë pasojat që vijnë nga shpërndarja e pabarabartë e nxehtësisë?
- f. Pse ka rëndësi shqyrtimi i elementeve të motit dhe parashikimi i tij?
- g. Si ndryshojnë elementet e motit?
- h. Cilët janë faktorët që ndikojnë mbi klimën?
- i. Ku qëndron dallimi midis motit dhe klimës?
- j. Çfarë pasojash sjellin në jetën tonë dhe në planet ndryshimet klimatike?

**4. Argumento** se ku ndryshon “efekti serrë” natyral i atmosferës së Tokës nga ajo që po ndodh gjatë këtij shekulli prej rritjes së aktivitetit njerëzor.

**5. Përcakto** në hartën klimatike të botës (të ekspozuar në klasë), brezat e nxehtësisë dhe klimat e tyre.

**Përshkruaj** veçoritë që kanë klimat që formohen në secilin prej këtyre brezave.

**6. Lidh me shigjetë** alternativat e duhura.

- |                                  |  |
|----------------------------------|--|
| 1. Shtimi i gazeve serrë         | a) është gjendja e atmosferës në një çast të dhënë, në një vend të caktuar.  |
| 2. Klima                         | b) krijon brezat e nxehtësisë.   |
| 3. Ngrohja e pabarabartë e Tokës | c) është mesatarja e vlerave të temperaturës, trysnisë atmosferike, lagështirës, ditëve me diell etj., për një periudhë afatgjatë. |
| 4. Moti                          | d) sjell ngrohjen globale.   |

## ■ Testim 2 Atmosfera

(shih planin vjetor dhe atë të tremujorit të parë për orën se kur bëhet testimi)

**Shënim 1:** Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit: njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipat ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (të tekstit). Pyetjet e përsëritjes mund t'i përdorni për pyetje testimi dhe gjatë orës së përsëritjes të formuloni edhe pyetje të tjera.

**Shënim 2:** Në orën e përsëritjes dhe të testimit, në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi/ja duhet të vlerësohet për shkallën e perceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënësit dhe zbatimeve të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi/ja mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit për t'i shpjeguar ato me fjalët e tij, por sidomos në aftësinë për t'i zbatuar ato. Pra i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues të nxënësit.

## Projekt (ora e parë)

- **Tema: Çështjet mjedisore të ujërave pranë vendbanimit tim**

### Rezultatet e të nxënësit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të kenë: lumi, liqeni, hapësira bregdetare, burimet ujore pranë vendbanimit të tij;
- hulumton mbi një çështje mjedisore që lidhet me ujërat në zonën e tij dhe identifikon problemin;
- përcakton faktorët e mundshëm që shkaktojnë problematikën mjedisore;
- identifikon disa zgjidhje të mundshme;
- vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- ndan me grupin e punës idetë dhe përfundimet individuale;
- u bën thirrje moshatarëve dhe komunitetit për të qenë aktivë në zgjidhjet e problemeve të tilla.

### **Burimet kryesore të informacionit:**

Teksti mësimor i Gjeografisë 7, materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara një vit më parë për realizimin e projektit të Gjeografisë 6; vëzhgime të nxënësve në terren; biseda me më të rriturit e familjes dhe komunitetin përkatës; të dhëna dhe analiza të marra pranë pushtetit lokal; informacione të siguruar nga interneti, institucione apo organizata mjedisore, media dhe shtypi;

### **Metodologjia që do të përdoret:**

Punë në grupe, hulumtim, intervista, anketim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

### **Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:**

Teksti mësimor, materiale të printuara informacione nga shtypi i shkruar, kompjuter, vid-eoprojektor, tabelë

prezantimi, shenjues, fletëpalosje, postera, fotografi të ndryshme, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

### **Udhëzimet për realizimin e projektit:**

- diskutohet mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të kenë: lumi, liqeni, hapësira bregdetare, burimet ujore pranë vendbanimit tënd; prezantohen këto potenciale me anë të albumeve, fletëpalosjeve, eseve, materialeve të përgatitura me *PowerPoint*, apo dhe në formë maketi, videoje;
- hulumtohet mbi një ose disa çështje mjedisore që lidhen me ujërat e zonës ku banon;
- identifikohet problemi dhe paraqitet në klasë;
- përcaktohen faktorët e mundshëm që kanë shkaktuar ose vazhdojnë të shkaktojnë këtë problematikë mjedisore;
- ofrohen zgjidhje për minimizimin e problemit;
- vlerësohen përfitimet dhe rreziqet që vijnë prej zgjidhjeve të mundshme;
- përgatiten fletëpalosje ose postera, në të cilat paraqitet problematika mjedisore, shkalla e ndërhyrjes së shtetit dhe komunitetit për përmirësimin e gjendjes, si dhe rrugët e zgjidhjes. Këto fletëpalosje mund të shërbejnë në veprimtari të ndryshme, të organizuara nga shkolla për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

**Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit:**

Ndahen nxënësit në grupe, me nga katër anëtarë secili;

- Njihen nxënësit me përmbajtjen e projektit, burimet e informacionit dhe me mënyrat si punohet me to. Nxënësit japin idetë e tyre.
- Mësuesi/ja jep sugjerime mbi shpërndarjen e punës brenda grupit.
- Nxënësit/et ndajnë rolet brenda grupit.

### Shënim

Në përfundim të projektit (në orën e katërt të planifikuar) do të bëhet prezantimi i punës së kryer. Deri në fazën e prezantimit, gjatë orës së dytë dhe të tretë të projektit nxënësit mund t'i referohen rubrikës “Udhëzimet për realizimin e projektit”, paraqitur më sipër.

## Tema mësimore: II.10 Cikli i ujit

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.10 Cikli i ujit	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet mbi lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën;</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje, komente, sqarime.</li> </ul>			
<b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor shembuj për të interpretuar cilin e ujit në atmosferë;</li> </ul>			
<b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi/ja interpreton lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën.</li> </ul>			
<b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup</li> </ul>			
<b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul>			



<p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b></p>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja vëzhgon lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën;</p>	
<p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna se si ndodh cikli i ujit në atmosferë;</p>	
<p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja përkufizon kuptimin mbi hidrosferën si dhe interpreton lidhjen midis saj dhe litosferës, atmosferës, biosferës;</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja interpreton lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën si dhe ciklin e ujit në planet;</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> hidrosferë, cikli i ujit</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>Disa prej pjesëve që përfshihen në konceptin hidrosferë;</p> <p>Që rrezatimi diellor është burimi i energjisë për çdo gjë në Tokë.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.10 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.10 në tekst – “Në mësimin e parë të Gjeografisë 7 mësuam se në planetin tonë, uji është i pranishëm në të gjitha format e tij, për shkak të atmosferës dhe distancës Tokë-Diell. Si mendoni, a mund të shterojë uji ndonjëherë? Jepni disa shembuj.”</p> <p>Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...</p>


<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë kuptimin mbi hidrosferën. Kështu, ai/ajo sqaron: Mbështjellja ujore e planetit tonë quhet hidrosferë. 97% e saj është ujë i kripur dhe gjendet në formën e deteve dhe oqeaneve, ndërsa 3% është ujë i ëmbël dhe gjendet në liqene, lumenj, përrenj, ujëra nëntokësore, burime, si dhe në formën e borës e të akullnajave.</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja fillon të trajtojë ciklin e ujit: Në planetin tonë, uji është gjithmonë në lëvizje, duke ndryshuar si rrjedhojë edhe gjendjet e tij (të lëngët, të gaztë dhe të ngurtë). Ai lëviz nga hidrosfera në atmosferë, litosferë dhe në biosferë, duke krijuar edhe lidhje midis këtyre mbështjelljeve.</p> <p>Në vazhdim, bazuar në figurat 24, 25 mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë me fjalët e tyre, format në të cilat gjendet uji në secilën prej mbështjelljeve gjeografike të planetit dhe ciklin e ujit në planet.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Në vazhdim nxënësit/et plotësojnë ushtrimin 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.11

### Veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve

<p><b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b></p>	<p><b>LËNDA: GJEOGRAFI</b></p>	<p><b>SHKALLA: III</b></p>	<p><b>KLASA: VII</b></p>
<p><b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b></p>		<p><b>Tema mësimore: II.11 Veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve</b></p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin e vet mbi veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia);</li> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth kësaj tematike që trajtohet duke bërë pyetje dhe sqarime.</li> </ul>			

<p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese,)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor shembuj për të identifikuar veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë,)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësi/ja identifikon se si ndryshojnë temperatura e kripësia (dendësia) e ujit të deteve/ oqeaneve, sipas gjerësive gjeografike.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, për realizimin e punës në grup.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit dhe të gjetjeve të ndryshme.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja vëzhgon lidhjen midis veçorive të ujit të deteve dhe oqeaneve dhe gjerësive gjeografike.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Përmes hartave nxënësi/ja mbledh të dhëna se si ndodhin këto ndryshime.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia) dhe ndryshimet e tyre në oqeanin botëror.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia).</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> kripësia e ujërave oqeanike/detare, dendësia dhe temperatura e tyre.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë: Që ujërat detarë/oqeanikë ndryshon temperatura dhe kripësia.</p>


	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.11 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Continents and Oceans</p>  <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.11 në tekst – “Plotësojmë në hartën skicë të mëposhtme oqeanet e botës dhe përshkruajmë se midis cilave kontinente ndodhen. Siç e shohim, ato duken si një tërësi ujore që rrethon kontinentet. Si mendoni, a kanë të gjitha oqeanet të njëjtën kripësi, dendësi dhe temperaturë të ujit?”</p> <p>Nxënësit/et plotësojnë hartën dhe përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit/et të lexojnë informacionin e tekstit. Më pas së bashku me ta, bazuar edhe në figurat 26, 27 vazhdon të trajtojë veçoritë e ujërave oqeanikë e detarë: Planeti ynë quhet ndryshe edhe “planeti blu”, sepse rreth 71% të sipërfaqes së tij e përbëjnë oqeanet, pjesë e së cilave janë detet. Sipërfaqja ujore është më e madhe në Hemisferën Jugore, ku shkon deri në 81%, krahasuar me Hemisferën Veriore, në të cilën oqeanet dhe detet zënë 61% të sipërfaqes. Thellësia mesatare e oqeanëve shkon në 3800 m...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Në vazhdim nxënësit/et diskutojnë mbi ushtrimet 1, 2, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>


## Tema mësimore: II.12

### Lëvizjet e ujërave oqeanike. Valët detare

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.12 Lëvizjet e ujërave oqeanike. Valët detare	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth dallimit ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi valët detare, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton faktorët që ndikojnë në formimin e valëve detare, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			

<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</p> <p>Nxënësi/ja dallon faktorët që ndikojnë mbi valët detare dhe elementet e valës;</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja vlerëson rolin e faktorëve në madhësinë e valëve që formohen.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë mbi valët detare, rrymat oqeanike, baticat dhe zbaticat; evidenton llojet e valëve sipas origjinës dhe elementet e saj.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënët të temës mësimore:</b> Nxënësi, bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë mbi valët detare, rrymat oqeanike, baticat dhe zbaticat. Evidenton llojet dhe elementet e valëve.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> valë detare, cunam, kreshtë, bazë, gjatësi e valës, lartësi e valës, tallaz.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë:</p> <p>Uji detar vazhdimisht është në lëvizje;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.12 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shohin figurën e paraqitur në rubrikën “diskutojmë” dhe të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: Gjatë pushimeve në bregdet, kemi vënë re se deti herë është i qetë e herë me dallgëzime të vogla ose të mëdha. Në figurën e mëposhtme, deti paraqitet i dallgëzuar. Si mendoni, nga se formohen këto dallgëzime?”</p> <p>Nxënësit/et të diskutojnë..</p>



<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Ujërat e oqeaneve dhe të deteve janë gjithmonë në lëvizje. Në sipërfaqe, lëvizjet janë në formën e valëve, ndërsa më në brendësi, në formën e rrymave detare ose oqeanike. Po kështu, çdo 24 orë uji i deteve dhe oqeaneve përparon dhe tërhiqet nga toka në mënyrë periodike, në formën e baticës dhe zbatcës. Të gjitha këto lëvizje të ujërave shkaktohen nga veprimi i disa faktorëve, të cilët do t'i trajtojmë në vazhdimësi.</p>  <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurat 28 e 29 dhe ndërkohë mësuesi/ja trajton së bashku me nxënësit/et llojet e valëve dhe elementet e tyre: <b>Vala</b> është një nga lëvizjet e dukshme të ujërave oqeanike ose detare. Shkaku më i zakonshëm i formimit të saj është era, që fryn mbi sipërfaqen e ujit. Në varësi të forcës së erës ndryshon edhe madhësia e valës, e cila varion që nga valëzimet e ulëta e deri tek ato më të larta (12 m lartësi). Pika më e lartë e një vale është <b>kreshta</b>, ndërsa pika më e ulët e saj është <b> baza</b>. Distanca vertikale ndërmjet kreshtës dhe bazës quhet <b>lartësi e valës</b>, kurse largësia horizontale nga njëra kreshtë në tjetrën ose nga njëra bazë në tjetrën, quhet <b>gjatësi e valës...</b></p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit/es</b></p>	<p>Vlerësimi i nxënësit fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.13

### Baticë-zbaticat

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.13 Baticë-zbaticat</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth dallimit ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi baticë-zbaticat, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpretin faktorët që ndikojnë në formimin e baticë-zbaticave, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			



<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi/ja dallon faktorët që ndikojnë në formimin e baticë-zbaticave;</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi/ja vlerëson rolin e faktorëve në madhësinë e baticë-zbaticave që formohen.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet valëve dhe baticë-zbaticave, si dhe faktorëve që ndikojnë në formimin e tyre.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet valëve dhe baticë-zbaticave, si dhe faktorëve që ndikojnë në formimin e tyre. Evidenton llojet e baticave.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> baticë; zbaticë</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Uji detar vazhdimisht është në lëvizje dhe niveli i ujit në bregdet ndryshon disa here gjatë ditës;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Ër të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.13 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shohin figurën e paraqitur në rubrikën “diskutojmë” dhe të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: Nëse jemi të vëmendshëm, në ditët e pushimeve mund të vëmë re që gjatë 24 orëve, niveli i ujit në bregun e detit ndryshon. Kjo mund të dallohet qartë, sidomos kur ndodhemi pranë ndonjë moli apo trampoline.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Në mëngjes herët dhe pasdite, kolonat e molit e të trampolinës dallohen lehtësisht, ndërsa në mesditë uji mbulon një pjesë të madhe të tyre. Këtë ndryshim mund ta vëmë re edhe nëse kemi zgjedhur të qëndrojmë nën një çadër pranë bregut. Në mesditë, uji mund të na vijë deri te çadra. A e dini se pse ndodh ky ndryshim i nivelit të ujit në bregdet?</p> <p>Nxënësit/et të diskutojnë..</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin pamjet (a) e (b) të figurës 30 dhe ndërkohë mësuesi/ja trajton së bashku me ata/ato formimin e baticë-zbaticave.</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja u drejtohet nxënësve/eve: Bazuar në këtë figurë: 1. përshkruaj me fjalët e tua ndryshimin që vë re në nivelin e ujit në bregdet gjatë një dite; 2. kujto dhe trego nëse e ke vënë re këtë ndryshim të nivelit të ujit në bregdet gjatë pushimeve. Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p>Në vazhdim mësuesja vazhdon: Siç e dimë, baticë-zbatica është ndryshimi ciklik i nivelit të ujit në bregdet gjatë 24 orëve. Ajo formohet si rezultat i forcës tërheqëse të Hënës ndaj Tokës, forcës tërheqëse të Diellit ndaj Tokës dhe i forcës centrifugale të Tokës (ose kundërvepruese të Tokës ndaj forcës tërheqëse të Hënës). Baticat dhe zbaticat hënore janë dy herë më të mëdha se ato të shkaktuara nga forca tërheqëse e Diellit. Megjithëse Hëna ka përmasa shumë të vogla (krahasuar me Diellin), për shkak të afërsisë së saj me Tokën, forca tërheqëse që ushtron mbi të është tepër e ndjeshme. Disa prej baticave mund të jenë më të mëdha apo më të vogla se ato që ndodhin zakonisht...</p> <p>Ftohen nxënësit/et të përshkruajnë paraqitjen skematike e baticave më të larta dhe atyre më të ulëta në figurën 31.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyre klase ushtrimet 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.14

### Rrymat oqeanike

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.14 Rrymat oqeanike</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth dallimit ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi rrymat oqeanike, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton faktorët që ndikojnë në formimin e rrymave oqeanike, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul> </li> </ol>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja dallon faktorët që ndikojnë mbi rrymat oqeanike;

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson rolin e faktorëve që ndikojnë në formimin e rrymave oqeanike.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë mbi valët detare, rrymat oqeanike, baticat dhe zbaticat; evidenton llojet e rrymave që formohen.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeaneve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë mbi valët detare, rrymat oqeanike, baticat dhe zbaticat. Evidenton llojet e rrymave oqeanike/detare.

**Fjalët kyçe:** rrymë e ngrohtë, rrymë e ftohtë.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve

#### a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Nxënësit/et dinë:  
Rrymat oqeanike ndikojnë në klimë;

#### b. Ndërtimi i njohurive të reja

##### Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.14 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

##### Veprimet në situatë

##### Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja fton nxënësit/et të diskutojnë rreth përmbajtjes së rubrikës “diskutojmë”: “Risjellim në vëmendje informacionet mbi rrugën që përshkon rrymat e Golfstrimit dhe për ndikimet e saj në klimën e vendeve pranë të cilave kalon. Përveç kësaj rryme ka edhe shumë të tjera që ndikojnë ndjeshëm në klimën e vendeve të ndryshme. Një pjesë e tyre sjell rritje të temperaturave, ndërsa disa të tjera i ulin ato. Por, pse formohen dhe lëvizin rrymat oqeanike?”

Nxënësit/et të diskutojnë mes tyre.

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Masat e mëdha ujore, që lëvizin për mijëra kilometra në formën e lumenjve të nënujshëm, nga një gjerësi gjeografike në tjetrën, quhen rryma oqeanike. Në varësi të gjerësisë gjeografike ku formohen dhe prej nga nisen, ato mund të jenë rryma të ngrohta dhe rryma të ftohta. Këto rryma lëvizin me një shpejtësi prej 4-5 km në orë dhe mund të përshkojnë deri në 100 km në ditë. Duke qenë se formohen në një gjerësi gjeografike dhe depërtojnë në gjerësi të tjera gjeografike, veçoritë e rrymave (kripësia, dendësia dhe temperatura) ndryshojnë nga ato të ujërave përreth tyre.</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurat 32 dhe 33 dhe ndërkohë mësuesi/ja trajton së bashku me nxënësit formimin e rrymave oqeanike të lidhura ngushtë me faktorët që ndikojnë mbi to (në formim dhe në shmangie)</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## ■ Punë praktike 2.4

- **Tema: Skicimi në hartë i rrugës që ndjekin disa nga rrymat oqeanike dhe evidentimi i rolit të tyre mbi klimën e rajoneve që përshkojnë**

### *Rezultatet e të nxënit*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- skicon në hartën skicë rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike;
- qarkon/shënon në hartën skicë shmangien e drejtimit të lëvizjes së disa prej rrymave
- oqeanike dhe evidenton se cili është shkaku i shmangies së tyre;
- përshkruan rolin e rrymave oqeanike në klimën e rajoneve që përshkojnë;
- ndan me të tjerët përfundimet e arritura nga vëzhgimet individuale.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:

45 minuta; në klasë.

***Materialet burimore:***

Harta e rrymave oqeanike, teksti mësimor i Gjeografisë 7, enciklopedi, atlasit gjeografik, informacionet e grumbulluara më parë nga interneti mbi këto rryma.

***Mjetet e punës:***

Harta skicë e rrymave oqeanike në tekst, laps/stilolaps, lapsa me ngjyra/lapustila.

***Metodologjia që do të përdoret:***

Punë individuale; diskutim në grupe.

***Puna përgatitore***

Për realizimin e kësaj pune praktike, mbështetuni në informacionet e grumbulluara më parë nga interneti mbi rrymat oqeanike, në dijet e përvetësuara nga teksti mësimor, si dhe në hartën skicë të këtyre rrymave.

***Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:***

- përcaktoni koordinatat gjeografike sipas paraleleve dhe meridianëve të paraqitur në hartë.
- skiconi në hartën skicë, rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike;
- qarkoni/shënoni në hartën skicë drejtimin e shmangies që pësojnë rrymat oqeanike nga drejtimi fillestar i tyre;
- përcaktoni veçoritë e rrymave oqeanike dhe faktorët që ndikojnë në formimin e shmangien e tyre;
- evidentoni rolin që luajnë rrymat oqeanike në klimën e rajoneve që përshkojnë.

## Tema mësimore: II.15

### Lumenjtë dhe elementet përbërëse të tyre

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.15 Lumenjtë dhe elementet përbërëse të tyre</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin mbi lumenjtë, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm llojet e lumenjve, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul> </li> </ol>			

<b>Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi/ja dallon veçoritë e llojeve të ndryshme të lumenjve;</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi/ja vlerëson elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi/ja identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshme, elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënimit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm, elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> lumenjtë fushorë, lumenjtë malorë, elementet përbërëse të lumit.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Lumenjtë rrjedhin drejt grykëderdhjes;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.15 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të diskutojnë së bashku përmbajtjen e rubrikës “diskutojmë”.”Dikush mund të banojë pranë një lumi, një tjetër e ka parë gjatë udhëtimeve, në emisione televizive apo filma; dikush mund të ketë pushuar pranë tij; një tjetër mund të ketë parë se nga buron apo ku derdhet një lumë. Gjithashtu, në harta kemi parë shtrirjen e lumenjve të ndryshëm. Bazuar në këto njohuri dhe me ndihmën e hartës fizike, përshkruajmë së bashku se çfarë është lumi dhe nga se përbëhet ai.” Nxënësit të diskutojnë me njëri-tjetrin.</p>



<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Ujërat sipërfaqësore që kanë rrjedhje të vazhdueshme nëpër një shtrat të krijuar prej tyre, quhen lumenj. Lumenjtë në botë janë të shumtë dhe kanë veçori të ndryshme nga njëri-tjetri. Këto veçori varen nga llojet e klimës e të relievit, nga përshkueshmëria e shtresave të tokës, nga prania ose jo e bimësisë, si dhe nga veprimtaria njerëzore. Sipas relievit nëpër të cilin kalojnë, lumenjtë janë: fushorë dhe malorë. Lumenjtë fushorë, për shkak të pjerrësisë shumë të vogël ose mungesës së pjerrësisë së relievit, kanë shpejtësi të vogël rrjedhëse, shtrat të gjerë dhe formojnë gjarpërime përgjatë rrugës së tyre. Lumenjtë malorë, për shkak të pjerrësisë së luginës që përshkojnë, kanë shpejtësi dhe forcë gërryese të madhe përgjatë rrjedhës së tyre. Si rrjedhojë, ata dallohen për shtretër të ngushtë e të thellë (deri në kanione), me pragje e ujëvara.</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 34 dhe të përshkruajnë veçoritë e secilit prej lumenjve të paraqitur.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Lumi përbëhet nga një rrjet degësh ujore, ku secila prej tyre ndahet në degë më të vogla. Ky rrjet i gjerë degësh quhet sistem ujëmbledhës. Vendi ku fillon rrjedha e lumit quhet burim (i përhershëm), ndërsa pjesa ku derdhet, quhet grykëderdhje. Lumi mund të derdhet në një tjetër lumë, në liqen, në det ose oqean. Sipërfaqja ku ujërat rrjedhëse bashkohen në një lumë kryesor, quhet pellg ujëmbledhës. Pellgjet ujëmbledhëse ndahen prej njëri-tjetrit nga pjesë të ngritura, të quajtura vija ujëndarëse. Përgjatë rrjedhës së tij, nga burimi në grykëderdhje, lumi gërryen, transporton dhe depoziton materiale, duke modeluar kështu shtratin e tij. Lartësia e ujit nga baza e shtratit deri në sipërfaqe quhet nivel. Niveli i lumit ndryshon në varësi të sasisë së reshjeve, shkrirjes së borës dhe të ndryshimit të temperaturave.</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 35 dhe të përshkruajnë elementet e lumit të paraqitur</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 5.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit/es</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## Tema mësimore: II.16

### Veprimtaria lumore

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.16 Veprimtaria lumore</b>	

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

##### 1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)

- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi veprimtarinë lumore në relief, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, llojet e veprimtarisë lumore në relief, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

##### 2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)

- Interpreton, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm format e krijuara prej veprimtarisë lumore në relief, duke e ilustruar me shembuj konkretë.

##### 3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)

- Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.

##### 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.

##### 5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

##### 6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.

##### 7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja dallon veçoritë e luginës prej veprimtarisë lumore;</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja vlerëson veprimtarinë lumore në reliev.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshme, identifikon format e krijuara në reliev prej veprimtarisë lumore.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshme, identifikon format e krijuara në reliev prej veprimtarisë lumore.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> erozion, transportim, depozitim, sedimente, deltë lumore</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë:</p> <p>Lumenjtë e modelojnë relievin ku kalojnë;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.16 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja përdor situatën (rubrikën “diskutojmë”) e vendosur në fillim të mësimit 2.16: Përgjatë rrugës që përshkon, lumi krijon relievin e tij. Përshkruajmë së bashku veçoritë e këtij relievi. A e dini si krijohen format karakteristike të relievit lumor?</p> <p>Nxënësit/et të diskutojnë me njëri-tjetrin.</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Gjatë rrjedhjes së tyre, lumenjtë modelojnë shtratin nëpër të cilin kalojnë, përmes erozionit (gërryerjes), transportimit dhe depozitimit të materialeve të ngurta.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 36 dhe bazuar në të, të përcaktojnë elementet përbërëse të lumit dhe të përshkruajnë format e luginave që formohen në pjesë të ndryshme të tij..</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Forca gërryese e lumit varet nga shpejtësia me të cilën rrjedh, nga vëllimi i ujit dhe i materialeve të ngurta që merr me vete, si dhe nga fortësia e shkëmbinjve të shtratit të tij. Përgjatë rrugës që përshkon, lumi gërryen në thellësi dhe në pjesën anësore të shtratit të tij. Kur procesi i gërryerjes ndodh më tepër në thellësi, quhet erozion vertikal. Për shkak të këtij erozioni, luginat mund të marrin formën e germës V ose të kanioneve, si dhe mund të thellohen vazhdimisht duke formuar disa nivele tarracash lumore (fig. 36 dhe 37 a/b) dhe pragje. Kur procesi i gërryerjes së lumit ndodh në pjesët anësore të shtratit të tij, duke e zgjeruar atë, quhet erozion anësor. Si rezultat i këtij erozioni, luginat mund të marrin formën e germës U, ose mund të jenë me fund të sheshtë.</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 37 dhe të përshkruajnë llojet e tarracave lumore.</p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Bashkë me ujin, lumi merr me vete edhe materialet e ngurta që gërryen nga shtrati. Këto materiale, që mund të jenë të madhësisë të ndryshme, quhen sedimente. Në varësi të madhësisë së sedimenteve ndryshon dhe distanca e transportimit të tyre. Sedimentet më të imëta e më të lehta qëndrojnë në sipërfaqen e ujit dhe shkojnë më larg, deri në grykëderdhje. Sedimentet më të rënda depozitohen më afër pjesës ku ndodh gërryerja. Në zonat e sheshta, ku pjerrësia e lumit është më e vogël, lumenjtë mund të gjarpërojnë (meandrojnë) si në figurën 36, pjesa 3. Duke iu afruar grykëderdhjes, lumi e ngadalëson shpejtësinë e tij dhe depoziton aty të gjitha materialet që ka marrë me vete, duke formuar delta lumore të formave të ndryshme (fig. 38).</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 38 dhe të përshkruajnë llojet e deltave lumore.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 5.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## ■ Punë praktike 2.5

### ▪ Tema: Elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve

#### *Rezultatet e të nxënit*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- identifikon në hartën skicë të botës, drejtimet kryesore të shtrirjes së lumenjve më të mëdhenj në botë.
- hulumton dhe grumbullon informacione mbi veçoritë e këtyre lumenjve;
- përshkruan disa prej veçorive që kanë këta lumenj;
- ndan me të tjerët përfundimet e arritura nga vëzhgimet individuale;
- tregon frymë bashkëpunimi në grup;

#### *Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:*

45 minuta; në klasë.

#### *Materialet burimore:*

Harta fiziko-gjeografike e botës, teksti mësimor i Gjeografisë 7, atlas, materiale të grumbulluara nga interneti mbi lumenjtë më të mëdhenj të botës.

#### *Mjetet e punës:*

Harta skicë e lumenjve të Shqipërisë, laps/stilolaps, lapsa me ngjyra/lapustila, fletore/fletë formati

A-4, materiale të grumbulluara nga interneti mbi lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë.

#### *Metodologjia që do të përdoret:*

Punë në grupe.

#### *Puna përgatitore*

Për realizimin e kësaj pune praktike mbështetuni në njohuritë e marra nga teksti mësimor mbi: elementet përbërëse të lumenjve, llojet e lumenjve dhe veprimtarinë e tyre në relief. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et që më parë të hulumtojnë dhe të grumbullojnë informacione mbi veçoritë e lumenjve më të mëdhenj në Shqipëri.

**Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike**

- Veçoni/përzgjidhni në hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë (të ekspozuar në klasë) disa prej lumenjve të vendit tonë, për t'i vëzhguar gjatë punës praktike.
- Gjejini dhe emërtojini ata në hartën skicë të tekstit.
- Identifikoni përmes hartës se çfarë lloj lumenjsh janë dhe drejtimet që ndjekin.
- Identifikoni, bazuar në vëzhgimet në hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë, elementet përbërëse të lumenjve që përzgjedhët dhe vendosini emërtimin përkatës secilit prej tyre në hartën skicë të tekstit. Plotësoni degë të lumit që nuk janë paraqitur në hartën skicë.
- Bazuar në vëzhgimet mbi hartën fiziko-gjeografike, përshkruani shkurtimisht në fletore/ fletë formati A-4, veçoritë që kanë këta lumenj (sipas llojit që i përkasin);
- Përshkruani se në cilën pjesë të lumit mbizotërojnë: erozioni, transportimi dhe depozitimi.
- Ndërtoni një maket (me plastelinë, dru, guralecë etj.), që paraqet elementet e një lumi;
- Diskutoni me njëri-tjetrin mbi përfundimet e arritura nga vëzhgimet dhe punët individuale.

**■ Punë praktike 2.6**

- **Tema: Përcaktimi i drejtimeve të rrjedhave të disa lumenjve kryesorë në hartën e botës**

***Mjetet e punës:***

Harta fiziko-gjeografike e botës, laps/stilolaps, lapsa me ngjyra/lapustila, fletore/fletë formati A-4.

***Metodologjia që do të përdoret:***

Punë në grupe.

***Puna përgatitore***

Për realizimin e kësaj pune praktike, mbështetuni në dijet e marra nga teksti mësimor mbi llojet e lumenjve. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et si të hulumtojnë dhe grumbullojnë informacione mbi veçoritë e lumenjve më të mëdhenj në botë.

**Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:**

- Veçoni/përzgjidhni në hartën fiziko-gjeografike të botës lumenjtë më të mëdhenj, për t'i vëzhguar gjatë punës praktike.
- Emërtojini ata në hartën skicë të botës.
- Emërtoni oqeanet dhe detet ku këta lumenj derdhen.

- Identifikoni në hartën skicë të botës, drejtimet kryesore të shtrirjes së lumenjve që për zgjodhët (në cilat zona burojnë dhe ku derdhen). Vëzhgoni me kujdes në hartën fiziko-gjeografike të botës, gjerësitë gjeografike dhe tiparet e relievit në zonat ku burojnë, kalojnë dhe derdhen lumenjtë. Analizoni nëse këta faktorë ndikojnë në madhësinë e tyre.
- Krahasoni format e grykëderdhjeve.
- Hulumtoni dhe grumbulloni informacione mbi lumenjtë dhe përshkruani veçoritë kryesore të tyre;
- Ndani me njëri-tjetrin përfundimet e arritura nga vëzhgimet individuale.

## Tema mësimore: II.17

### Liqenet dhe llojet e tyre

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.17 Liqenet dhe llojet e tyre</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi veçoritë e e liqeneve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, se cilat janë llojet e liqeneve sipas origjinës së formimit, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul>			
<p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Interpreton, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshëm llojet e liqeneve, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul>			
<p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.</li> </ul>			
<p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul>			

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës****1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja dallon veçoritë e secilës prej liqeneve;

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja vlerëson rëndësinë e liqeneve.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja krahason liqenet me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vendndodhjen e tyre në hartë.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja krahason liqenet me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vendndodhjen e tyre në hartë.

**Fjalët kyçe:** liqene natyrore (tektonike, vullkanike, akullnajore, karstike, bregdetare), liqene artificiale

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:

Shqipëria ka disa liqene tektonike, bregdetarë, akullnajorë...;

Rëndësinë e liqeneve;

**b. Ndërtimi i njohurive të reja****Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.17 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

**Veprimet në situatë****Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja, bazuar në rubrikën “diskutojmë” fton nxënësit/et të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: “Vendi ynë ka dalje të gjerë në det, si dhe liqene mjaft të thella, me sipërfaqe të mëdha.



<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Kështu, kushdo prej nesh mund të pushojë në bregdet apo pranë një liqeni. Ashtu si detet, edhe liqenet e zbutin klimën dhe na ofrojnë peshk shumë të mirë. Kur jemi pranë një liqeni, natyrshëm mund të na lindë pyetja: si është formuar ai?”</p> <p>Nxënësit/et të diskutojnë me njëri-tjetrin.</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Liqenet janë gropa të mëdha e të mbyllura, të mbushura me ujë prej një kohe të gjatë (fig. 39/a). Ato mund të furnizohen prej: reshjeve, ujërave rrjedhëse, burimeve nëntokësore, ujërave të përfutuara nga shkiritja e borës dhe akujve etj. Liqenet mund të jenë me rrjedhje, kur prej tyre buron ndonjë lumë apo përrua, ose pa rrjedhje, kur nuk ka asnjë të tillë. Kur sasia e ujit që hyn në liqen është më e vogël se ajo që del prej tij, liqeni mund të kthehet në një kënetë (fig. 39/b).</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 39 dhe bazuar në të, të përshkruajnë mënyrën e formimit të një liqeni...</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit/et të njohin informacionin e tekstit mbi llojet e liqeneve dhe së bashku me ta trajton llojet e liqeneve: Liqenet ndryshojnë nga njëri-tjetri në bazë të mënyrës së formimit të tyre. Për këtë arsye, ato ndahen në liqene natyrore dhe liqene artificiale. Sipas origjinës së formimit, liqenet natyrore janë: tektonike, vullkanike, akullnajore, karstike dhe bregdetare...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## ■ Punë praktike 2.7

### ▪ Tema: Liqenet në Shqipëri

#### *Rezultatet e të nxënësve*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- identifikon në hartë liqenet e Shqipërisë dhe i klasifikon ato sipas origjinës së formimit;
- përshkruan veçoritë e secilit prej tyre (sipas llojit);
- evidenton rëndësinë e liqeneve;
- diskuton me të tjerët përfundimet e arritura nga vëzhgimet individuale.

#### *Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:*

45 minuta; në klasë.

*Materialet burimore:* Harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë, teksti mësimor i Gjeografisë 7, informacione mbi liqenet e vendit tonë, të grumbulluara nga interneti.

#### *Mjetet e punës:*

Harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë, laps/stilolaps, fletore/fletë formati A-4.

#### *Metodologjia që do të përdoret:*

Punë në grupe.

#### *Puna përgatitore*

Për realizimin e kësaj pune praktike mbështetuni në njohuritë e përfutuara nga teksti mësimor mbi liqenet. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et si të hulumtojnë dhe grumbullojnë informacione mbi llojet e liqeneve, veçoritë e tyre dhe rëndësinë që kanë.

#### *Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:*

- Gjenero liqenet në hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë (të ekspozuar në klasë).
- Qarkojini dhe ngjyrosini ato në hartën skicë të Shqipërisë.
- Klasifikojini liqenet sipas origjinës së formimit (vendosi në tabelën e mëposhtme).
- Bazuar në informacionet e grumbulluara nga interneti mbi llojet e liqeneve dhe nga vëzhgimet në hartën fiziko-gjeografike të Shqipërisë, përshkruani shkurtimisht veçoritë e tyre (në tabelën e mëposhtme).
- Ndani me njëri-tjetrin përfundimet e arritura nga vëzhgimet dhe punët individuale.

## Tema mësimore: II.18

### Burimet dhe përdorimet e tyre

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.18 Burimet dhe përdorimet e tyre</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi llojin dhe përdorimin e burimeve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, se cilat janë llojet e burimeve, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskuton për llojin dhe përdorimin e burimeve, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga teksti shkollor, për të plotësuar detyrat e dhëna në grup.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul> </li> </ol>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja dallon veçoritë e burimeve;

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja vlerëson përdorimin e burimeve.

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.

**Fjalët kyçe:** burime të flohta, burime të ngrohta

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:  
Shqipëria ka shumë burime ujore...;

**b. Ndërtimi i njohurive të reja**

#### **Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.18 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

#### **Veprimet në situatë**

##### **Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja, bazuar në rubrikën “Diskutojmë”, fton nxënësit/et të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: “Përshkruajmë figurën e paraqitur. Bazuar në idenë që përcjell ajo dhe në informacionet që kemi, evidentojmë së bashku disa prej burimeve ujore që ndodhen në Shqipëri ose pranë vendbanimit tonë. A e dini se ç’lloj burimesh janë? Si janë formuar?”

Nxënësit/et të diskutojnë me njëri-tjetrin.

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Ujërat nëntokësore që dalin në mënyrë natyrale mbi sipërfaqen e tokës, formojnë një <b>burim</b>. Këto ujëra mund të burojnë që nga një rrjedhë e vogël deri në sasi shumë të mëdha. Burimet ujore formohen përgjatë thyerjeve të shtresave shkëmbore, çarjeve karstike, ose përgjatë luginave lumore. Burimet ndryshojnë nga njëri-tjetri për nga temperatura, kripërat minerale dhe gazet e tretura në to. Burimet e mëdha janë kryesisht burime karstike. Nisur nga temperatura e ajrit në vendin ku dalin, ujërat e burimeve mund të jenë <b>të ftohta</b> (kur temperatura e tyre është më e ulët se temperatura e ajrit), dhe <b>të ngrohta</b> ose termale (kur temperatura e tyre është më e lartë se 200C). Disa burime përmbajnë ujëra minerale, në të cilat gjenden sasi të konsiderueshme kripërash minerale dhe gaze të tretura. Në vende të ndryshme të botës ka edhe burime me ujëra të nxehta, që quhen <i>gejzera</i>. Ujërat e këtyre burimeve dalin me force pranë zonave vullkanike, në intervale të caktuara kohore (si në figurën 45).</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 45 dhe bazuar në të, të përshkruajnë gejzerat dhe të krahasojnë ato me burimet ujore që gjenden në vendin tone.</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit/et të njohin informacionin e tekstit mbi rëndësinë e burimeve ujore dhe të diskutojnë rreth tyre. Ftohen të sjellin shembuj burimesh nga vendbanimi i tyre.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2 të rubrikës “Radha jote”. Lihen si detyrë shtëpie ushtrimet 3 dhe 4.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## ■ Punë Praktike 2.8

### ▪ Tema: Burimet pranë vendbanimit tim dhe rëndësia e tyre

#### *Rezultatet e të nxënës*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- vëzhgon në zonën ku banon për praninë e burimeve (nëse nuk ka të tilla, ai/ajo mund të kërkojë informacione mbi burime të ndryshme të vendit tonë);
- hulumton dhe grumbullon informacione mbi veçoritë e këtyre burimeve;
- përgatit dhe prezanton fletëpalosje ose albume, që evidentojnë veçoritë e këtyre burimeve dhe rëndësinë e përdorimit të tyre.
- ndan me të tjerët përfundimet e arritura nga vëzhgimet individuale.
- tregon frymë bashkëpunimi në grup.

#### *Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:*

45 minuta; në klasë.

#### *Materialet burimore:*

Harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë, teksti mësimor i Gjeografisë 7, materiale të grumbulluara nga interneti mbi burimet në vendin tonë dhe veçanërisht në zonën ku nxënësi/ja banon; materiale të siguruara nga pushteti vendor, informacione nga më të rriturit.

#### *Mjetet e punës:*

Harta fiziko-gjeografike e Shqipërisë, laps/stilolaps, lapsa me ngjyra/lapustila, fletë formati A-4, fletëpalosje, foto, laptop, videoprojektor, ujë të ambalazhuar.

#### *Metodologjia që do të përdoret:*

Punë në grupe.

#### *Puna përgatitore*

Për realizimin e kësaj pune praktike, mbështetuni në dijet e marra nga teksti mësimor mbi burimet. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et si të hulumtojnë dhe të grumbullojnë informacione mbi burimet në/pranë vendbanimeve të tyre (kërkesë e shtruar edhe te “Radha jote” në mësimin 2.18).

***Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:***

- Vëzhgoni në zonën ku banoni për praninë e burimeve (nëse nuk ka të tilla, mund të kërkonti informacione mbi burime të ndryshme të vendit tonë).
- Identifikojini ato në hartën e Shqipërisë.
- Hulumtoni dhe grumbulloni informacione mbi veçoritë e këtyre burimeve.
- Diskutoni për llojet e burimeve, veçoritë që kanë dhe përdorimin e tyre.
- Përgatitni dhe prezantoni fletëpalosje ose albume, që evidentojnë veçoritë e këtyre burimeve, rëndësinë e përdorimit si edhe vlerat e tyre. Këto mund t'i paraqitni edhe në formën e një përmbledhjeje nëpërmjet programit *PowerPoint*.
- Ndani me njëri-tjetrin përfundimet e arritura nga vëzhgimet individuale.

## **Tema mësimore: II.19**

### **Bora dhe akujt**

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.19 Bora dhe akujt</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët mbi formimin e borës dhe akujve, duke bërë pyetje, komente dhe sqarime.</li> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, formimin e borës dhe akujve, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.</li> </ul>			
<p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskuton për llojin dhe përdorimin e burimeve, duke e ilustruar me shembuj konkretë.</li> </ul>			
<p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor figura dhe makete të ndryshme për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve.</li> <li>• Përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis.</li> </ul>			
<p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e detyrave dhe të diskutimeve, në klasë.</li> </ul>			

<p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së diskutimit/detyrave të dhëna në grup.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b></p>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja dallon veprimin e borës dhe të akujve në mjedis;</p>	
<p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja përshkruan veprimin e borës dhe të akujve në mjedis.</p>	
<p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja përshkruan formimin e borës dhe akujve dhe veprimin e tyre në mjedis.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> borë e përhershme, kufiri i borës së përhershme, akullnajë</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Akullnajat formohen në pole; Në zonat malore formohet edhe borë të përhershme dhe akuj;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.19 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja, bazuar në rubrikën “Diskutojmë” fton nxënësit/et të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: “Gjatë stinës së dimrit, një pjesë e popullsisë që jeton në zonat malore të vendit tonë, përballet me vështirësi të mëdha qarkullimi, për shkak të reshjeve të mëdha të dëborës dhe ngricave. Në lartësi më të mëdha, disa maja malesh zbardhin nga bora e akujt edhe gjatë verës, pra në mënyrë të përhershme. A e dini pse ndodh kështu? Si formohen akujt dhe bora e përhershme?”</p>



<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Nxënësit/et të diskutojnë mes tyre.</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja vazhdon: Në majat e maleve dhe pranë poleve, temperaturat e ajrit janë shumë të ulëta dhe reshjet bien në formë bore. Kur këto reshje janë të mëdha dhe temperaturat shumë të ulëta, aq sa bora mbetet përgjatë gjatë gjithë vitit, formohet bora e përhershme. Lartësia mbi të cilën bora asnjëherë nuk arin të shkrijë, quhet kufiri i borës së përhershme. Kufiri i borës së përhershme ndryshon në varësi të sasisë së reshjeve që bien dhe të vlerave të temperaturave të ajrit. Kur temperaturat rriten dhe sasia e reshjeve zvogëlohet, kufiri i borës së përhershme ngrihet më sipër në lartësi, dhe anasjelltas.</p> <p>Ftohen nxënësit/et të shohin figurën 46 dhe bazuar në të, të përshkruajnë se si ndryshon lartësia e kufirit të borës së përhershme nga Ekuatori deri në pole, si dhe pse ndryshon.</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja vazhdon: Rënia e vazhdueshme e borës bën që shtresat e reja të saj të mbivendosen mbi borën e mëparshme. Për shkak të ngritjeve dhe uljeve të temperaturës, ajo shkrin dhe ngrin disa herë, duke u kthyer në kokrriza akulli. Kur trashësia e borës shkon rreth 20-30 m, pesha e saj ushtron një trysni më të madhe ndaj kokrrizave të borës së poshtme dhe e bën atë më të ngjeshur. Gjatë ngjeshjes, kokrrizat e shtresave të poshtme të akullit shkrijnë dhe kur temperatura bie përsëri, ringurtësohen, por në përmasa më të mëdha, të cilat përbëjnë masën e akullnajës. Në rast se relievi është i pjerrët dhe pjesa fundore e akullit bëhet e rrëshqitshme, akulli i krijuar fillon të lëvizë dhe formon një akullnajë. Nëse relievi nuk ka pjerrësi, akullnaja shpërndahet në të gjitha drejtimet. Gjatë lëvizjes së tyre, akullnajat gërryejnë, transportojnë dhe depozitojnë në relievi. Shpejtësia e kësaj lëvizjeje ndryshon në varësi të pjerrësisë së shpatit, trashësisë së akullit dhe temperaturave të ajrit. Veprimtaria gërryese e akullnajave formon cirqet akullnajore dhe luginat akullnajore, ndërsa veprimtaria depozituese formon morenat (që mund të jenë anësore, të sipërme, të bazës dhe frontale, si në figurën 47).</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë pjesët e akullnajës të paraqitura në figurën 47.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 6.</p>
---	---

<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.

## Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë

- **Përsëritje III**
- **Tema Hidrosfera**
- **Përsëritja III - Hidrosfera )**

### 1. E vërtetë apo e gabuar?

- Rreth 97% e hidrosferës përbëhet nga ujë i ëmbël. **V G**
- Lumenjtë mund të derdhen vetëm në dete ose oqeanë. **V G**
- Mbushja me ujë e gropave karstike formon një liqen akullnajor. **V G**
- Vala është një nga lëvizjet e nënujshme të ujërave oqeanike ose detare. **V G**
- Lartësia mbi të cilën bora asnjëherë nuk arrin të shkrijë, quhet kufiri i borës së përhershme. **V G**
- Masa të mëdha ujore që lëvizin për mijëra kilometra në formën e lumenjve sipërfaqësorë, quhen rryma oqeanike. **V G**

2. Në figurën 1, **plotëso** me numrat përkatës rrathët e shigjetave që tregojnë qarkullimin e ujit në natyrë dhe **përshkruaj** se si ndodh ai.

3. Bazuar në figurën 2, **përshkruaj** se si ndryshon temperatura mesatare e ujërave oqeanike/ detare sipas gjerësive gjeografike (nga Ekuatori në pole) dhe **përcakto** shkaqet që ndikojnë në ndryshimin e saj.

4. Bazuar në figurën 3, **përshkruaj** se si ndryshon kripësia mesatare e ujërave oqeanike/ detare sipas gjerësive gjeografike (nga Ekuatori në pole) dhe **përcakto** shkaqet që ndikojnë në ndryshimin e saj.

**5. Vendos** në figurën 4, elementet përbërëse të lumit dhe **evidento** se çfarë veprimtarie kryen ai që prej burimittë tij e deri ku derdhet.

**6.** Bazuar në figurën 5: a) **përcakto** pjesët përbërëse të akullnajës; b) **përshkruaj** veprimtarinë e akullnajës gjatë rrugës që ajo përshkon.

**7. Diskuto** mbi pyetjet e mëposhtme.

- a. Pse qarkullon uji në natyrë?
- b. Çfarë veçorish kanë ujërat e oqeaneve/deteve?
- c. Pse formohen valët?
- d. Ç'janë baticat dhe zbaticat dhe pse formohen ato?
- e. Ç'janë rrymat oqeanike dhe si formohen ato? Pse e ndryshojnë drejtimin gjatë rrugëtimit të tyre?
- f. Si ndahen liqenet sipas origjinës?
- g. Çfarë janë burimet dhe sa lloje janë ato?
- h. Si formohet akullnaja?

**Lidh me shigjetë alternativat e duhura.**

- |   |   |
|---|---|
| a. formohet nga uji i përftuar prej shkrirjes së akujve në një gropë akullnajore. | <b>1.</b> Bora e përhershme                 |
| b. është e errët dhe e ftohtë, sepse aty nuk mbërrin rrezatimi diellor.           | <b>2.</b> Burimi i ftohtë                   |
| c. formohet kur bora e sezonit bie mbi borën e pashkrirë të sezonit të kaluar.    | <b>3.</b> Liqeni akullnajor                 |
| d. formohet kur temperatura e tij është më e ulët se temperatura e ajrit.         | <b>4.</b> Shtresa ujore e fundit të oqeanit |

## ■Projekt (ora e dytë)

- **Tema: Çështjet mjedisore të ujërave pranë vendbanimit tim**

**Rezultatet e të nxënit**

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të kenë: lumi,

liqeni, hapësira bregdetare, burimet ujore pranë vendbanimit të tij;

- hulumton mbi një çështje mjedisore që lidhet me ujërat në zonën e tij dhe identifikon problemin;
- përcakton faktorët e mundshëm që shkaktojnë problematikën mjedisore;
- ofron zgjidhjen e problemit;
- vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- ndan me grupin idetë dhe përfundimet individuale;
- u bën thirrje moshatarëve dhe komunitetit për të qenë aktivë në zgjidhjet e problemeve të tilla.

### **Burimet kryesore të informacionit:**

Teksti mësimor i Gjeografisë 7, materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara më parë për realizimin e projektit; vëzhgime të nxënësve/eve në terren, biseda me më të rriturit e familjes dhe komunitetin përkatës; të dhëna dhe analiza të marra pranë pushtetit lokal; informacione të siguruar nga interneti, institucione apo organizata mjedisore, si dhe nga media e shtypi.

### **Metodologjia që do të përdoret:**

Punë në grupe, hulumtim, intervista, anketim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

### **Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:**

Teksti mësimor, materiale të printuara, informacione nga shtypi i shkruar; kompjuter, vid-eoprojektor, tabelë prezantimi, shenjues, fletëpalosje, postera, foto të ndryshme, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit/et etj.

### **Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së dytë të projektit:**


- Nxënësit/et raportojnë punën e bërë deri në këtë fazë të projektit.
- Evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre.
- Nxënësit/et përshkruajnë shkallën e përdorimit të burimeve të informacionit, rrugët e sigurimit dhe vlefshmërinë e tyre.
- Raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës/e të grupeve të tjera mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme.

**Shënim:** Për udhëzimet e realizimit të projektit referoju rubrikës përkatëse, të paraqitur në orën e parë të tij.

## Tema mësimore: II.20

### Ndërtimi i brendshëm i Tokës

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.20 Ndërtimi i brendshëm i Tokës	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim veçoritë kryesore për secilën shtresë të Tokës.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron dhe shpjegon për moshatarët e tij, ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake (topin me rritjen gjeografike).</li> </ul> <p>Modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.</p> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja përshkruan veçoritë kryesore për secilën shtresë të Tokës.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi ndërtimin e brendshëm të Tokës.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.</p>			

Rezultatet e të nxënit të temës mësimore: Nxënësi/ja modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.	<b>Fjalët kyçe:</b> korja (kontinentale, oqeanike) manteli, bërthama, litosfera, astenosfera
<b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.
Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve	
<b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b>	Nxënësit/et dinë: Toka është një trup i ngurtë, i përbërë nga shtresa; Brendësia e Tokës nuk mund të shihet me sy të lirë;
<b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.20 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.20 (në tekst) – “Diskutojmë: Dimë që Toka jonë, si pjesë e grupit të planetëve të brendshëm, është një trup shkëmbor që përbëhet prej elementeve të rënda (alumin, silic, nikel, hekur, krom etj). Në sipërfaqe, ne e shohim atë si një trup të ngurtë. Sipas informacioneve dhe përfytyrimeve tuaja, a mendoni se është ajo njësoj e gurtë deri në qendrën e saj?”</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mes tyre.</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Duke marrë si shembull figurën 48, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e ri: Njohuritë tona mbi strukturën e brendshme të Tokës bazohen kryesisht në të dhëna jo të drejtpërdrejta, sepse njeriu, deri më sot ka arritur të gërmojë jo më shumë se 12-15 km në thellësi të saj.</p>  <p>The diagram illustrates the Earth's internal layers: the crust, mantle, and core. It shows seismic waves (P-waves and S-waves) traveling from the surface into the interior. Three recording stations are shown on the right, each with a seismogram recording the waves. The diagram demonstrates how seismic waves provide indirect information about the Earth's internal structure.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Për ta njohur Tokën deri në brendësi të saj, na vijnë në ndihmë valët sizmike, të cilat në momentet kur ndodhin tërmetet, shpërndahen në drejtime dhe mënyra të ndryshme, në varësi të përbërjes së lëndës ku kalojnë (fig. 48)... Bazuar në këtë figurë, mësuesja u tregon nxënësve/eve ndryshimet që pësojnë valët (se si përthihen valët-me kënde të ndryshme dhe ka zona ku nuk kalojnë) në shtresa të ndryshme të Tokës.</p> <p>Në vazhdim trajton ndërtimin shtresor të Tokës: Shtresa e parë, në të cilën ndodhet edhe bota e gjallë, është korja e Tokës. Ajo përbën vetëm 2% të vëllimit të përgjithshëm të këtij planeti dhe është e formuar nga shkëmbinj me përbërje të ndryshme, ku mbizotërojnë elemente të tilla si, silici dhe alumini. Kjo shtresë gjendet në formën e kores kontinentale dhe kores oqeanike. Trashësia e kores kontinentale ndryshon nga 30 km deri në 70 km, ndërsa ajo e kores oqeanike shkon 5 deri në 8 km...</p> <p>Fton nxënësit/et që, bazuar në figurën 49, të dallojnë dhe përshkruajnë shtresat e Tokës nga sipërfaqja në brendësi.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihet detyrë klase ushtrimi 1 i rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 2</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit/es</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## Tema mësimore: II.21

### Llojet e shkëmbinjve dhe shkëmbinjtë sedimentarë

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.21 Llojet e shkëmbinjve dhe shkëmbinjtë sedimentarë</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim llojet e shkëmbinjve sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron dhe shpjegon për moshatarët e tij, klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë, duke përshkruar veçoritë kryesore të shkëmbinjve sedimentarë.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë. Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul> </li> </ol>			



<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b>	
Nxënësi/ja përshkuan llojet e shkëmbinjve sedimentarë.	
<b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b>	
Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë.	
<b>3. Marrja e vendimeve</b>	
Nxënësi/ja klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë. Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë.	
<b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë dhe vullkanikë. Klasifikon shkëmbinjtë sedimentarë.	<b>Fjalët kyçe:</b> shkëmbinjtë (sedimentarë, magmatikë, metamorfikë) sedimentarë copëzorë, sedimentarë kimikë, sedimentarë organogjenë
<b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi	<b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.
Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve/eve	
<b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b>	Nxënësit/et dinë: Toka është një trup i ngurtë, i përbërë nga shkëmbinj të shumtë e të ndryshëm; Jo të gjithë shkëmbinjtë mund të shihet me sy të lirë;
<b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.21 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.21 (në tekst) – “Diskutojmë: Mësuam që çdo shtresë e Tokës është e përbërë nga shkëmbinj të ndryshëm. Në sipërfaqen e saj arrijmë të shohim vetëm disa prej tyre (kryesisht në zonat ku vepron erozioni, mungon bimësia apo ka çarje të relievit), pasi pjesa më e madhe e shkëmbinjve është e mbuluar nga dherat, bimësia, ujërat apo ndërtimet. Figurat e mëposhtme paraqesin dy mjedise shkëmbore. Përshkruajmë përmbajtjen e secilit prej tyre dhe sjellim shembuj të ngjashëm nga mjedise shkëmbore që njohim apo shohim rreth nesh. Si janë ndërtuar ato?”</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mes tyre.</p>

**b. Ndërtimi i njohurive të reja**

**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**

Duke orientuar nxënësit/et të bazohen në figurën 50, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e ri: Shkëmbinjtë janë trupa të ngurtë, të përbërë nga një ose më shumë minerale. Ata janë krijuar si rezultat i proceseve të formimit dhe zhvillimit të kores së Tokës (oqeanike dhe kontinentale), por edhe të shtresave më në thellësi. Shkëmbinjtë më të vjetër në sipërfaqen e Tokës (prej rreth 4 miliardë vjetësh) janë gjetur në Australi dhe në Groenlandë, ndërsa në Shqipëri, më të vjetrit datojnë 450–500 milionë vite më parë. Në botë njihen rreth 1000 lloje shkëmbinjsh, të cilët sipas mënyrës së formimit ndahen në tri grupe të mëdha: sedimentarë, metamorfikë dhe magmatikë (fig. 50).


Fton nxënësit/et të përshkruajnë figurën 50.

Në vazhdim mësuesi/ja trajton shkëmbinjtë sedimentarë: Shkëmbinjtë sedimentarë formohen nga grumbullimi dhe ngjeshja e sedimenteve të ndryshme. Sedimentet janë grumbullime me origjinë organike (prej mbetjeve bimore ose shtazore), ose inorganike (prej copëzave të shkëputura nga shkëmbinj të ndryshëm të kores tokësore). Shkëmbinjtë sedimentarë formohen në pjesën më sipërfaqësore të kores tokësore (si në atë kontinentale, ashtu edhe në koren oqeanike). Madhësia e copëzave që grumbullohen, varet nga fortësia e shkëmbinjve që copëtohen dhe nga distancat që përshkojnë ato gjatë transportit nga njëri vend në tjetrin.

Fton nxënësit/et që, bazuar në figurën 51, të dallojnë mënyrën dhe vendin e formimit të shkëmbinjve sedimentarë në Tokë.

Nxënësit/et diskutojnë mes tyre.

Në vazhdim mësuesi/ja trajton llojet e shkëmbinjve sedimentarë: Shkëmbinjtë sedimentarë ndahen në: sedimentarë copëzorë, sedimentarë kimikë, sedimentarë organogjenë.



<p>• Shkëmbinjtë sedimentarë copëzorë formohen nga grumbullimi dhe ngjeshja e copëzave me madhësi të ndryshme, të shkëputura prej shkëmbinjve të tjerë. Në varësi të përmasave të këtyre copëzave, këta shkëmbinj gjenden në formën e konglomeratit, zallishtes, rërës, argjilës etj....</p> <p>Fton nxënësit/et që, bazuar në figurën 52 a/b/c, të përshkruajnë veçoritë e shkëmbinjve sedimentarë.</p>	
<p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 4.</p>	
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit/et</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të punës në grup.</p>

## Tema mësimore: II.22 Shkëmbinjtë magmatikë

<p><b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b></p>	<p><b>LËNDA: GJEOGRAFI</b></p>	<p><b>SHKALLA: III</b></p>	<p><b>KLASA: VII</b></p>
<p><b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b></p>		<p><b>Tema mësimore: II.22 Shkëmbinjtë magmatikë</b></p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim llojet e shkëmbinjve magmatikë.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demonstron dhe shpjegon për moshatarët e tij mënyrën e formimit të shkëmbinjve magmatikë, duke përshkruar veçoritë kryesore të tyre.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Klasifikon shkëmbinjtë magmatikë.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul>			

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës****1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja përshkuan llojet e shkëmbinjve magmatikë.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi shkëmbinjtë magmatikë.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja klasifikon shkëmbinjtë magmatikë.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja klasifikon shkëmbinjtë magmatikë.

**Fjalët kyçe:** magmë, llavë, magmatikë intruzivë, magmatikë efuzivë, ultrabazikë, bazikë, mesatarë, acidë.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi.

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:

Toka është e përbërë nga shkëmbinj të shumtë e të ndryshëm;

**b. Ndërtimi i njohurive të reja****Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.22 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

**Veprimet në situatë****Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.22 (në tekst) – “Diskutojmë: Risjellim në vëmendje se çfarë ndodh në mantelin e Tokës, ku mendohet që ka vatrën pjesa më e madhe e vullkaneve. Bazuar në njohuritë që keni mbi vullkanet, si mendoni, nga shpërthimi dhe ftohja e tyre, a ndodhin ndryshime në sipërfaqen e Tokës?”

Nxënësit/et diskutojnë mes tyre.

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	
	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Duke orientuar nxënësit/et të bazohen në figurën 50, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e ri: Për të njohur shkëmbinjtë magmatikë, duhet të kuptojmë fillimisht se ç’është magma. <b>Magma</b> është një përbërje e shkrirë, e formuar kryesisht në mantelin e Tokës, e cila përmban minerale të ndryshme dhe gaze të tretura. Ajo formohet si rezultat i temperaturave dhe trysnisë së lartë që ushtrohet mbi shkëmbinjtë që ndodhen në pjesën e poshtme të kores dhe mbi ata të mantelit. Për shkak të gjendjes së saj të shkrirë dhe të dendësisë më të vogël se shkëmbinjtë e ngurtë të litosferës, magma ngjitet në pjesët e sipërme të shtresave tokësore. Kur arrin të dalë në sipërfaqe dhe lëshon në atmosferë gazet e saj, magma quhet <b>llavë</b>.</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë formimin e shkëmbinjve magmatikë, bazuar në figurën 53.</p> <p>Në vazhdim mësuesja trajton llojet e shkëmbinjve magmatikë: Ftohja dhe më pas ngurtësimi i magmës çojnë në formimin e shkëmbinjve magmatikë (fig. 53). Nëse ngurtësimi i magmës ndodh në brendësi të Tokës, shkëmbinjtë e formuar quhen <b>magmatikë intruzivë</b> (të brendshëm), ndërsa kur ngurtësimi i saj ndodh në sipërfaqen e Tokës, shkëmbinjtë quhen <b>magmatikë efuzivë</b> (të jashtëm). Në bazë të përqindjes së sasisë së dioksidit të silicit që përmbajnë, shkëmbinjtë magmatikë ndahen në <b>shkëmbinj ultrabazikë, bazikë, mesatarë dhe acidë</b>. Shkëmbinjtë acidë janë më rezistentë se ata ultrabazikë.</p> <p>Fton nxënësit/et që, bazuar në figurën 54, të dallojnë mënyrën dhe vendin e formimit të shkëmbinjve magmatikë në Tokë.</p> <p>Nxënësit <b>diskutojnë mes tyre</b>.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihet detyrë klase ushtrimi 1 i rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 2.</p>

<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit/es</b>	Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## Tema mësimore: II.23 Shkëmbinjtë metamorfikë

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.23 Shkëmbinjtë metamorfikë	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim llojet e shkëmbinjve metamorfikë.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan mënyrën e formimit të shkëmbinjve metamorfikë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Klasifikon shkëmbinjtë metamorfikë.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			

<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi/ja përshkuan llojet e shkëmbinjve metamorfikë.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi shkëmbinj të metamorfikë.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi/ja klasifikon shkëmbinj të metamorfikë.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja klasifikon shkëmbinj të magmatikë.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> metamorfikë kontakti, metamorfikë rajonale</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Toka është e përbërë nga shkëmbinj të shumtë e të ndryshëm;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.23 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.23 (në tekst) – “Diskutojmë: Mermeri është një material që përdoret shpesh për ndërtimin apo zbukurimin e objekteve të ndryshme, p.sh.: statuja, shkallë bane-sash, parmakë dritaresh, fasada ndërtesash etj. Në të gjitha këto raste është përdorur mermeri i përpunuar (pllaka ose copa të mëdha mermeri). Si mendoni, në ç’forma dhe madhësi gjendet ai në natyrë?”</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mes tyre.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Duke orientuar nxënësit/et të bazohen në figurën 56, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e ri: Shkëmbinjtë metamorfikë formohen si rezultat i transformimit (metamorfozës) që pësojnë shkëmbinjtë sedimentarë dhe magmatikë për shkak të temperaturës dhe trysnisë së lartë në sipërfaqen e Tokës. Shkëmbinjtë metamorfikë në planetin tonë zënë një hapësirë të konsiderueshme dhe gjenden kryesisht në thellësitë 5 km. Në Shqipëri, përhapja e tyre është më e kufizuar. Ndër ta dallohen shkëmbinjtë mermerë, që gjenden kryesisht në Peshkopi e Shkodër, si dhe kuarцитet në Tropojë. Procesi i transformimit të shkëmbinjve magmatikë apo sedimentarë në metamorfikë ndodh pranë zonave vullkanike dhe në vendet ku mund të ketë fundosje të shtresave shkëmbore prej lëvizjes së pllakave të kores tokësore. I gjithë ky proces zhvillohet në brendësi të tyre, ku temperatura dhe trysnia e lartë shkaktojnë ndryshime në strukturën dhe përbërjen kimike të mineraleve që përmbajnë shkëmbinjtë.</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë formimin e shkëmbinjve metamorfikë, bazuar në figurën 56.</p> <p>Në vazhdim mësuesja trajton llojet e shkëmbinjve metamorfikë: Në varësi të kushteve ku ndodh transformimi i shkëmbinjve magmatikë apo sedimentarë në metamorfikë, dallohen dy lloje shkëmbinjsh: metamorfikë kontakti dhe metamorfikë rajonale.</p> <p>Fton nxënësit/et që bazuar në figurën 57 a/b të dallojnë mënyrën dhe vendin e formimit të shkëmbinjve metamorfikë në Tokë.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë mes tyre.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1,2 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>



## Tema mësimore: II.24 Rëndësia e shkëmbinjve

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.24 Rëndësia e shkëmbinjve</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan llojet e shkëmbinjve dhe mineraleve kryesore që përdoren nga shoqëria njerëzore.</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjte, mineralet) për shoqërinë.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul> </li> </ol>			

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja përshkuan rëndësinë e shkëmbinjve.

### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi shkëmbinjtë dhe mineralet e ndryshme me rëndësi ekonomike për shoqërinë

### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për shoqërinë

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për shoqërinë.

**Fjalët kyçe:** minerale (të ngurta, të lëngëta, të gazta), minerale (metalore dhe jometalore).

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

#### a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Nxënësit dinë:

Shkëmbinjtë dhe mineralet kanë rëndësi të madhe ekonomike dhe natyrore;

#### b. Ndërtimi i njohurive të reja

##### Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.24 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

##### Veprimet në situatë

##### Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.24 (në tekst) – Diskutojmë: Dimë që nëntoka shqiptare është e pasur me minerale. Listojmë disa prej tyre dhe përshkruajmë ku ndodhen e përse përdoren.

Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...

##### Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesja trajton konceptin minerale dhe gjendjet e tyre: Shkëmbinjtë përbëhen nga minerale të ndryshme.

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Mineralet janë përbërje lëndore, të cilat janë formuar nga procese fizike e kimike që zhvillohen në koren e Tokës. Secili prej tyre ka një strukturë të caktuar, që e dallon nga të tjerët. Mineralet mund të jenë në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. Në gjendje të ngurtë janë mineralet metalore (si kromi, bakri, hekuri, alumini etj.) dhe jometalore (si mermeri, kaolina etj). Në gjendje të lëngët është nafta, ndërsa në gjendje të gaztë është gazi natyror.</p> <p>Në vazhdim, fton nxënësit/et të shohin informacioni e dhënë në tekst dhe e trajton së bashku me ta.</p> <p>Fton nxënësit/et të diskutojnë rreth këtij informacioni duke përshkruar figurat 58 dhe 59 si dhe duke sjellë vetë shembuj ilustrues.</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyre klase ushtrimet 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.25

### Dherat

<p><b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b></p>	<p><b>LËNDA: GJEOGRAFI</b></p>	<p><b>SHKALLA: III</b></p>	<p><b>KLASA: VII</b></p>
<p><b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b></p>		<p><b>Tema mësimore: II.25 Dherat</b></p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.</li> </ul>			

**2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)**

- Përshkruan veçoritë e kryesore të dherave.

**3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)**

- Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.
- Identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës****1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja liston faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi veçoritë kryesorë të dherave.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave.

**Fjalët kyçe:** dherat, shkëmbinj mëmë, faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave, profili i dherave.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:

Në shkëmbinj të ndryshëm formohen lloje të ndryshme dherash.

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.25 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.25 (në tekst) – Diskutojmë: Në figurë është paraqitur prerja tërthore e një lloji toke. Përshkruajmë se çfarë veçorish (trashësia, ngjyra, dendësia, përmasat e copave që e përbëjnë) dallojmë nga sipërfaqja e saj deri në thellësi.</p> <p>Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesja trajton konceptin dhera (toka): Dherat janë një trup natyror, i formuar nga grumbullimi i materialeve të shpërbëra prej shkatërrimit të shkëmbinjve, si dhe nga ajri, uji në formë tretësirash të pasura me kripëra, copëzat e fosileve organike dhe organizmat e gjallë (shumë të vegjël e mikroskopikë, si insektet, krimbat, bakteret). Dherat gjenden në pjesën e sipërme të kores së Tokës dhe janë të pasura me lëndë organike. Shkëmbinjtë mbi të cilët formohen dherat, i quajmë shkëmbinj mëmë (fig. 60). Për formimin e dherave nevojiten periudha të gjata kohore, sepse procesi i shkatërrimit të shkëmbinjve është shumë i ngadaltë. Në shpërbërjen e tyre ndikon edhe aktiviteti i kafshëve, bimëve dhe gjallesave shumë të vogla. Mendohet se formimi i një centimetri dhe (tokë) kërkon nga 100 deri në 1000 vjet...</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 60 dhe trajton profilin e dherave.</p> <p>Bazuar në figurën 90, nxënësit/et përshkruajnë veçoritë e secilës shtresë, duke sjellë edhe vetë shembuj ilustrues.</p> <p>Në vazhdim mësuesi/ja trajton faktorët që ndikojnë në formimin e dherave: Dherat ndryshojnë ndërmjet tyre, për shkak të veçorive që kanë (trashësia, ngjyra, përbërja minerale, dendësia, etj.). Kjo, pasi formimi i dherave varet nga këta faktorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lloji i shkëmbinjve. Në varësi të llojit të shkëmbinjve, pra të fortësisë dhe të përbërjes së tyre, përcaktohen edhe veçoritë e dherave që formohen. Për shembull, shkëmbinjtë më të butë, të cilët gërryhen e shpërbëhen më shpejt, formojnë toka me trashësi (thellësi) më të madhe...</li> </ul> <p>Në vazhdim ftohen nxënësit të përshkruajnë figurën 61...</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1,2, 3, 4, të rubrikës “Radha jote”.</p>
---	---

<b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b>	Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.
<b>Vlerësimi i nxënësit</b>	Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.

## Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë


- **Përsëritje IV**
- **Tema Litosfera 1**

### 1. E vërtetë apo e gabuar?

- Ne mund t'i shohim me sy të lirë të gjitha llojet e shkëmbinjve të planetit. **V G**
- Mineralët mund të jenë në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë. **V G**
- Shkëmbinjtë nën të cilët formohen dherat, i quajmë shkëmbinj mëmë. **V G**
- Bërthama e Tokës përbëhet nga nikeli dhe hekuri. **V G**
- Shkëmbinjtë janë trupa gjeologjikë, të përbërë nga një ose më shumë minerale. **V G**
- Në planetin tonë gjenden tri lloje shkëmbinjsh: sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë. **V G**
- Shkëmbinjtë metamorfikë ndahen në: ultrabazikë, bazikë, mesatarë dhe acidë. **V G**

2. Në figurën 1: a) **emërto** shtresat e Tokës; b) **evidento** disa prej veçorive të secilës prej tyre.

### 3. Plotëso skemën e përbri.



**4. Analizo** faktorët që ndikojnë në formimin dhe përhapjen e dherave.

**5.** Në figurën 2, **plotëso** profilin e dherave dhe **përshkruaj** disa nga veçoritë e secilës shtresë.

**6. Diskuto** mbi këto pyetje:

- a. Si janë formuar shkëmbinjtë magmatikë, sedimentarë dhe metamorfikë?
- b. Cilat janë llojet e shkëmbinjve sedimentarë? Si formohet secili prej tyre?
- c. Cilat janë llojet e shkëmbinjve magmatikë? Si formohet secili prej tyre?
- d. Cilat janë llojet e shkëmbinjve metamorfikë? Si formohet secili prej tyre?
- e. Çfarë janë mineralet dhe në ç'formë gjenden në natyrë?
- f. Ku qëndron rëndësia e shkëmbinjve dhe e mineraleve?
- g. Çfarë kupton me fjalën “dhera”?
- h. Nga ndryshojnë dherat prej shkëmbinjve?

**7. Lidh me shigjetë** alternativat e duhura.

- |   |  |
|---|--|
| 1. Shkëmbinjtë metamorfikë rajonalë formohen            | a. dekompozimi i organizmave bimore dhe shtazorë.  |
| 2. Kur ngurtësimi i magmës ndodh në sipërfaqe të Tokës, | b. kur shtresat e mëdha shkëmbore në thellësi u nënshtrohen temperaturave dhe presioneve shumë të larta. |
| 3. Materiali organik i dherave formohet nga             | c. grumbullimi dhe ngjeshja e sedimenteve të ndryshme.   |
| 4. Shkëmbinjtë sedimentarë formohen nga                 | d. formohen shkëmbinjtë magmatikë efuzivë.   |

## ■ Testim 3 – Hidrosfera dhe Litosfera 1

**(shih planin vjetor dhe atë të tremujorit të parë për orën se kur bëhet testimi)**

**Shënim 1:** Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit/et: njohuritë, shkathhtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit/et të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipat e ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (të tekstit). Pyetjet e përsëritjes mund t'i përdorni për pyetje testimi dhe gjatë orës së përsëritjes të formuloni edhe pyetje të tjera.

**Shënim 2:** Në orën e përsëritjes dhe të testimit, në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi/ja duhet të vlerësohet për shkallën e perceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij/saj të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi/ja mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit/es për t'i shpjeguar ato me fjalët e tij/saj, por sidomos në aftësinë për t'i zbatuar ato. Pra, i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues të nxënësit/es.

## Tema mësimore: II.26

### Historia e Tokës

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë		Tema mësimore: II.26 Historia e Tokës	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim historinë e formimit të planetit tonë.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan kohën gjeologjike të Tokës</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Identifikon disa prej ngjarjeve më të rëndësishme përgjatë historisë së formimit të saj.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			




<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b>                      Nxënësi/ja liston erat kryesore të kohës gjeologjike të Tokës (nga më e vjetra tek më e reja)</p>	
<p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b>                      Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur që prej 4.6 miliardë vite më parë.</p>	
<p><b>3. Marrja e vendimeve</b>                      Nxënësi/ja përshkruan kohën gjeologjike të Tokës.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja përshkruan kohën gjeologjike të Tokës.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> koha gjeologjike, era, periudha</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë:                      Toka është formuar miliona vite më parë dhe ka pësuar ndryshime.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b>                      Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.26 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b>  <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b>                      Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.26 (në tekst) – Diskutojmë: Rikujtojmë çfarë kemi mësuar mbi vendin që zë Toka në sistemin diellor dhe diskutojmë mbi pyetjet: Kur është formuar Toka? Pse ndryshon ajo nga planetët e tjerë të sistemit diellor?</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b>                      Mësuesi/ja trajton konceptin kohë gjeologjike: Mendohet se Toka u formua rreth 4.6 miliardë vite më parë.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Duke qenë se bëhet fjalë për një kohë shumë të largët, dukuritë që kanë ndodhur në planetin tonë janë të shumta dhe mjaft të rëndësishme. Shtrirja kohore që nga momenti i formimit të Tokës e deri më sot përbën kohën gjeologjike të saj. Gjeologët e ndajnë kohën gjeologjike në era dhe në periudha, duke evidentuar ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur në secilën prej tyre. Ndër to mund të veçohen: formimi i shkëmbinjve më të vjetër (rreth 4 miliardë vite më parë); rritja e sasisë së oksigjenit në atmosferë (rreth 2.3 miliardë vite më parë); fillimi i jetës në Tokë (rreth 542 milionë vite më parë). Një dëshmi e rëndësishme, mbi të cilën gjeologët bazohen për të shpjeguar ndryshimet që kanë pësuar bota e gjallë dhe kushtet natyrore në planetin tonë, janë fosilet e gjetura midis shkëmbinjve....</p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 63 dhe të përshkruajnë disa prej ngjarjeve më të rëndësishme që kanë ndodhur në planetin tonë që prej 4.6 miliardë vite më parë...</p> <p>Nxënësit përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1,2 të rubrikës “Radha jote”. Lihet për detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.27

### Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.27 Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim ndryshimin që ka pësuar Pangea përgjatë miliona viteve.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan ndryshimet kryesore të Pangeas.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Identifikon llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>			
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja evidenton llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi ndryshimin që ka pësuar Pangea përgjatë miliona viteve.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja përshkruan ndryshimin që ka pësuar Pangea përgjatë miliona viteve. Identifikon llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja përshkruan ndryshimin që ka pësuar Pangea përgjatë miliona viteve. Identifikon llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> Pangea, pllaka tektonike, kufij pllakash (ruajtëse, shkatërruese, ndërtuese).</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Toka është formuar miliona vite më parë dhe ka pësuar ndryshime.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.27 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.27 (në tekst) – Diskutojmë: Risjellim në vëmendje ndërtimin strukturor të Tokës dhe përshkruajmë çfarë janë litosfera dhe astenosfera. Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b> Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shohin figurat 63 e 64 dhe trajton ndryshimet që ka pësuar Pangea: Rreth 250 milionë vite më parë, kontinentet kanë qenë të bashkuara të gjitha, duke formuar një superkontinent të quajtur Pangea (fig. 64/a). Ky superkontinent filloi të copëtohej rreth 200 milionë vite më parë. Të njëjtët shkëmbinj dhe fosile të kësaj periudhe janë gjetur si në Afrikën Perëndimore, ashtu edhe në pjesën lindore të Amerikës së Jugut (fig. 65). Kjo tregon se këto kontinente kanë qenë të bashkuara më parë. Që atëherë, lëvizja e pllakave tektonike ka bërë që kontinentet të zhvendosen në pozicionet që janë sot (si në figurën 64/d)...</p> 

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Bazuar në figurat 63 e 64, mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë ndryshimet që ka pësuar Pangea...</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p>Në vazhdim, bazuar në edhe në figurën 65, mësuesja trajton llojet e pllakave dhe të kufijve të tyre: Ndryshimi i madh midis superkontinentit të 250 milionë vjetëve më parë dhe pamjes që ka sot sipërfaqja e Tokës, shpjegohet me lëvizjen e pllakave tektonike. Litosfera e sotme e planetit tonë është e ndarë në 15 pllaka të mëdha tektonike dhe në mbi 20 të vogla. Koha gjeologjike e Tokës (në miliona vite)...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 3 të rubrikës “Radha jote”. Lihet për detyrë shtëpie ushtrimi 2.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.28

### Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI	LËNDA: GJEOGRAFI	SHKALLA: III	KLASA: VII
<p>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</p>		<p>Tema mësimore: II.28 Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre</p>	
<p style="text-align: center;"><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim ndryshimet që pëson korja oqeanike dhe ajo kontinentale përgjatë miliona viteve.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan ndryshimet kryesore që ndodhin në koren e Tokës.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Identifikon dukuritë që ndodhin në kufijtë e pllakave tektonike.</li> </ul>			

<p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës/lëndës</p> <p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja evidenton llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi ndryshimet e vazhdueshme që ka pësuar korja e Tokës.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja krahason dukuritë që ndodhin në kufijtë e pllakave tektonike.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja krahason dukuritë që ndodhin në kufijtë e pllakave tektonike.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> dinamika e kores së Tokës, dukuritë tektonike që ndodhin në secilin lloj të kufijve të pllakave</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Toka është formuar miliona vite më parë dhe ka pësuar ndryshime.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.28 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.28 (në tekst)</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>– Diskutojmë: Sjellim edhe një herë në vëmendje ndërtimin e kores së Tokës; kuptimin mbi pllakat tektonike dhe kufijtë midis tyre. Përshkruajmë çfarë janë: korja kontinentale dhe ajo oqeanike, pllakat tektonike dhe kufijtë midis tyre. Mësuam që pllakat tektonike lëvizin, por, a e dini pse? Çfarë ndodh në kufijtë e pllakave tektonike?</p> <p>Nxënësit/et diskutojnë, përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesja fton nxënësit të shohin figurën 65 dhe trajton dinamikën e kores tokësore: Pas formimit të Tokës si planet, korja e saj nisi të ngurtësohej. Pjesa më e madhe e kores kontinentale ka një vjetërsi 3-4 miliardë vjeçare, ndërsa korja oqeanike më e vjetër daton 180 milionë vjet më parë. Siç shihet, ndërmjet moshave të tyre ka një diferencë të madhe. Kjo shpjegohet me dinamikën e secilës prej tyre. Korja kontinentale, duke qenë më pak e dendur se ajo oqeanike, nuk mund të zhytet dhe të shkatërrohet. Pjesa më e madhe e saj mbetet e pandryshuar, si ajo e formuar miliarda vite më parë. Ndërkohë, korja oqeanike e re formohet vazhdimisht në kufijtë e pllakave ndërtuese....</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë figurën 67.</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja trajton dukuritë që ndodhin në kufijtë e pllakave tektonike: Në kufijtë e pllakave ruajtëse pllakat i rrëshqasin horizontalisht njëra-tjetrës, pra këtu nuk ka as zhytje të tyre dhe as del material nga manteli (fig. 68/a). Ndërkohë që pllakat i rrëshqasin njëra-tjetrës në kufijtë e tyre, fërkimi që krijohet shkakton tërmete. Këto tërmete janë të rralla, por kanë forcë të madhe shkatërruese, sepse janë të cekëta (afër sipërfaqes). Kufij të pllakave ruajtëse dallohen p.sh. në çarjen e madhe të San Andreas, Kaliforni.</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë figurën 68.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.29

### Tërmetet

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.29 Tërmetet</b>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim ndryshimet e sipërfaqes së Tokës.</li> </ul> </li> <li><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (tërmetet).</li> </ul> </li> <li><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Krahason <b>ndryshimet</b> e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (tërmetet).</li> <li>• Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</li> </ul> </li> <li><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> </li> <li><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> </li> <li><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> </li> <li><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul> </li> </ol>			



<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi/ja evidenton llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi pasojat e proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi/ja krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (tërmetet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> tektonike, vullkanike, vatër, hipoqendër, epiqendër, magnitudë.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë: Toka tronditet vazhdimisht nga tërmete me forcë të ndryshme. Kur ndodhin sjellin dëme të mëdha.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.29 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.29 (në tekst) – Diskutojmë: Le të shohim në tabelën e mëposhtme pasojat e tërmetit të rënë në Porto Princ të Haitit, në vitin 2010. Nga informacionet që mund të keni për tërmetet që kanë rënë në vendin tonë, sillni shembuj rreth pasojave të tyre.  Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja fton nxënësit/et të shohin figurën 69 dhe trajton konceptin mbi tërmetet: Lëkundjet e shpejta të kores së Tokës si rezultat i veprimit të faktorëve të brendshëm, quhen tërmete. Ato formohen si pasojë e lëkundjeve dhe shkëputjeve të shkëmbinjve në brendësi të kores tokësore, për shkak të fërkimit që krijohet gjatë lëvizjeve të pllakave tektonike. Tërmetet ndodhin kryesisht në zonat ku riaktivizohen thyerjet e vjetra tektonike. Këto quhen tërmete tektonike. Tërmetet shkaktohen edhe nga lëvizja e fuqishme e magmës nëpër korridoret e saj. Këto lloj tërmetesh quhen vullkanike dhe ndodhin më shpesh përgjatë “Unazës së Zjarrtë të Paqësorit”. Në varësi të thellësisë ku formohen, tërmetet mund të jenë: të cekëta, të ndërmjetme dhe të thella.....</p> <p>Në vazhdim fton nxënësit/et të përshkruajnë figurën 69. Nxënësit përshkruajnë...</p> <p>Në vazhdim, mësuesi/ja trajton elementet e tërmetit: Zona e kores së Tokës ku lind tërmeti, quhet vatrë e tij ose hipoqendër. Ajo ndodhet në një thellësi nga disa dhjetëra kilometra (15-20 km) deri në 700 km. Zona që gjendet në sipërfaqen e Tokës, në drejtim vertikal me vatrën e tërmetit, quhet epiqendër. Valët sizmike që dalin nga vatra, përhapen në të gjitha drejtimet në formë rrethore, duke shkaktuar lëvizjen e shtresave shkëmbore. Disa valë përhapen në brendësi të Tokës, ndërsa disa të tjera përhapen vetëm në sipërfaqe. Fuqia e një tërmeti (forca me të cilën tundet toka) quhet magnitudë e tij. Në ditët e sotme, një sizmograf e mat magnitudën nëpërmjet shkallës Rihter (dikur përdorej shkalla Merkal).</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë hartën e figurës 70 dhe së bashku me ta përcakton shpërndarjen gjeografike të tërmeteve në botë..</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p>Në vazhdim, bazuar në hartën e figurës 70, nxënësit/et tregojnë se në cilët kufij pllakash është përqendruar pjesa më e madhe e tërmeteve në botë.</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 5.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.30

### Vullkanet

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.30 Vullkanet</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim ndryshimet e sipërfaqes së Tokës.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (vullkanet).</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (vullkanet).</li> <li>• Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>			
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja evidenton llojet e pllakave tektonike dhe llojet e kufijve midis tyre.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi pasojat e proceseve të shpejta (tërmetet, vullkanet).</p>			

<p>Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (vullkanet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (vullkanet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> vullkani, vatra, oxhaku, krateri, produktet vullkanike, zonat vullkanike.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>Në Tokë ka shumë zona vullkanike</p> <p>Kur ndodhin sjellin dëme të mëdha.</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.30 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.30 (në tekst) – Diskutojmë: Rikujtojmë njohuritë që kemi marrë mbi shkëmbinjtë magmatikë dhe përshkruajmë se si formohen ata. Po magma dhe llava, çfarë janë? Pse ndryshojnë midis tyre?</p> <p>Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja trajton konceptin vullkan: Procesi i daljes së produkteve vullkanike dhe vendi ku ato dalin në sipërfaqe, quhet vullkan.</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Një vullkan shpërthen kur forca e magmës në brendësi është më e madhe se rezistenca e kores tokësore që e rrethon atë. Në këtë rast, duke u nisur nga thellësia, magma e shkrirë, nën tryshinë e gazeve që përmban, hap me forcë korridore nëntokësore, depërton përmes tyre për të dalë në sipërfaqe dhe shpërthen (fig. 71 dhe fig. 72). Ashtu si tërmetet, edhe vullkanet janë rezultat i dinamikës së pllakave tektonike.</p> <p>Mësuesja fton nxënësit të shohin figurën 71 dhe së bashku me nxënësit trajton pjesët e një vullkani dhe produktet e tij: Një vullkan është i përbërë nga tri pjesë kryesore (fig. 71): 1. Vatra e vullkanit, e cila ndodhet në thellësi dhe përbën rezervuarin ku grumbullohet magma. 2. Oxhaku, që është korridori përgjatë të cilit lëviz magma (mund të ketë një ose disa oxhakë). 3. Krateri, i cili përbën grykën në formë hinke, nga ku dalin produktet vullkanike...</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë hartën e figurës 72 dhe së bashku me ta përcakton shpërndarjen gjeografike të vullkaneve në botë..</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 6.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.31

### Format e relievit

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.31 Format e relievit</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim format e relievit të Tokës.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan se cilët janë faktorët që ndikojnë në formimin e formave të relievit të Tokës.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Krahason midis tyre veçoritë e relievit të sipërfaqes së Tokës.</li> <li>• Demonstron në hartë format kryesore të relievit të Tokës.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			

<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b> Nxënësi/ja evidenton format kryesore të relievit të Tokës.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b> Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi format kryesore të sipërfaqes së Tokës dhe vlerëson faktorët që ndikojnë në formimin e tyre. Demonstron në hartë format kryesore të sipërfaqes së Tokës.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b> Nxënësi/ja krahason format kryesore të sipërfaqes së Tokës dhe faktorët që ndikojnë në formimin e relievit të saj.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja krahason format kryesore të sipërfaqes së Tokës dhe faktorët që ndikojnë në formimin e relievit të saj.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> faktorë të jashtëm dhe faktorë të brendshëm të formimit të relievit, mal, kodër, fushë, luginë</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Planeti ynë ka formë tepër komplekse, si një elipsoid me reliev; Relievi është në zhvillim;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.31 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.31 (në tekst) – Diskutojmë: Nga teksti i Gjeografisë 6, rikujtojmë se çfarë janë mjediset natyrore. Krahasojmë mjediset natyrore të paraqitura në figurat e mëposhtme (a, b, c) dhe përshkruajmë se cilat elemente natyrore mbizotërojnë te secili prej tyre.  Nxënësit/et përshkruajnë, sjellin shembuj...</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja trajton faktorët që ndikojnë në formimin e relievit të Tokës dhe format kryesore të relievit të saj: Format e ulura dhe të ngritura të kores tokësore përbëjnë relievin e Tokës. Relievi është produkt i veprimit të faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm. Si faktorë të brendshëm dallohen përbërja shkëmbore dhe lëvizjet e ndryshme tektonike. Format që krijohen prej faktorëve të brendshëm, modelohen nga veprimi i faktorëve të jashtëm. Në këta faktorë bëjnë pjesë: veprimi i elementeve klimatike, veprimtaria e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore e nëntokësore, veprimtaria detare, karstike, akullnajore, si dhe veprimtaria e njeriut.</p> <p>Format e relievit: Malet janë format më të larta në reliev. Disa male janë formuar gjatë ngurtësimit të magmës në sipërfaqe, disa të tjera prej rrudhosjes dhe ngritjes së shtresave të kores tokësore (kryesisht përgjatë kufijve shkatërrues). Ato mund të gjenden si male të veçuara, vargje malore dhe malësi. Malet kanë shpate dhe kreshta (të mprehta ose të latuara) me forma të larmishme, të krijuara gjatë periudhave të...</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë...</p> <p>Fton nxënësit të përshkruajnë figurat 74, 75, 76, 77 dhe të evidentojnë se cilët janë faktorët e formimit të relievit, si dhe format e krijuara në reliev. Së bashku me ta përcakton shpërndarjen gjeografike të vullkaneve në botë..</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>



## Tema mësimore: II.32

### Bota bimore

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.32 Bota bimore</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim klasifikim e botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Nxënësi/ja përshkruan veçoritë e botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>			
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja rendit brezat bimorë të botës.</p> <p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja vlerëson shumëllojshmërinë e botës bimore në botë.</p> <p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja identifikon shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.</p>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> bimësia e zonës së nxehtë, bimësia e zonave mesatare, bimësia e zonave të ftohta.</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit/et dinë: Planeti ynë ka botë të gjallë të larmishme;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b> Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.32 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b> <b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b> Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.32 (në tekst) – Diskutojmë: Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi brezat e nxehtësisë, duke përshkruar veçoritë e klimës në këta breza dhe si ndikon ajo në zhvillimin dhe shpërndarjen e botës bimore. Nxënësit/et përshkruajnë, sjellin shembuj...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b> Mësuesi/ja trajton shpërndarjen e bimësisë në zonat (brezat) e nxehtësisë: Shpërndarja jo e njëjtë e nxehtësisë dhe e lagështirës nga Ekuatori në pole, bën që në sipërfaqen e rruzullit tokësor të kemi zona të ndryshme bimore. Duke u nisur nga Ekuatori në drejtim të poleve, dallohen këto lloje bimëshish: Bimësia e zonës së nxehtë, që ndeshet në pyjet e dendura ekuatoriale, në savana dhe shkretëtira. Bimësia e zonave mesatare, e cila shtrihet në pyjet e këtyre zonave, preritë, shkretëtirat dhe zonat mesdhetare. Bimësia e zonave të ftohta ose ajo e tundrës. Hapësira e shtrirjes së bimësisë së zonave mesatare dhe të zonave të ftohta është më e madhe në Hemisferën Veriore sesa në Hemisferën Jugore (për shkak të shtrirjes shumë më të madhe të kontinenteve)...</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë figurat 78, 79, 80, 81, 82 dhe të evidentojnë veçoritë e secilës zonë bimësie.</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## Tema mësimore: II.33

### Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore

<p><b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b></p>	<p><b>LËNDA: GJEOGRAFI</b></p>	<p><b>SHKALLA: III</b></p>	<p><b>KLASA: VII</b></p>
<p><b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b></p>		<p><b>Tema mësimore: II.33 Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore</b></p>	
<p style="text-align: center;"><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b></p> <p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rendit saktë, me gojë ose me shkrim faktorët që ndikojnë shpërndarjen e botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcakton se cilët faktorë ndikojnë më tepër mbi shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore në glob.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul>			

#### 4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.*)

- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.

#### 5. Kompetenca personale (*Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.*)

- Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

#### 6. Kompetenca qytetare (*Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.*)

- Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

#### 7. Kompetenca digjitale (*Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.*)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

#### 1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi/ja evidenton se cilët janë faktorët shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore në botë.

#### 2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi/ja mbledh të dhëna se cilët faktorët ndikojnë më tepër në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore në botë.

#### 3. Marrja e vendimeve

Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.

**Fjalët kyçe:** klima, cilësia e ajrit, relievi, tokat, njeriu

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit/et dinë:

Planeti ynë ka botë të gjallë të larmishme;

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.33 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.33 (në tekst) – Diskutojmë: Bazuar në njohuritë që kemi, ne mund të evidentojmë disa nga faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe në shumëllojshmërinë e saj. Cilët janë ata?</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë, sjellin shembuj...</p> <p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja trajton faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e bimësisë në zonat (brezat) e nxehtësisë: Shpërndarja e botës bimore varet nga një sërë faktorësh. Midis tyre veçojmë: klimën, cilësinë e ajrit, relievin, llojet e tokave dhe vepërimtarinë e njeriut. Nga Ekuatori drejt poleve, klima ndryshon, duke ndikuar mbi bimësinë me të gjitha elementet e saj. Drita është një nga elementet e klimës, për të cilin bima ka shumë nevojë për të kryer procesin e fotosintezës. Disa bimë janë dritëdashëse, ndërsa disa të tjera, hijedashëse. Lagështira është një element tepër i domosdoshëm për jetën e bimëve, pasi nëpërmjet saj treten kripërat e ndryshme, që ato i thithin me anë të rrënjëve. Disa bimë kanë nevojë për më tepër lagështirë sesa të tjerat. Era i ndihmon gjithashtu bimët në avullimin e ujit që kanë thithur nëpërmjet rrënjëve, si dhe ndikon në pjalmimin e tyre dhe shpërndarjen e farërave. Erërat e forta e rrezikojnë shumë zhvillimin e bimësisë...</p> <p>Fton nxënësit/et të përshkruajnë figurat 83, 84, 85 dhe të evidentojnë faktorët kryesorë që ndikojnë mbi shpërndarjen e bimësisë.</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2 të rubrikës “Radha jote”. Lihet detyrë shtëpie ushtrimi 3.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

**Tema mësimore: II.34****Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës shtazore**

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë</b>		<b>Tema mësimore: II.34 Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës shtazore</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim se si është shpërndarë bota shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan shpërndarjen e pabarabartë të shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</li> <li>• Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</li> </ul> <p><b>4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.</li> </ul> <p><b>5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan përvojat dhe mendimet në grup.</li> </ul> <p><b>6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.</li> </ul> <p><b>7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.</li> </ul>			

<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës</b>	
<p><b>1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike</b></p> <p>Nxënësi/ja evidenton shpërndarjen e pabarabartë të botës shtazore në botë.</p>	
<p><b>2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit</b></p> <p>Nxënësi/ja mbledh të dhëna mbi faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</p>	
<p><b>3. Marrja e vendimeve</b></p> <p>Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:</b> Nxënësi/ja identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës shtazore sipas brezave të nxehtësisë.</p>	<p><b>Fjalët kyçe:</b> evolucioni i Tokës, klima, relievi, bimësia, njeriu</p>
<p><b>Burimet:</b> Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:</b> Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.</p>
<p>Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><b>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</b></p>	<p>Nxënësit dinë:</p> <p>Planeti ynë ka botë të gjallë të larmishme;</p>
<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Situata e të vepruarit</b></p> <p>Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.34 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p><b>Veprimet në situatë</b></p> <p><b>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</b></p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.34 (në tekst) – Diskutojmë: Shohim hartën e mëposhtme dhe përshkruajmë se si janë shpërndarë disa prej llojeve të botës shtazore në planet. Bazuar në njohuritë e marra ose në kuriozitetet që mund të keni lexuar mbi botën e kafshëve, përmendni edhe shembuj të tjerë (mbi vendndodhjen dhe jetën e tyre). Si mendoni, pse bota shtazore është e larmishme dhe e shpërndarë në botë në mënyrë të pabarabartë?</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë, sjellin shembuj...</p>

<p><b>b. Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>	<p><b>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</b></p> <p>Mësuesi/ja trajton shpërndarjen e botës shtazore në zonat (brezat) e nxehtësisë: Bota shtazore ose fauna e planetit tonë është e shumëllojshme. Ajo jeton në sipërfaqen e Tokës, në tokë, në ujë dhe në ajër. Bota shtazore ndryshon nga njëra gjerësi gjeografike në tjetrën, por edhe midis vendeve të së njëjtës gjerësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm. Ndër ta, më kryesorët janë: evolucioni i Tokës, klima, relievi, bimësia dhe njeriu. Evolucioni i Tokës- Ndryshimet që ka pësuar sipërfaqja e Tokës përgjatë kohës së saj gjeologjike, kanë ndikuar edhe në botën shtazore (fig. 86). Si rezultat i shkëputjes dhe veçimit të kontinenteve nga njëri-tjetri, bota e hershme shtazore u zhvillua në kushtet specifike të secilit prej tyre, duke marrë veçoritë përkatëse. Kjo shpjegon ndryshimet midis botës shtazore të kontinentit të Amerikës së Jugut dhe asaj të kontinentit afrikan, edhe pse kanë kushte klimatike të ngjashme. Pas ndarjes së dy kontinenteve dhjetëra milionë vite më parë, në secilin prej tyre u zhvilluan lloje të reja të botës shtazore.</p> <p>Fton nxënësit/et që, bazuar në fig. 87 dhe 88, të përshkruajnë ndryshimet që vëren midis llojeve të botës shtazore të zonës së nxehtë dhe atyre të zonës së ftohtë.</p> <p>Nxënësit/et përshkruajnë, diskutojnë...</p> <p><b>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup</b></p> <p>Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 2, 3, të rubrikës “Radha jote”.</p>
<p><b>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</b></p>	<p>Nxënësit/et prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p><b>Vlerësimi i nxënësit</b></p>	<p>Vlerësimi fokusohet në vlerësimin e punës individuale dhe të asaj në grup.</p>

## ■ Punë praktike 2.9

- **Tema: Shpërndarja e botës së gjallë sipas zonave të nxehtësisë**

### *Rezultatet e të nxënësit*

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- identifikon brezat e nxehtësisë dhe zonat klimatike në hartën skicë të botës;



- hulumton dhe grumbullon informacione mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe mbi veçoritë e tyre;
- përshkruan llojet kryesore të botës bimore dhe shtazore sipas brezave të nxehtësisë;
- bashkëpunon në grup dhe ndan me të tjerët njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.

### ***Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:***

45 minuta; në klasë.

***Materialet burimore:*** harta fiziko-gjeografike e botës, teksti mësimor, atlas, materiale të gjetura në internet mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe mbi veçoritë e tyre.

***Mjetet e punës:*** harta fiziko-gjeografike e botës, laps/stilolaps, lapsa me ngjyrë/lapustila, fletore/fletë formati A-4, laptop, videoprojektor.

### ***Metodologjia që do të përdoret:***

Punë në grupe.

### ***Puna përgatitore:***

Për realizimin e kësaj pune praktike, nxënësit duhet të bazohen në njohuritë e marra nga teksti mësimor, mbi brezat e nxehtësisë dhe zonat klimatike që shtrihen në secilin prej tyre. Mësuesi/ja i orienton që më parë nxënësit të hulumtojnë dhe grumbullojnë informacione mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe mbi veçoritë e tyre. Me këto informacione, nxënësit do të përgatisin përmbledhjen, e cila do të prezantohet gjatë punës praktike me *PowerPoint*, skema të bëra në tabakë kartoni, postera apo me fletëpalosje. Mësuesi/ja orienton që më parë disa prej nxënësve të përgatitin herbariume me llojet e bimëve që rriten në vendin tonë ose në vendbanimet e tyre.

### ***Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:***

- Në hartën fiziko-gjeografike të botës, të ekspozuar në klasë, përcaktoni brezat e nxehtësisë dhe llojet e klimave që kanë.
- Përcaktojini dhe emërtojini ato në hartën skicë të botës (në tekst).
- Përcaktoni dhe emërtoni në hartën skicë të botës hapësirën që zënë llojet e bimësisë në secilin brez të nxehtësisë (sipas llojeve të klimave). Shkruani në kuadratet bosh disa prej karakteristikave kryesore të tyre.
- Paraqitni në hartën skicë të mëposhtme, me shkrim ose me një shenjë konvencionale, nga dy ose tri lloje bimësh përfaqësuese për secilën lloj bimësie.
- Paraqitni aty, me shkrim ose me një vizatim të thjeshtë, edhe nga dy ose tre përfaqësues të botës shtazore për secilin brez të nxehtësisë.
- Prezantoni nëpërmjet *PowerPoint*-it, skemave të bëra në fletë kartoni, posterave apo

fletëpalosjeve, produktin që keni përgatitur prej hulumtimeve tuaja mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe për veçoritë e tyre.

- Tregojuni (nëse e keni përgatitur) shokëve tuaj edhe herbariumin, duke veçuar në të ndonjë lloj bime që përdoret si bar mjekësor.

- **Nëntematika II: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë**
- **Përsëritje V**
- **Tema Litosfera 2**

### 1. E vërtetë apo e gabuar?

- Gjeologët e ndajnë kohën gjeologjike të Tokës, në era dhe në periudha. **V G**
- Pasojat e drejtpërdrejta të lëvizjeve të pllakave tektonike janë: tërmetet, vullkanet dhe formimi i maleve. **V G**
- Tërmetet që ndodhin në zonat ku riaktivizohen thyerjet e vjetra tektonike, quhen tërmete tektonike. **V G**
- Shkëputja e pjesëve të Pangeas zë fill rreth 250 milionë vite më parë. **V G**
- Korja oqeanike është më pak e dendur se korja kontinentale. **V G**
- Në kufijtë e pllakave ndërtuese ndodh largimi i pllakave nga njëra-tjetra. **V G**
- Krateri përbën rezervuarin ku grumbullohet magma. **V G**
- Veprimtaria e elementeve klimatike dhe ajo e ujërave rrjedhëse, janë faktorë të jashtëm që veprojnë mbi relievin. **V G**

**2. Plotëso:** a) pjesët e një tërmeti (në figurën a) dhe **përcakto** zonat më aktive sizmike në botë; a) b) pjesët e një vullkani dhe produktet vullkanike të tij (në figurën b) dhe **përcakto** zonat vullkanike më aktive në botë.

### 3. Bazuar në hartën e pllakave tektonike në botë:

- përcakto** tipat e kufijve të pllakave tektonike në rastet 1, 2 dhe 3.
- përshkruaj** se çfarë ndodh në secilin prej tyre.

### 4. Diskuto mbi pyetjet:

- Çfarë është pllaka tektonike?
- Pse korja kontinentale është më e vjetër se ajo oqeanike?
- Si formohen tërmetet dhe sa lloje janë ato sipas origjinës së formimit?
- Cilët janë faktorët e formimit të relievit dhe nga ç'forma kryesore përbëhet ai?

- e. Cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen e bimësisë?
- f. Cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen e botës shtazore?

### 5. Lidh me shigjetë alternativat e duhura.

- |                              |   |
|------------------------------|---|
| 1. Bimësia e zonës së ftohtë | a) quhet një fragment i litosferës, i kufizuar nga tre tipa kufijsh.  |
| 2. Pllakë tektonike          | b) janë forma më të ulëta se malet që nuk e kalojnë lartësinë 1000 m.   |
| 3. Fushat                    | c) janë forma kryesisht të sheshta e të ulëta, të krijuara nga ulje tektonike të tokës ose nga grumbullime sedimentare. |
| 4. Kodrat                    | d) shtrihet përgjatë tundrës.   |

## ■ Testim 4 – Litosfera 2

(shih planin vjetor dhe atë të tremujorit të parë për orën se kur bëhet testimi)

**Shënim 1:** Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit/et: njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipat ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (të tekstit). Pyetjet e përsëritjes mund t'i përdorni për pyetje testimi dhe gjatë orës së përsëritjes të formuloni edhe pyetje të tjera.

**Shënim 2:** Në orën e përsëritjes dhe të testimit në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi/ja duhet të vlerësohet për shkallën e perceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi/ja mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit për t'i shpjeguar ato me fjalët e tij, por sidomos në aftësinë për t'i zbatuar ato. Pra i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues të nxënësit.

### Projekt (ora e tretë)

- **Tema: Çështjet mjedisore të ujërave pranë vendbanimit tim**

#### Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të kenë: lumi,

liqeni, hapësira bregdetare, burimet ujore pranë vendbanimit të tij;

- hulumton mbi një çështje mjedisore që lidhet me ujërat në zonën e tij dhe identifikon problemin;
- përcakton faktorët e mundshëm që shkaktojnë problematikën mjedisore;
- ofron zgjidhjen e problemit;
- vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- ndan me grupin idetë dhe përfundimet individuale;
- u bën thirrje moshatarëve dhe komunitetit për të qenë aktivë në zgjidhjet e problemeve të tilla.

### **Burimet kryesore të informacionit:**

Teksti mësimor i Gjeografisë 7, materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara më parë për realizimin e projektit; vëzhgime të nxënësve në terren, biseda me më të rriturit e familjes dhe komunitetin përkatës; të dhëna dhe analiza të marra pranë pushtetit lokal; informacione të siguruara nga interneti, institucione apo organizata mjedisore, si dhe nga media e shtypi.

### **Metodologjia që do të përdoret:**

Punë në grupe, hulumtim, intervista, anketim, diskutim, analizë, prezantim, shkëmbim opinionesh.

### **Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:**

Teksti mësimor, materiale të printuara, informacione nga shtypi i shkruar; kompjuter, videoprojektor, tabelë prezantimi, shenjues, fletëpalosje, postera, foto të ndryshme, skica/ vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit etj.

### **Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së tretë të projektit:**

- Nxënësit përshkruajnë punën e bërë deri në këtë fazë të projektit. Tashmë ai duhet të jetë në trajtën e një raporti paraprak, ndaj u këshillohet të tregojnë një vëmendje të veçantë për origjinalitetin dhe cilësinë e punimit, për të pasur një produkt sa më të realizuar në fazën përfundimtare.
- Evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre.
- Nxënësit përshkruajnë shkallën e përdorimit të burimeve të informacionit, rrugët e sigurimit dhe vlefshmërinë e tyre.
- Raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës të grupeve të tjera, mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme.

**Shënim** Për udhëzimet e realizimit të projektit referoju rubrikës përkatëse, të paraqitur në orën e parë të tij.



# III.

## Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjedisve

### ▪ Nëntematika: Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin

Nxënësi:

- Diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota.
- Heton disa ndër problematikat e krijuara si pasojë e ndërhyrjeve të veprimtarisë së njerëzve (p.sh., ndërtimet e shumta dhe pa kriter, mungesa e kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të zeza etj):
  - në një zonë bregdetare;
  - në një qendër urbane;
  - në një zonë rurale
- Vlerëson ndërvarësinë globale të ndikimeve mjedisore (p.sh., transferimi i ndotjes).

### Tema mësimore:

### III.1 Potencialet e zonave bregdetare

<b>FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI</b>	<b>LËNDA: GJEOGRAFI</b>	<b>SHKALLA: III</b>	<b>KLASA: VII</b>
<b>Nëntematika III: Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin</b>		<b>Tema mësimore: III.1 Potencialet e zonave bregdetare</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</b>			
<p><b>1. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (Nxënësi/ja komunikon në mënyrë efektive.)</b> Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim që bregdeti ka shumë potenciale turistike, ekonomike dhe mjedisore.</p>			
<p><b>2. Kompetenca e të menduarit (Nxënësi/ja mendon në mënyrë krijuese.)</b> Përshkruan disa potenciale turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare.</p>			
<p><b>3. Kompetenca e të nxënit (Nxënësi/ja mëson për të nxënë.)</b> Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake.</p>			

Nxënësi/ja diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota

**4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi/ja kontribuon në mënyrë produktive.)**

Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët/diskutimi të situatës.

**5. Kompetenca personale (Nxënësi/ja bën jetë të shëndetshme.)**

Ndan përvojat dhe mendimet në grup.

**6. Kompetenca qytetare (Nxënësi/ja përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.)**

Kontribuon në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit.

**7. Kompetenca digjitale (Nxënësi/ja përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.)**

Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

Nxënësi/ja heton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare.

**2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit**

Nxënësi/ja sjell shembuj nga vendi dhe bota mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare.

**3. Marrja e vendimeve**

Nxënësi/ja diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore:** Nxënësi/ja diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike, mjedisore të hapësirave bregdetare, përmes shembujve nga vendi dhe bota.

**Fjalët kyçe:** potenciale mjedisore, potenciale ekonomike.

**Burimet:** Teksti, foto, internet, materiale të printuara, album, revista shkencore, enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK, shkenca natyrore.

Metodologjia/teknikat e përdorura/ veprimtaritë e nxënësve

**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve**

Nxënësit dinë:  
Bregdeti është hapësirë që ofron potenciale të mëdha zhvillimi;

